

**KOMISIONI EVROPIAN**

Bruksel, 10.10. 2012 SEC (2012) 332

**DOKUMENT PUNE I SHËRBIMEVE TË KOMISIONIT**

**RAPORT I PROGRESIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2012**

*në shtojcë të*

**DEKLARATËS SË KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EVROPIAN DHE KËSHILLIN**  
Strategjia për zgjerim dhe sfidat kryesore 2012-2013

{KOM(2012)600}

Sekretariati për Çështje Evropiane intervenoi në tekst, duke e zëvendësuar referencën "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" me emrin kushtetues "Republika e Maqedonisë".

## PËRMBAJTJE E SHKURTËR

PËRMBAJTJE E SHKURTËR.....	2
1. HYRJE.....	4
1.1. PARATHËNIA.....	4
1.2. KONTEKSTI.....	4
1.3. MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	4
2. KRITERET POLITIKE.....	6
2.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I SË DREJTËS .....	6
2.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTA E PAKICAVE (SHIH KREUN E NJËJTË KREU 23 – TË DREJTA TË JURISPRUDENCËS DHE FUNDAMENTALE).....	14
2.3. ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE.....	20
3. KRITERET EKONOMIKE.....	21
3.1. EKZISTIMI I TREGTISË FUNKSIONALE TË TREGUT.....	21
3.2 KAPACITETI PËR MENAXHIM ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAT TREGTARE TË UNIONIT .....	26
4. AFTËSIA QË TË MERREN OBLIGIMET NGA ANËTARËSIA.....	29
4.1. KREU 1: QARKULLIMI I LIRË I MALLRAVE .....	29
4.2 KREU 2: QARKULLIMI I LIRË I PUNËTORËVE.....	31
4.3. KREU 3: E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE...31	
4.4. KREU 4: QARKULLIMI I LIRË I KAPITALIT.....	33
4.5. KREU 5: FURNIZIMET PUBLIKE.....	34
4.6. KREU 6: E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE.....	35
4.7. KREU 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE.....	36
4.8. KREU 8: POLITIKA E KONKURENCËS .....	37
4.9. KREU 9: SHËRBIMET FINANCIARE .....	38
4.10. KREU 10: SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIUMET .....	40
4.11. KREU 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL.....	41
4.12. KREU 12: SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE43	
4.13. KREU 13: PESHKATARIA.....	45
4.14. KREU 14: POLITIKA E TRANSPORTIT.....	46
4.15. KREU 15: ENERGJETIKA.....	47
4.16. KREU 16: TATIMIMI.....	49
4.17. KREU 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE.....	50
4.18. KREU 18: STATISTIKA.....	51
4.19. KREU 19: POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI.....	52
4.20. KREU 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE.....	54
4.21. KREU 21: RRJETET TRANSEVROPIANE.....	55
4.22. KREU 22: POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTITUCIONEVE STRUKTUREORE.....	55
4.23. KREU 23: GJYQËSIA DHE TË DREJTAT THEMELOR.....	57
4.24. KREU 24: DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA.....	63
4.25. KREU 25: SHKENCA DHE HULUMTIMI .....	67
4.26. KREU 26: ARSIMI DHE KULTURA.....	68
4.27. KREU 27: MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	69
4.28. KREU 28: MBROJTJA E KOSUMATORËVE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE.72	
4.29. KREU 29: UNIONI DOGANOR.....	74
4.30. KREU 30: MARRËDHËNIE TË JASHTME.....	74
4.31. KREU 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES .....	75
4.32. KREU 32: KONTROLLI FINANCIAR.....	76
4.33. KREU 33: DISPOZITA FINANCIARE DHE BUXHETORE .....	77

ANEKS STATISTIKOR.....79

## 1. Hyrje

### 1.1. Parathënie

Nga muaji mars 2002, Komisioni rregullisht i ka informuar Këshillin dhe Parlamentin për progresin e arritur nga ana e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky raport për progresin e arritur nga ana e Republikës së Maqedonisë në përgatitjet për anëtarësim në BE në masë të madhe e ndjek strukturën e njëjtë, si edhe në vitet e mëparshme. Raporti:

- shkurtimisht i përshkruan marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit;

- e analizon situatën në Republikën e Maqedonisë në lidhje me kriteret politike për anëtarësim;

- e analizon situatën në Republikën e Maqedonisë në bazë të kriterëve politike për anëtarësim;

- e shqyrton kapacitetin e Republikës së Maqedonisë për plotësimin e obligimeve nga anëtarësimi, përkatësisht nga *acquis*, i paraqitur në marrëveshjet, legjislacionin sekondar dhe politikat e Bashkimit.

Ky raport e përfshin periudhën nga tetori 2011 deri në shtator 2012. Progresi matet në bazë të vendimeve të miratuara, legjislacionit të miratuar dhe masat e zbatuara. Sipas rregullës, nuk janë marrë parasysh legjislacioni ose masat që janë në përgatitje ose presin të miratohen nga Kuvendi. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informata të grumbulluara dhe të analizuara nga ana e Komisionit. Gjithashtu, janë përdorur shumë burime, duke përfshirë edhe kontributet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, vendet-anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informatat nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni përpilon konkluzione të hollësishme sa i përket Republikës së Maqedonisë në dokumentin e vet të veçantë për zgjerimin, bazuar në analizën teknike të përmbajtur në këtë raport.

### 1.2. Konteksti

Këshilli Evropian në dhjetor 2005 i ndau Republikës së Maqedonisë status të vendit-kandidat. Marrëveshja për stabilizim dhe asocim (MSA) ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së është nënshkruar më prill 2001 dhe ka hyrë në fuqi më prill 2004. Në tetor 2009, Komisioni i dha rekomandim Këshillit që të fillojë negociatën me vendin, si dhe të kalojë në fazën e dytë të zbatimit të MSA. Këto rekomandime u përsëritën në vitin 2010 dhe 2011. Këshilli ende nuk ka marrë qëndrim në lidhje me propozimet e Komisionit.

### 1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë

Republika e Maqedonisë merr pjesë në **procesin e stabilizimit dhe asocimit**.

**Marrëveshja për stabilizim dhe asocim (MSA)** mbeti thelbësore për marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë. Vendi i zbaton obligimet e veta sipas MSA me BE-në, duke ipërfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me fazën e parë

nga zbatimi i Titullit V (Qarkullimi i punëtorëve, themelimi, sigurimi i shërbimeve, kapitali). Propozimi i Komisionit nga viti 2009 për kalim në fazën e dytë të asociimit, në pajtim me nenin 5 të MSA, është lëndë e shqyrtimit nga ana e Këshillit.

Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik ndërmjet BE-së dhe vendit vazhdoi nëpërmjet strukturave të MSA. Takimet e trupave të përbashkët më të lartë, gjegjësisht Komitetit për stabilizim dhe asociim dhe Këshillit për stabilizim dhe asociim, u mbajtën në tetor 2011 dhe janar dhe korrik 2012. Ekspertët nga të dyja palët kanë mbajtur takime në shtatë nënkomitete dhe grup të veçantë për reforma në administratën publike. Vazhdoi dialogu multilateral ekonomik ndërmjet Komisionit, vendeve-anëtare të BE-së dhe vendeve-kandidate në kontekst të mbikëqyrjes fiskale paraaderuese, duke përfshirë edhe takimin në nivel të ministrave të mbajtur në maj në Bruksel. Në dhjetor 2011, Qeveria e miratoi revizionin vjetor të Programit nacional për miratim të së drejtës së BE-së.

Qeveria dhe Komisioni e filluan **Dialogun aderues në nivel të lartë (HLAD)** më 15 mars 2012. Qëllimi i HLAD është që të futet dinamikë e re në procesin e reformave për aderim në BE dhe me këtë të përforcohet dhe të stimulohet perspektiva evropiane e vendit. Ai nuk e zëvendëson standardin e procedurave paraaderuese. HLAD fokusohet në pesë fusha kryesore: mbrojtja e lirisë së të shprehurit në medie, përforsimi i sundimit të së drejtës, reformat në administratën publike, përmirësimi i procesit zgjedhor dhe zhvillimi i ekonomisë së tregut. Në të gjithashtu shqyrtohet çështja për marrëdhëniet të mira fqinjësore. Takime në nivel politik u mbajtën më 15 mars, 7 maj dhe 17 shtator. Në takime u shqyrtua progresi në reformat në bazë të qëllimeve dhe aktiviteteve të kontraktuara, si dhe udhërrëfyesit të Qeverisë. Konsultime teknike në tema të ndryshme vazhdojnë gjatë vitit. Marrë përgjithësisht, ekziston progres i mirë. Qëllimet dhe aktivitetet vlerësohet hollësisht në kuadër të pjesëve relevante në Raportin e progresit.

**Liberlazimi i vizave** për qytetarët e Republikës së Maqedonisë që udhëtojnë në Zonën e Shengenit hyri në fuqi në dhjetor 2009. Komisioni themelon mekanizëm për përcjellje të liberalizimit pas vizave që të vlerësojë nëse zbatimi i të gjitha reformave të vendosura nga vendi është konsekuent me udhërrëfyesin për liberalizim të vizave, si dhe nëse është i qëndrueshëm. Kjo u plotësua me mekanizëm për paralajmërim që të shmangen keqpërdorimet. Komisioni e prezantoi raportin e dytë nga përcjellja para Parlamentit Evropian dhe para Këshillit në dhjetor 2011, ndërkaq e miratoi raportin e tretë në gusht 2012. Në janar 2008, hyri në fuqi **Marrëveshja për readmision** ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë.

**Ndihmë financiare** është siguruar nëpërmjet Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA). Korniza e reviduar më shumë vjeçare financiare indikative për 2012-2013, vendit i ndan kontribut të përgjithshëm nga BE në shumë prej 215 milionë euro. Programi i fundit nacional në suazat e IPA Komponentit I në rrjedhë, iu parashtrua Komisionit në korrik 2012 me shpërndarje të përgjithshme nga BE në shumë prej 56 milionë euro për vitin 2012 dhe 2013. Krahas kësaj, vendi vazhdon me përfitimit nga bashkëpunimet e ndryshme rajonale dhe tejkufitare dhe programet horizontale. Zbatimi i të gjitha programeve të IPA-s në vend ngadalë përparon. Megjithatë, Qeveria duhet ta orientojë edhe ta përforcojë planifikimin dhe koordinimin horizontal të politikave, veçanërisht në aspekt të IPA-s që pason për periudhën programore 2014-2020.

Nga viti 2007, Komisioni ndau shumë prej mbi 490 milionë euro për zbatimin e projekteve në vend, duke përfshirë edhe 101 milionë euro në vitin 2012. Kjo ndihmë fokusohet në përforsimin e mëtejshëm të kapacitetit administrativ (me theks të veçantë në gjyqësi dhe sektorët e administratës publike), zhvillim rajonal ekonomik, reforma

doganore, harmonizim me *acquis*-in e BE-së, dhe mbështetje teknike, për të siguruar menaxhim të shëndoshë dhe efikas me fondet e BE-së. Në kontekst të paraaderimit, nga dhjetori 2010, pushtetet nacionale drejtpërdrejt menaxhojnë me mbi 250 milionë euro sipas Sistemit të decentralizuar për zbatim (DIS) për katër prej gjithsej pesë komponentëve të IPA-s. Ekzistojnë elemente stimuluese për përforsim të kapaciteteve në administratë në vitin 2012, edhe pse ende nevojitet përforsim i mëtejshëm i menaxhimit nacional dhe sistemeve për kontroll me qëllim që të sigurohet efikasitet më i lartë, ndikim dhe absorbim i mjeteve të BE-së.

**Shoqëria civile** mori mbështetje të madhe financiare nga BE-ja në kuadër të IPA-s për ndihmë të shoqërisë civile dhe programeve nacionale, si dhe nëpërmjet Instrumentit Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut. Programet të cilat zbatohen tani për tani sigurojnë përkrahje të konsiderueshme për menaxhim dhe angazhim të resurseve në OJQ, për bashkëpunim institucional ndërmjet organizatave civile dhe organeve qendrore dhe lokale, si dhe lidhje në rrjet në nivel rajonal. Poashtu, sipas DIS-it, shoqëria civile është e përfshirë në përcjelljen e zbatimit të përgjithshëm të ndihmës nga BE, veçanërisht ndihmës së ofruar sipas Komponentit për ndihmë për tranzicion dhe komponentit për përsosje institucionale, nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet dyvjetore për përcjellje të IPA-s. Takimi i parë u mbajt në Shkup më 16 korrik 2012.

Republika e Maqedonisë në mënyrë aktive merr pjesë në **programet e BE-së** në vijim: “Programi i shtatë kornizë për hulumtim”, “Programi për sipërmarrësi dhe inovacione”, “Progresi”, “Kultura”, “Evropa për qytetarët”, “Fiskalis 2013”, Dogana 2013”, dhe (nga dhjetori 2011) “Programi për energji inteligjente”.

## **2. KRITERET POLITIKE**

Kjo pjesë e shqyrton progresin e bërë nga ana e Republikës së Maqedonisë drejt plotësimit të kriterëve politike nga Kopenhaga, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokraci, sundim të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të pakicave. Gjithashtu, përcillet bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet e inkuadruara në procesin e zgjerimit dhe vendet anëtare, si dhe respektimi i obligimeve ndërkombëtare, siç është bashkëpunimi me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavinë (GJPNJ).

### **Demokracia dhe sundimi i së drejtës**

#### *Kuvendi*

Funksioni i Kuvendit dhe dialogu politik kanë qenë të qëndrueshëm. Dialogu duhet të përforsohet edhe më tej, sidomos për çështjet ndëretnike.

Të gjitha palët e kanë përkrahur Dialogun aderues të nivelit të lartë si mundësi për vendosje të dinamikës së re në procesin e aderimit në BE. Kuvendi miratoi disa ligje të lidhura me aderimin në BE, sidomos në aspekt të qëllimeve reformuese të Dialogut paraderues në nivel të lartë.

Kuvendi debaton për propozimet e Qeverisë për përmirësim të kornizës ligjvënëse për zgjedhje, duke i përcjellur rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet në vitin 2011. Propozimet kanë për qëllim përforsimin e Kodit zgjedhor, sidomos përmes rritjes së transparencës së fushatës dhe financimit të partive politike dhe adresimit të mangësive dhe dyshimeve në ligjin ekzistues. Qeveria poashtu propozoi ndryshime të Ligjit për financim të partive politike. Lista zgjedhore është në fazë të kontrollit. Përpjekjet rrjedhëse do të jenë të domosdoshme për përmbushje të plotë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, veçanërisht në aspekt të ndarjes së shtetit nga

partitë politike, parandalimit të frikësimit të votuesve dhe revizionit të Listës së zgjedhësve.

Komisioni parlamentar për çështje evropiane dhe Këshilli nacional për eurointegrim, me të cilin kryeson opozita dhe përfshin përfaqësues të shoqërisë civile, kanë mbajtur seanca të përbashkëta për çështje evropiane kyçe. Ata debatuan për Raportin e progresit për vitin 2011, revizionin vjetor të Programit nacional për miratim të së drejtës së Bashkimit evropian (NPAA) dhe udhërrëfyesin për reforma nga Dialogu aderues i nivelit të lartë. Komisioni për çështje evropiane dhe Këshilli nacional për eurointegrim u konsultuan me Komisionin në takimin në suaza të Dialogut aderues në nivel të lartë më 7 maj dhe 17 shtator në Shkup. Të dy trupat kanë mbajtur mbledhje të rregullta dhe debate publike.

Për pikat e rendit të ditës të propozuara nga ana e opozitës është debatuar në seanca plenare, në pajtim me Ligjin për Kuvend nga viti 2009 dhe ndryshimet e Rregullores nga viti 2010.

U mbajtën katërmbëdhjetë debate publike shtesë, një diskutim publik dhe dy debate mbikëqyrëse. Në procesin ligjvënës u konsultuan organizata nga shoqëria civile dhe publiku akademik.

U zbatuan ndryshimet nga viti 2011 të Ligjit për gjuhët. Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive i vazhdoi aktivitetet e veta dhe mbajti pesë mbledhje, duke përfshirë edhe një për incidentet ndëretnike dhe tensionet që ndodhën në gjysmën e parë të vitit. Komisioni për punë dhe politikë sociale vazhdon të debatohet për Ligjin për mbrojtësit ndihmë viktimave nga konflikti në vitin 2011 i propozuar nga Qeveria për. Duhet të gjendet zgjidhje e përbashkët e mjaftueshme që e lehtëson pajtimin, në bazë të raportit qeveritar të paradokohshëm për Marrëveshjen Kornizë të Ohrit.

Kodeksi etik për deputetët nuk u miratua. Komisioni anketues i themeluar për të hetuar incidentin në Kuvend në vitin 2010 ende nuk ka miratuar konkluzion.

Instituti parlamentar, i themeluar me Ligjin për Kuvendin nga viti 2009 me qëllim që të ndihmojë në punën e deputetëve, ende nuk funksionon. Nevojiten përpjekje plotësuese për t'u zgjidhur pengesat administrative, siç janë prolongimet e procedurave për punësim të kuadrit.

Mbikëqyrja parlamentare mbi përcjelljen e komunikimeve u përforcua me ndryshimet e kornizës ligjvënëse. Duhet të përforcohet mbikëqyrja mbi shërbimet për zbulim dhe kundërzbulim. Ekziston bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërmjet të dyja komisioneve parlamentare kompetente dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

*Përgjithësisht*, funksionimi i Kuvendit dhe dialogu politik ishte i qëndrueshëm. Kuvendi në mënyrë konsekuente e mbështet procesin e aderimit, duke përfshirë Dialogun aderues në nivel të lartë. Ekziston progres në zbatimin e Ligjit për gjuhët dhe Rregulloren. Qeveria miratoi propozime për përmirësimin e kornizës për zgjedhje, të cilat tani shqyrtohen nga ana e Kuvendit. Të domosdoshme janë përpjekje të vazhdueshme për përmbushje të plotë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme që të zhvillohet kapaciteti i Kuvendit dhe nevojitet të përforcohet dialogu politik.

#### *Qeveria*

Qeveria e Maqedonisë e thelloi përkushtimin e procesit të reformave të lidhur me BE-në duke iu përkushtuar plotësisht Dialogut aderues në nivel të lartë. Në bazë të

kësaj, ajo miratoi udhërrëfyes ambicioz për reforma në prill 2012 dhe rregullisht bën kontrollim të zbatimit në nivel të ministrave. Në frymën e inkluzivitetit, u konsultuan organizata nga shoqëria civile. Nëpërmjet këtij dialogu, procesi i aderimit në BE përsëri ka fituar vend qendror në agjendën politike të vendit.

Versioni i reviduar i Programit nacional për miratim të së drejtës së BE (NPAA) u miratua më dhjetor 2011. Ai përmban afate më të qarta, kërkesa për punësim dhe implikime buxhetore. Shkurtime në buxhetin shtetëror kanë ndikuar në zbatimin e disa prej masave.

Në gjysmën e parë të vitit 2012 ka pasur disa incidente dhe vrasje në vend. Përpjekjet e përbashkëta të partnerëve në koalicion kanë pasur rol të rëndësishëm në zvogëlimin e tensioneve ndëretnike të krijuara me këto incidente (*Të shihet Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat kulturore*). Qëndrimet e ndryshme për statusin e viktimave nga konflikti në vitin 2011 kanë ndikuar në marrëdhëniet në Qeveri. Partnerët e koalicionit duhet të vazhdojnë me dialogun e tyre që të gjejnë zgjidhje dhe të sigurojnë stabilitet.

Në tetor 2011, 10 ditë pas fillimit të regjistrimit, Komisioni shtetëror i regjistrimit dha dorëheqje për shkak të mospajtimeve në lidhje me metodologjinë e vendosur nga Enti shtetëror i statistikës, veçanërisht metodën për numërim të qytetarëve që punojnë jashtë shtetit. Partnerët e koalicionit u pajtuan që ta ndërpresin regjistrimin.

Vazhdoi decentralizimi i pushtetit, element kryesor i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Është miratuar programi për zbatim të decentralizimit dhe vetadministrimit lokal për vitin 2011-2014 dhe plani përkatës aksional. Të gjitha komunat, përveç njëjës, kanë hyrë në fazën e dytë të decentralizimit fiskal që siguron transferim më të konsiderueshëm të kompetencave dhe menaxhim financiar në nivel lokal. Sipas Ligjit për financim të njëjësive të vetadministrimit lokal, pjesa e TVSH-së e transferuar në komuna është rritur për 4%, në këtë mënyrë duke e përforcuar kapacitetin e tyre financiar për marrje të detyrave të reja. Dispozitat e Ligjit për zhvillim rajonal për shpërndarje financiare nëpërmjet trupave përgjegjës nuk janë zbatuar plotësisht. Që t'u ndihmohet komunave, zbatohen programe për përforsim të kapacitetit.

Progresi në arritjen e qëllimeve të decentralizimit duhet të përshpejtohet me stimulim nga Ministria për Vetadministrim Lokal dhe Ministria e Financave. Mekanizmat për ballafaqim me dallimet e konsiderueshme në sigurimin e shërbimeve publike janë të kufizuar, dhe veçanërisht në pozitë të pavolitshme janë komunat rurale dhe të vogla. Qëndrueshmëria financiare e komunave mbetet sfida kryesore. Edhe pse ka rritje të caktuar të grumbullimit të tatimeve lokale dhe taksave, disa komuna kanë vështirësi në grumbullimin e tatimit mbi pronë.

Korniza financiare dhe juridike për zbatim të të gjitha përgjegjësive të transferuara në komuna duhet të zhvillohet me pjesëmarrje të njëjësive të vetadministrimit lokal. Gjithashtu, nevojitet transparencë më e madhe dhe koordinim i financimit qendror të projekteve të komunave.

*Përgjithësisht*, bashkëpunimi në suaza të koalicionit qeveritar ka vazhduar dhe pati sukses t'i sigurojë vend qendror procesit të aderimit të agjendës politike. Qeveria në mënyrë efikase e ka koordinuar zbatimin e Dialogut aderues në nivel të lartë në bazë të udhërrëfyesit të vet. Qeveria seriozisht iu përgjigj tensioneve ndëretnike dhe duhet të vazhdojë me këtë për përforsim të mëtejme të marrëdhënieve ndëretnike dhe pajtimit, duke përfshirë statusin e viktimave nga konflikti në vitin 2001. Partnerët



e koalicionit duhet të vazhdojnë me dialogun e tyre që të gjejnë zgjidhje dhe të sigurojnë stabilitet. Në fushën e vetadministrimit lokal, duhet të përshpejtohet progresi i decentralizimit, veçanërisht në aspekt të kornizës financiare.

#### *Administrata publike*

Është arritur progres në fushën e administratës publike. Komiteti i lartë për administratë publike, me të cilin kryeson Kryetari i Qeverisë, e mbajti koordinimin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë politike për reformat në administratën publike. Është përmirësuar kapaciteti administrativ dhe funksional i Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA) për menaxhim me administratën publike, dhe inspeksioni administrativ u përforcua me kuadër të ri dhe trajnime. Nevojiten përpjekje plotësuese dhe resurse për përmirësim të mëtutjeshëm të kapacitetit administrativ të MSHIA-s dhe inspeksionit administrativ për kryerje efektive të detyrave në vend. Ligji për nëpunës shtetërorë dhe Ligji për nëpunës publikë u ndryshuan, duke e shtyrë deri në muajin janar 2013 zbatimin e disa metodave për vlerësimin e kuadrove që paraprakisht u kritikuan nga ana e ekspertëve të BE-së. Mobiliteti i nëpunësve shtetërorë dhe publikë u përmirësua pjesërisht. Regjistri i nëpunësve publikë tani funksionon, edhe pse ka të dhëna jo të plota nga disa institucione. Gjykata kushtetuese përjashtoi disa kategori të kuadrove nga përfshirja e Ligjit për nëpunës publikë, duke i mbajtur vetëm ato që qartë kanë autorizime publike. Procedurat për punësim dhe përjashtim në institucionet që nuk janë të prëfshira në Ligjin për nëpunës publikë tani rregullohen me dispozitat nga legjislacioni për marrëdhënie pune dhe marrëveshje kolektive. Sfera e shërbimit shtetëror dhe publik ngelet e fragmentuar. Që të konsolidohet rregullimi i kësaj sfere dhe që të zgjidhen mangësitë veçanërisht në aspekt të punësimit, avancimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kanë filluar përgatitjet për një Ligj të ri për administratë i cili do të jetë më gjithpërfshirës.

Kriteret kualifikuese për punësim edhe më tutje janë jokonsekuente. Është shënuar përparim i caktuar në eliminimin e shpalljeve të publikuara për kandidatë përkatës, por megjithatë ekziston shqetësim se parimi për punësim në bazë të meritave nuk respektohet çdoherë. Rregullativa për punësime të përkohshme edhe më tutje është e paharmonizuar me procedurat e përgjithshme për punësimin e nëpunësve shtetërorë dhe publikë. Qeveria nuk i bën të arritshme numrat zyrtarë për vendet e punës ekzistuese ose të transferuara.

Në lidhje me përfaqësimin e drejtë, afërsisht një e katërta nga të gjithë nëpunësit e sapopunësuar shtetërorë janë nga bashkësitë joshumicë. Nevojitet përmirësim i konsiderueshëm i koordinimit të procesit të punësimit, veçanërisht nga ana e Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Vazhdoi trendi i punësimit në bazë kuantitative pa i marrë parasysh aq sa duhet nevojat reale të institucioneve. Shumica e të punësuarve nuk janë të sistemuar në institucionet përkatëse edhe pse marrin kompensim nga Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Procedura e punësimit për pjesëtarët e bashkësive joshumicë nuk është e harmonizuar me procedurat e përgjithshme për punësim dhe ngel e cenueshme për ndikimin politikë tejmasë.

Sistemi për rroga ngelet i fragmentuar. Vazhdoi praktika e pagesës së kompensimeve ad hok të nëpunësve publikë për marrjen e detyrave të caktuara në suaza të pozicioneve të tyre të punës, pa u siguruar justifikim transparent.

Kuvendi e vendosi parimin "heshtja është miratim" në procedurë administrative, duke ndryshuar mbi 130 ligje në përputhje me ndryshimet e paradokohshme të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Procedura ankimore komplekse seriozisht

e dëmton zbatimin e këtij parimi./ Për ballafaqim me këtë çështje dhe me çështje tjera, kanë filluar përgatitjet për ligj bashkëkohor për procedurë të përgjithshme administrative.

Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative në Shkallë të Dytë. Komisioni shtetëror ende nuk është funksional plotësisht dhe ka mungesë të kapacitetit administrativ.

MSHIA i vazhdoi përpjekjet për përmirësimin e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. E-qeveria u promovua si vegël për zmadhimin e transparencës dhe për parandalimin e korrupsionit të pakonsiderueshëm. Sistemi "Semafor" për vlerësim nga ana e qytetarëve u përhap dhe përfshin institucione plotësuese. Përgjegjësia për menaxhim me vlerësimin e ndikimit të rregullativës (RIA) dhe Regjistri unik elektronik i rregullave u bart nga Sekretariati i Përgjithshëm në MSHIA. Janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e procesit për përpilimin e legjislacionit përmes RIA-s. Megjithatë, nuk zbatohen në mënyrë sistematike. Duhet të rritet vetëdija publike për ditarin civil që teston sa janë të kënaqur qytetarët.

Në aspekt të menaxhimit financiar, përgjegjësia udhëheqëse ende nuk i merr plotësisht parasysh parimet e kontrollit të brendshëm financiar publik. Raportet e Entit Shtetëror të Revizionit vazhdimisht i potencojnë mangësitë e shumta në lidhje me zbatimin e rregullave për furnizime publike dhe politikën e resursve njerëzore. Duhet të përforcohet cilësia e planifikimit strategjik në institucionet qendrore dhe lokale.

Gjykata Kushtetuese i shfuqizoi dispozitat e afër 15% të ligjeve që u kontestuan para Gjykatës gjatë vitit 2011, zvogëlim në krahasim me vitin 2012.

Numri i ankesave të pranuar në Komisionin Nacional për Mbrojtjen e Qasjes në Informata u zvogëlua për 25% në vitin 2011. Shumica e ankesave janë kundër organeve të administratës shtetërore për heshjen administrative. Më shumë se gjysma e ankesave sollën në paraqitjen e informatave të kërkuara. Nuk u imponuan sanksione. Kapaciteti administrativ i Komisionit Nacional për Mbrojtjen e Qasjes në Informata nuk është përmirësuar dhe financimi nga shteti u zvogëlua. Komisioni Nacional për Mbrojtjen e Qasjes në Informata vazhdoi të mbajë trajnime të rregullta që të rritet vetëdija për të drejtën e qasjes së lirë në informatat publike.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit edhe më tutje respektohen nga ana e organeve publike në të shumtën e rasteve (78%). Edhe më tutje rekomandimet më së paku i marrin parasysh komisionet qeveritare në shkallë të dytë, pastajë vijojnë Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Njësitë e Vetadministrimit Lokal. Shumica e shkeljeve kanë të bëjnë me të drejtat e konsumatorëve, të drejtat pronësore, të drejtat e punëtorëve dhe burgjet.

Pati përparim mesatar në lidhje me reformat e policisë me zbatimin e Aktit për sistematizim të orientuar drejt përfundimit të efikasitetit të shërbimeve policore. Nevojiten resurse njerëzore plotësuese për zbatimin e aktit, veçanërisht në forcat policore rajonale. Ka nevojë për trajnime permanente, profesionalizim dhe depolitizim të të punësuarve në polici. Për këtë qëllim, nevojitet mekanizëm mbikëqyrës i pavarur për organet për zbatimin e ligjit për luftë kundër mosndëshkueshmërisë dhe për sigurimin e shërbimeve policore demokratike dhe të përgjegjshme. Ligji për ndjekjen e komunikimeve u ndryshua, duke e përforcuar efikasitetin dhe transparencën e kësaj mase të veçantë hetuese.

*Përgjithësisht*, ka përparim të caktuar në aspekt të administratës publike. Shërbimet për qytetarët u përmirësuan dhe gradualisht po vendoset e-qeveria. Janë ndërmarrë hapa në lidhje me reformat themelore të kornizës administrative dhe shërbimit publik dhe shtetëror. Nevojiten përpjekje plotësuese që të garantohet transparencë, profesionalizëm dhe pavarësi e administratës publike. Veçanërisht, duhet të sigurohet respektim i parimit për punësim në bazë të meritave bashkë me parimin për përfaqësim të drejtë.

*Sistemi i jurisprudencës (Shih edhe Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore)*

Organet kryesore me detyrë për sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë, përgjegjësisë dhe profesionalizmit të jurisprudencës vazhduan t'i kryejnë funksionet e tyre.

Këshilli Gjyqësor emëroi 63 gjykatës në gjykata nga të gjitha instancat në vitin 2011 dhe 6 kryetarë të rinjë të gjykatave. Gjatë emërimit të gjykatave në instancën e parë, Këshilli Gjyqësor vazhdoi t'u japë përparësi kandidatëve të cilët nuk kanë diplomuar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (AGJPP) edhe krahas dispozitave ligjore se 50% nga emërimet e këtilla duhet të jenë nga radhët e kandidatëve të diplomuar nga AGJPP-ja. Kjo shkakton shqetësim në lidhje me kredibilitetin e dispozitave ekzistuese për punësim dhe obligimet e marra të Këshillit Gjyqësor për punësim të bazuar në merita. Këshilli Gjyqësor ngriti 4 procedura për shkarkim gjatë vitit 2011 (prej 12 të vitit të kaluar) dhe 1 procedurë disiplinore. Për momentin ekzistojnë baza të shumta për shkarkimin e gjykatësve, por, ajo që shfrytëzohet në shumicën e rasteve është e gjerë dhe e përgjithshme (ushtrim i funksionit të gjykatësit në mënyrë joprofesionale, jo në kohë dhe të pakujdesshme). Nevojiten përpjekje për mbrojtjen e mëtutjeshme të sigurisë së mandatit të gjykatësve me garantim se bazat për shkarkim janë të qarta, precize dhe të parashikueshme dhe se zbatimi i rregullave domethënë respektim i parimit të proporcionalitetit. Këshilli Gjyqësor e përfundoi evaluimin profesional të 612 gjykatësve për vitin 2011: 77% u vlerësuan me notë shumë mirë, 20% me mirë, 2,45% me mjaftueshëm dhe 0,49% (3 gjykatës) me notë pamjaftueshëm. Kriteret për vlerësim të zbatuara nga ana e Këshillit Gjyqësor sipas legjislacionit ekzistues janë kryesisht kuantitative në vend të kualitative dhe nuk është bërë asnjë lidhshmëri ndërmjet vlerësimit profesional të gjykatësve dhe njohjes së nevojave të tyre të ardhshme për trajnim.

Këshilli i Prokurorëve Publikë emëroi 18 prokurorë publikë në vitin 2011. Asnjë prokurorë publik nuk është shkarkuar. Shërbimet e Këshillit ngelin me numër të pamjaftueshëm të të punësuarve. Këshilli është financiarisht i varur nga zëri buxhetor nga mjetet e ndara për Prokurorinë Publike dhe është i vendosur në zyre të marra me qira.

Parimi i përfaqësimit të drejtë dhe barazisë gjinore vazhdon të respektohet në shërbimet e gjyqësisë dhe prokurorisë.

Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (AGJPP) vazhdon të sigurojë si trajnime fillestare për gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm ashtu edhe trajnime të vazhdueshme për anëtarët dhe të punësuarit në gjyqësi, organet për zbatimin e ligjit dhe institucionet dhe trupat tjerë. Megjithatë, gjenerata e pestë e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë e caktuar për vjeshtën e vitit 2011 u shty dhe iu bashkua gjeneratës për vitin 2012. Kjo shtyrje rezultoi nga pasiguria rreth komponentit të sapovendosur për integritet për provimin pranues të AGJPP-së, që pjesërisht u anulua nga Gjykata Kushtetuese në shkurt 2012. Prej 80 kandidatëve të cilët me

sukses diplomuan në AGJPP nga janari 2009 deri më tani 56 janë punësuar si gjykatës dhe prokurorë, ndërsa 24 të tjerë ngelin të emërohen në vendet e tyre të para të punës.

Në lidhje me *efikasitetin*, është arritur progres për zvogëlimin e numrit të lëndëve të ngelura në sistemin gjyqësor në tërësi. Numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjydhura në gjykatat vendore në të gjitha instancat në fund të vitit 2011 ishte 295.769 (në krahasim me numrin prej 678.670 në vitin 2010). Një numër i konsiderueshëm i lëndëve dhe rasteve jashtëkontestimore (afër 330.000) u mënjanuan nga sistemi gjyqësor në gjysmën e dytë të vitit 2011, si rezultat i bartjes së kompetencave të përmbauesve profesionalë dhe noterëve. Megjithatë, shkaku kryesor për zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjydhura është shkalla e lartë e lëndëve të zgjidhura në gjykatat themelore në tre vitet e fundit (deri në 170% në vitin 2011), si rezultat i disiplinës së zmadhuar procedurale dhe përcjelljes së punës të gjykatësve individualë. Vetëm Gjykata Supreme dhe Gjykata Administrative edhe më tutje vazhduan të grumbullojnë lëndë të pazgjydhura në vend që gradualisht t'i zvogëlojnë dhe duhet të përkushtohet vëmendje urgjente në ndarjen përkatëse të resurseve njerëzore me qëllim që të zgjidhet ky problem. Përderisa përmirësimi i efikasitetit në jurisprudencë është arritur e konsiderueshme, duhet të kihet kujdes që cilësisë së jurisprudencës t'i jepet prioritet i lartë në mënyrë të barabartë. Si rezultat i reformave të konsiderueshme të jurisprudencës në periudhën ndërmjet vitit 2004 dhe 2010 për momentin nuk ekziston strategji gjithpërfshirëse për reforma në jurisprudencë, as plan aksional. Këshilli gjyqësor buxhetor e përfundoi projektin për përcaktimin e çmimit në procedurë gjyqësore me qëllim që të vendosen resurse njerëzore dhe buxhetore që u nevojiten gjykatave nacionale. Metodologjia për statistikën gjyqësore nga viti 2011 ende nuk zbatohet në mënyrë sistematike dhe ende nuk ka trajnim përkatës ose ngritje të vetëdijes ndërmjet gjykatave për atë se si t'i shfrytëzojnë veglat e reja statistikore. Strategjia 2011 – 2013, me të cilën përcaktohet numri i gjykatësve dhe prokurorëve nuk përmban asnjë analizë që do të informojë për menaxhimin ose ndarjen e resurseve ekzistuese që të arrihet efikasitet më i madh përmes rrjetit të gjykatave, e as që i projekton nevojat e ardhshme në aspekt të indikatorëve të qartë të konfirmuar. Strategjia IT për gjyqësinë ngelet që të zbatohet dhe përhapet plotësisht në prokurori. Nevojiten përpjekje, ose të përmirësohet zbatimi i strategjive individuale, ose të zhvillohet strategji gjithpërfshirëse që do t'i bashkojë të gjitha strategjitë në mënyrë koherente dhe do të fokusohet në sfidat tjera në kuadër të sektorit gjyqësor. Këshilli për reforma në jurisprudencë duhet ta intensifikojë punën e vet dhe të ndërmerr udhëheqësin në përkufizimin e kornizës së re strategjike për vazhdimin e reformave në jurisprudencë.

*Përgjithësisht*, në lidhje me jurisprudencën, ekzistojnë masa ligjore dhe institucionale mbrojtëse, por nevojiten përpjekje plotësuese që do ta garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë në praktikë. Është arritur përparim në zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjydhura. Nevojiten përpjekje plotësuese që të krijohen baza të qarta dhe transparente, të cilat do të sigurojnë procedura proporcionale për shkarkim dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme do ta përmirësojnë zbatimin e emërimit të gjykatësve në bazë të meritave dhe zhvillimit në karrierë.

Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë duhet të përkrahet në mënyrë plotësuese, në rolin e vet kyç në zhvillimin e shërbimit të prokurorisë dhe gjyqësisë në mënyrë profesionale dhe me kualifikim të lartë.

*Politika kundër korrupsionit (Shih edhe Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe te drejtat*

*themelore)*

U bënë ndryshime plotësuese në kornizën ligjore. Janë bërë ndryshime të Ligjit për financimin e partive politike dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave me të cilët u përmirësua kontrolli dhe autorizimet përmbareuese të organeve kompetente. Programet e reja shtetërore për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit dhe për parandalimin dhe zvogëlimin e konfliktit të interesave u miratuan nga ana e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), së bashku me Planin akional përkatës për vitin 2011 – 2015. Megjithatë, përgatitja e dobët për hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për procedurë penale ishte shtyerje e mëtutjeshme në zbatimin e tij, me ç'rast tani pas hyrjes së tij në fuqi u shty deri në dhjetor 2013.

Dënime më të rrepta për vepra penale të lidhura me korrupsionin u shqiptuan nga ana e gjykatave në krahasim me vitin 2010. Megjithatë, vetëm në disa raste ka urdhëresë për sekuestrim dhe konfiskim të pronës. Dosja e hetimeve, persekutimeve dhe akuzave, duke përfshirë edhe përdorimin e plotë të mjeteve në dispozicion për detyrim dhe teknikave të veçanta hetuese duhet të përcaktohet në të ardhmen. Kapaciteti i përgjithshëm i jurisprudencës që të ballafaqohet me rastet e korrupsionit mbetet i dobët. Vetëm kundër një numri të vogël të rasteve të korrupsionit në nivel të lartë është mbajtur procedurë dhe pothuajse të gjithë mbesin në sistemin gjyqësor edhe pas shumë viteve, pasi janë kthyer në rigjykim në bazë të ankesës, për shkak të shqyrtimit jo përkatës të dëshmive nga ana e gjykatës në shkallë të parë.

Ligji për financimin e partive politike u ndryshua në muajin tetor 2011, që ta përforcojë sistemin e kontrollit për financimin e partive dhe fushatave zgjedhore. Megjithatë, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) mbetet dobët i pajisur që t'i kryejë funksionet e veta të reja në përputhje me legjislacionin. Zbatimi i rregullave për financimin e partive duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme, veçanërisht nëse merren parasysh rekomandimet e GREKO-s. ESHR-ja deri më tani zbatoi revizion të 11 raporteve financiare të partive politike dhe ende nuk është zbatuar revizion i raporteve për vitin 2011. Enti nuk ka ndërmarrë masa kundër asnjë partie politike për shkeljen e obligimit për njoftim edhe pse ka pranuar raporte financiare prej vetëm 16 nga gjithsej 40 parti të regjistruara në vitin 2011.

Pas zgjedhjeve në vitin 2011, në muajin maj Gjykata e Apelit e vërtetoi aktgjykimin e liderit të apertisë opozitare që u dënua me dënim me burg prej 5 vjetësh për financimin e fushatës zgjedhore dhe keqpërdorimin e pozicionit. Me këtë u ngritën çështje në lidhje me selektivitetin.

Numri i nëpunësve policorë për të cilët u ngritën procedura disiplinore mbetet i pandryshuar, ndërsa Drejtoria Doganore e përforcoi sistemin e vet të kontrollit të brendshëm, duke e dyfishuar numrin e procedurave kundër nëpunësve doganorë.

Korrupsioni në furnizimet publike edhe më tutje mbetet problem serioz. Korniza institucionale dhe masat e ndërmarra mbesin të paaftësuar për zgjidhjen efikase të këtij fenomeni. Nevojitet përmirësim plotësues i legjislacionit ekzistues për ballafaqim me rreziqet nga korrupsioni dhe zmadhimi i transparencës në furnizimet publike. Sistemi për kontroll të brendshëm në administratën qendrore dhe lokale mbetet i dobët. Mekanizmat efektive të "pëshpëritjes" në sektorin publik dhe privat duhet të përcaktohen në të ardhmen.

Ekzistojnë disa akuza penale për keqpërdorim të furnizimeve publike.

Ekziston mungesë e analizave për korrupsion dhe mënyrave për zgjidhjen e tij.

Nevojitet që në mënyrë plotësuese të përforcohet bashkëpunimi operativ dhe këmbimi i informatave ndërmjet institucioneve. Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjeve nga ana e ESHR-së, KSHPK-së dhe institucioneve tjera është i penguar nga mungesa e çfarëdo qoftë sistemi të koordinuar të ndjekjes, në lidhje me rezultatin e atyre kundërvajtjeve dhe procedurave penale që kanë filluar. Sistemi statistikor për përcjelljen e politikave antikorrutive nuk është i zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme. Vetëdija publike në lidhje me antikorrupsionin mbetet e dobët. Mjetet për sigurimin e veprimeve efektive kundër korrupsionit mbeten të pamjaftueshme.

*Përgjithësisht*, ekziston kornizë ligjore dhe kapacitetet janë të përforcuara në mënyrë të pakonsiderueshme, por nevojiten përpjekje më të mëdha në lidhje me zbatimin e ligjeve ekzistuese. Janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e kapaciteteve për verifikim edhe të autorizimeve përmbarese të organeve. Megjithatë, është arritur progres i vogël në lidhje me rezultatet përfundimtare. Në të ardhmen duhet të themelohet evidencë për menaxhim me rastet e korrupsionit në nivel të lartë. Nevojitet shkallë më e lartë e proaktivitetit dhe koordinimit nga ana e trupave për supervizion dhe organeve për zbatimin e ligjit. Duhet të përmirësohet grumbullimi dhe analizimi i të dhënave statistikore për orientim të përpjekjeve ku është më e nevojshme. Korrupsioni mbetet i shpërndarë në shumë sfera dhe vazhdon të paraqesë problem serioz.

## **2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave (Shih Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore)**

*Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*

Është arritur përparim në lidhje me **instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**, me ratifikimin e Konventës së reviduar Sociale të Evropës dhe Konventës për të drejtat e personave me nevoja të posaçme të KB-së me Protokollin përkatës fakultativ. Ende nuk është ratifikuar Konventa Evropiane për gjuhë rajonale ose të pakicave.

Gjatë periudhës raportuese, **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (GJEDNJ) miratoi shtatë aktgjykime gjyqësore se Republika e Maqednisë i ka shkelur të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjithsej 341 aplikime të reja u paraqitën në GJEDNJ-në deri në muajin shtator 2011, duke e rritur numrin e aplikimeve të pazgjidhura të përgjithshme në 969.

Është bërë progres i kufizuar në lidhje me **avancimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut**. Janë bërë përpjekje që të përforcohet zbatimi i kornizës ligjore dhe të rritet numri i të punësuarve në institucione. Avokati i Popullit ende ka nevojë për mandat të plotë që t'i avancojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut në përputhje me Parimet e Parisit.

*Të drejtat civile dhe politike*

Mekanizmi nacional parandalues i Zyrës së Avokatit të Popullit mbetet vegël e rëndësishme për **pengim të torturës dhe sjelljes degraduese**. Sektori i kontrollit të brendshëm dhe standardeve profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme në mënyrë plotësuese e përmirësoi profesionalizmin e punëtorëve të vet dhe vazhdon me ndjekje të rregullt të punës policore; megjithatë, rezultatet mbesin të kufizuara. Janë bërë përpjekje për zmadhimin e njohjes së standardeve evropiane tek nëpunësit policorë dhe për zbatimin e masave mbrojtëse kundër sjelljes degraduese në stacionet policore. Në praktikë, mbesin zbrazëtira në lidhje me

zbatimin e masave formale mbrojtëse kundër sjelljes degraduese, duke përfshirë edhe strategjinë për tolerancë zero për sjelljen degraduese. Dobësitë në sistemin e ankesave dhe sistemin e lidhur të grumbullimit të të dhënave ende shqetësojnë. Janë bërë përpjekje për përmirësimin e procedurave për dhe raportin ndaj personave të arrestuar, duke përfshirë edhe Planin aksional për renovim të objekteve për paraburgim; megjithatë, kushtet në një numër të madh të objekteve mbesin nën standardet e kërkuara.

Nuk kishte përgjigje të rekomandimit të Parlamentit Evropian nga viti 2007 për ndjekje në rastin e Kaled el Masrit për paraburgimin jashtëgjyqësor ireal.

Ka përparim të caktuar në lidhje me **sistemin e burgjeve**. Vazhdon rikonstruktimi i burgjeve dhe trajnimi i nëpunësve të burgjeve. Janë miratuar procedura standarde për menaxhim dhe vlerësim të rrezikut. Megjithatë, sistemi i burgjeve seriozisht mbetet pa mjete të mjaftueshme financiare dhe pa numër të mjaftueshëm të punëtorëve. Menaxhimi i keq, kushtet e këqija materiale, mbrojtja e kufizuar shëndetësore, mungesa e arsimit dhe aktiviteteve për rehabilitim, veçanërisht për të miturit, si dhe mungesa e mekanizmave të inspektimit të pavarur për ballafaqim me shkeljet dhe ndëshkimin e kryerësve edhe më tutje krijojnë shqetësim. Stërngarkimi vazhdon me mesatare prej 20%.

**Qasja në drejtësi** shënon trend pozitiv në sigurimin e ndihmën juridike përmes këshillimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në 24 nga 85 qytetarë përgjithësisht. Azilkërkuesit gjithashtu janë të pranueshëm për ndihmë juridike.

Progres i caktuar është arritur në sferën e **lirisë së të shprehurit** dhe mediet. Përgjithësisht ekziston kornizë e plotë kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e lirisë së të shprehurit. Dialogu në tryezën e rrumbullakët ndërmjet Qeverisë dhe Shoqatës së Gazetarëve u tregua si forum i rëndësishëm për zgjidhjen e sfidave kyçe të lidhura me mediet. U nënshkrua Memorandum për mirëkuptim, që nxjerrë në pah pesë sfera për të cilat duhet të diskutohet, duke përfshirë edhe dekriminalizimin e shpifjes dhe "ofendimit", përforsimin e servisit radiodifuziv publik, transparencën e reklamimit qeveritar dhe përmirësimin e respektimit të standardeve profesionale të gazetarëve dhe redaktorëve. Në shtator 2012, Qeveria miratoi Propozim – ligj të ri për përgjegjësinë civile për ofendim dhe shpifje të orientuar drejt harmonizimit me parimet relevante të GJEDNJ-së. Kodi penal duhet të rendohet në përputhje me këtë qasje. U zbatuan trajnime në sferën e jurisprudencës për nenin 10 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe u përkthyen aktgjykimet kyçe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nevojiten përpjekje plotësuese që do të garantojnë se këto standarde do të zbatohen në mënyrë konsekuente. Gjithashtu, duhet të përforsohen standardet profesionale në gazetari. Njëkohësisht, ekziston shqetësim i vazhdueshëm për mungesë nga pluralizmi dhe autocensura. Për momentin nuk ka trup autorregullativ aktiv për mediet.

Këshilli për Radiodifuzion e përmirësoi dojen e vet për zbatim në lidhje me përqendrimin ilegal të pronësisë dhe konfliktit të interesave dhe nga shumë kanale televizive kërkoi t'i ndryshojnë strukturat e veta të pronarëve. Këshilli për Radiodifuzion gjithashtu, ia hoqi licencën kanalit televiziv TV A2, me arsyetim se përmbajtja programore nuk është në përputhje me kërkesat e licencës. Këshilli Radiodifuzion duhet të tregojë se vijon qasje jodiskriminuese dhe transparente. Vazhdon shqetësimi se një pjesë e madhe nga fuhatat reklamuese të financuara nga Qeveria janë të orinetuara drejt medieve që e përkrahin Qeverinë. Inspektorati

Shtetëror i Punës duhet të vazhdojë t'i zbatojë të drejtat e punonjësve medialë që të sigurojë siguri në vendin e punës dhe pavarësi.

**Liria e grumbullimit dhe bashkimit** është siguruar përgjithësisht. Nuk kishte raste të keqpërdorimit të legjislacionit ose regjistrimeve të ndaluara.

Strategjia e re për bashkëpunim me shoqërinë civile (2012-2017) dhe Plani aksional (2012 – 2014) u miratuan në qershor 2012. Në strategji është propozuar Këshilli për bashkëpunim me shoqërinë civile, ndërsa korniza juridike – obligative do t'i standardizojë rregullat për financimin shtetëror të organizatave të shoqërisë civile. Strategjia e re ka për qëllim të sigurojë se të gjitha masat e bartura nga strategjia paraprake implementohen. Në përgatitje të strategjisë së re u vërejt pjesëmarrje e gjerë.

Komisioni qeveritar për statusin e interesit publik, i formuar në shtator 2011, në të ardhmen duhet të bëhet plotësisht operativ. Legjislacioni tatimor ende nuk është në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione, duke e parandaluar qasjen në beneficionet tatimore dhe llojet e caktuara të aktivitetit ekonomik. Sistemi për ndarje të financimit shtetëror të organizatave civile duhet të përmirësohet dhe standardizohet. Organizatat e shoqërisë civile në masë të madhe mbesin të pavarura nga financimi i jashtëm. Sistemet ekzistuese qeveritare për implementimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile duhet të përforcohen edhe më tutje, duke i përfshirë bashkëpunimin me Seksionin e OJQ-ve në Sekretariatit e Përgjithshëm. Nuk janë ndërmarrë masa që të zhvillohet shoqëri civile në sferat rurale dhe/ose në nivel komunal. Njësitë e vetadministrimit lokal nuk kanë mjaft kapacitet në këtë sferë që të sigurojnë bashkëpunim të standardizuar dhe financim të organizatave lokale të shoqërisë civile.

Ligji i ri për lustrim i miratuar në qershor e zëvendëson ligjin paraprak i cili u kontestua dy herë nga ana e Gjykatës kushtetuese. Periudha e përfshirë me ligj shkon më larg se viti 1991, si edhe në ligjet paraprake. Përveç kësaj, ligji i ri mundëson publikimin e emrave të bashkëpunëtorëve të mëparshëm të shërbimeve sekrete, si dhe të dëshmimeve shoqëruese. Përfshirja e zbatimit përfshin gazetarë, akademikë, bartës të funksioneve publike në të kaluarën, anëtarë të organizatave civile dhe individë të cilët kanë fituar gjatë kohës së procesit të privatizimit. Shqetësimi u rrit rreth proporcionalitetit dhe kushtetutshmërisë së Ligjit.

Në lidhje me lirinë e **mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit**, edhe dy subjekte fetare janë regjistruar sipas Ligjit për statusin juridik të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, me çka numri total ka shënuar rritje në 30. Dy aplikime për regjistrim u refuzuan. Bashkësia e Bektashinjve nga Tetova ende nuk është regjistruar. Bashkësia e Bektashinjve parashtroi ankesë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të lidhura me kthimin e pronës.

*Përgjithësisht, të drejtat civile dhe politike* gjerësisht respektohen dhe është arritur përparim i caktuar i mëtutjeshëm. Reforma rrjedhëse e sistemeve të burgjeve duhet të vazhdohet. Përpjekje të rëndësishme nevojiten që të përmirësohet menaxhimi me burgjet, veçanërisht për të miturit. Dialogu ndërmjet Qeverisë dhe gazetarëve për çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit është thelluar. Qeveria miratoi propozim për dekriminalizimin e shpifjes përmes Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje. Kodi penal duhet të revidohet në përputhje me këtë qasje. Këshilli radiodifuziv filloi t'i zbatojë dispozitat ligjore kundër përqendrimit të pronësisë dhe konfliktit të interesave me sferën politike. Ka shqetësim të madh për mungesën



e pluralizmit dhe autocensurës dhe Këshilli radiodifuziv duhet të tregojë se e ndjek qasjen jodiskriminuese dhe transparente. Përpjekje të vazhdueshme nevojiten që të zgjidhen sfidat e lidhura siç janë transparenca e reklamave qeveritare dhe të drejtat punëtore të gazetarëve.

*Të drejtat ekonomike dhe sociale (Shih edhe kapitullin 19 – Politika sociale dhe punësimi)*

Sa u përket **të drejtave të femrave dhe barazisë gjinore**, zakonet diskriminuese, traditat dhe stereotipet janë të përhapura gjerësisht dhe i shkelin të drejtat themelore të femrave, veçanërisht të atyre femrave në mjediset rurale. Pjesëmarrja aktive e femrave në jetën politike mbetet e ulët, veçanërisht në nivelin lokal. Femrat gjithashtu janë të përfaqësuara dobët edhe në tregun e punës. Janë zbatuar veprime të caktuara, shumë të kufizuara, që kanë të bëjnë me femrat rome. Institucionet nuk e realizojnë rolin e tyre përkatës në lidhje me sigurimin e integritetit më të mirë të perspektivës gjinore në sferat politike. Nuk ekziston qasje strategjike për zbatimin e strategjive nacionale dhe planeve aksionale.

Përparim i caktuar dhe i kufizuar është arritur në sferën e **të drejtave të fëmijëve**. Ndryshimet e Ligjit për drejtësinë e të miturve parashikojnë të drejta më të mëdha dhe mbrojtje më të mirë të fëmijëve - viktimave dhe vendosin masa të veçanta mbrojtëse për fëmijët - dëshmitarë. Personat profesionalë për drejtësinë e të miturve nga të gjitha institucionet relevante kanë dobi të volitshme nga trajnimet detajore. Përmbledhja e të dhënave statistikore për drejtësinë e të miturve është e përmirësuar. Janë themeluar 11 këshilla komunalë për mbrojtje nga delikuenca e të miturve. Institucionet relevante mbetën të financuara në mënyrë të pamjaftueshme dhe me kapacitet të pamjaftueshëm kadrovik, sa i përket administratës për drejtësinë e të miturve. Duhet të përforcohet menaxhimi dhe koordinimi i procesit të reformave.

Kushtet për paraburgimin e të miturve në stacione policore nuk arrijnë t'i përmbushin kërkesat ligjore. Ndihma juridike falas nuk u siguroi sistematikisht për të miturit. Nuk funksionin programi për dëshmipërbim të viktimave të mitur. Situata në institucionin edukativ – përmirësues në Veles mbetet çështje e shqetësimin serioz, veçanërisht në lidhje me trajtimin e të miturve në pjesën e mbyllur, sigurimin e mbrojtjes së jashtme shëndetësore, shërbimeve edukative dhe rehabilituese. Numri i kuadrove të specializuara si psikologë dhe punëtorë socialë mbetet i pamjaftueshm.

Parandalimi, mbrojtja, shërbimet sociale në terren ende nuk kanë resurse financiare dhe njerëzore të mjaftueshme, veçanërisht në lidhje me fëmijët me nevoja të posaçme, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzojnë lëndë narkotike dhe fëmijët që janë viktimave të dhunës familjare, abuzimit seksual ose trafikimit me fëmijët.

Përparim i caktuar dhe i kufizuar mund të vërehet në trajtimin e personave të cenueshëm socialë dhe/ose personave me aftësi të kufizuara. U ratifikua Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet sociale ngadalë deinstitutionalizohen, kurse shoqëria civile ngadalë e përmirëson sigurimin e saj të shërbimeve të mbrojtjes sociale. Sidoqoftë, decentralizimi fiskal dhe administrativ i shërbimeve sociale është ende i kufizuar. Është i ngadalshëm zbatimi i politikave të miratuara. Duhet të adresohen kushtet e këqija materiale dhe trajtimi çnjerëzor dhe degradues në institucionet psikiatrike. Integriteti social i personave me aftësi të kufizuara është shumë i kufizuar. Shkalla e varfërisë mbetet shumë e lartë.

Ekziston një përparim i caktuar në sferën e **politikës antidiskriminuese**. Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi u bë anëtar-vëzhgues i Rrjetit evropian për trupat për barazi.

Ai ishte aktiv në shqyrtimin e ankesave, kryesisht në fushën e marrëdhënieve të punës, sigurimit social, gjyqësisë dhe administratës. Kapaciteti i përgjithshëm i Komisionit mbetet i dobët, ndërsa edhe nivelet e tij të dukjes, dhe qasjes ndaj publikut janë të ulëta. Vetëdija publike për nevojën e mosdiskriminimit është shumë e kufizuar. Ligji për mosdiskriminim mbetet plotësisht në përputhje me *acquis*; është lënë anash ende diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Komuniteti i lesbikeve, gej, biseksualëve dhe transeksualëve (LGBT) vazhdon të jetë objekt i diskriminimit dhe stigmatizimit.

Ekziston përparim në lidhje me të **drejtat e punëtorëve dhe sindikatave**. Këshilli Ekonomik dhe Social (KES) vazhdimisht vazhdon të mblidhet. KES ra dakord për rrogën minimale, kurse Kuvendi miratoi Ligjin për rrogën minimale. U sigurua trajnim për personat relevantë për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës dhe për negociuesit dhe ndërmjetësuesit. Dialogu social dypalësh mbetet i dobët, veçanërisht në sektorin privat. Kapaciteti i partnerëve socialë mbetet i dobët, sepse sindikatat kanë një mungesë të kapaciteteve të qëndrueshme financiare dhe kapaciteteve të menaxhimit.

Ekziston përparim në aspektin e **të drejtave të pronësisë**. Procesi i kthimit të pronës së konfiskuar gjatë Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë rezulton me zgjidhje të 30.744 rasteve të paraqitura në periudhën nga maji i vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2007. Afër 10% e vendimeve të miratuara janë zgjidhur në instancë të dytë ose nga Gjykata Administrative. Prona e cila nuk mund të kthehej u kompensua në formë të fletobligacioneve, kurse 11 lëndë në vlerë prej 301 milionë euro u zgjidhën në periudhë prej vitit 2001-2011. *Përgjithësisht*, ekziston progres i caktuar në përf forcimin e të drejtave sociale dhe ekonomike. Institucionet maqedonase kanë rol proaktiv lidhur me të drejtat e fëmijëve, veçanërisht drejtësinë e të miturve dhe fëmijëve nga rruga. Dialogu social u zhvillua përmes Këshillit ekonomik social. Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është angazhuar në shqyrtimin e ankesave edhe pse resurset e tij janë të kufizuara. Ligji për mosdiskriminim duhet plotësisht të harmonizohet me *acquis*, veçanërisht lidhur me diskriminimin në bazë të përcaktimit seksual. Nevojitet mbrojtje më e mirë e të drejtave të femrave, përfshirë ato të grupeve të cenueshme, si dhe përpjekje e mëturshme për zmadhimin e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës dhe në jetën politike. Integrimi social i personave me nevoja të veçanta mbetet i dobët.

#### *Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat kulturore*

Në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012, kishte incidente dhe vrasje të shumta në vend, të cilat sollën zmadhimin e tensionit ndëretnik dhe protesta publike. Qeveria u përgjigj në mënyrë të qetë dhe të matur. Liderët politikë gjithashtu dhanë deklaratat duke thirrur në maturi dhe respekt të ndërsjellë. Kjo qasje duhet të vazhdojë me qëllim që të shmanget politizimi i incidenteve. Është esenciale që organet gjyqësore dhe organet për zbatimin e ligjit të kryejnë hetime rigorozë dhe objektive me qëllim që të sigurohet se autorët e çfarëdo krimi të bërë u nxorën para drejtësisë.

Shqyrtimi i zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit ka filluar nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit (SIMKO), ndërsa Qeveria miratoi raport, për herë të parë nga nënshkrimi i Marrëveshjes. Raporti i mbulon të gjitha aspektet e Marrëveshjes, duke treguar ku ekziston progres dhe duke i theksuar sfidat kryesore. Raporti siguron mjet kryesor për përf forcimin e dialogut ndëretnik. Shqyrtimi duhet të vazhdojë, ndërsa rekomandimet duhet të përcillen në mënyrë konkrete.

Marrëdhëniet në Qeveri janë nën ndikimin e pikëpamjeve të ndryshme lidhur me statusin e viktimave të konfliktit nga viti 2001. Partnerët e koalicionit duhet ta vazhdojnë dialogun e tyre me qëllim që të gjinden zgjidhje dhe të sigurohet stabilitet. Komisioni për Punë dhe Politikë Sociale vazhdon të diskutojë për Ligjin për mbrojtësit, i propozuar nga Qeveria, qëllimi i të cilit është sigurimi i përkrahjes viktimave të konfliktit të vitit 2001. Duhet të gjindet zgjidhje e ndërsjellë, që do të mundësojë pajtim, në bazë të raportit të fundit

qeveritar për Marrëveshjen komizë të Ohrit.

SIMK punësoi kuadër të ri. Megjithatë nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për përfundimin e kapacitetit të SIMK.

Agjencia për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, që paraqesin më pak se 20% të popullatës, e zmadhoi prezantimin e saj, për shembull, nëpërmjet forumeve pjesëmarrëse në të cilat merret pjesë me institucione dhe shoqëri tjera civile. Sidoqoftë, Agjencia nuk kishte mundësi të kryejë numër të madh detyrash të saj si rezultat i resurseve të kufizuara.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e përkrahu qasjen në arsim të komuniteteve, për shembull përmes përpilimit të librave shkollorë adekuate. Qasja e arsimit në gjuhët e komuniteteve më të vogla mbetet i pabarabartë si rezultat i numrit të kufizuar të mësuesve të kualifikuar dhe materialeve mësimore.

Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive vazhdon të ekzistojnë në shumë komuna. Sidoqoftë, potenciali i tyre për zhvillimin e dialogut ndërmjet bashkësive në nivel lokal nuk është shfrytëzuar plotësisht.

Ligji për gjuhët vazhdon të zbatohet mirë në Kuvend. Vëllimi i tij zgjerohet që të përfshijë funksionarë të cilët zgjidhen ose emërohen nga Kuvendi. Duhet të vendoset mekanizëm për evaluim dhe monitorim.

Lidhur me Strategjinë për arsim të integruar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, donatorët financuan aktivitete të caktuara, por nuk u nda buxhet shtetëror për zbatimin e Strategjisë. Strategjia në shkolla sipas vijës etnike dhe gjuhësore mbetet e shpërndarë gjerësisht. Ekzistojnë raste të përsëritura të dhunës ndëretnike në shkollat e mesme.

Lidhur me përfaqësimin e drejtë, përfaqësimi i plotë i nëpunësve publikë nga komunitetet joshumicë është i mjaftueshëm dhe mbetet përafërsisht 29%. Sidoqoftë, ndarja nëpër ministri është e pabarabartë, ndërsa përfaqësimi i drejtë i nivelit më të lartë, mbetet i pamjaftueshëm. Disa prej komuniteteve më të vogla, veçanërisht romët dhe turqit, mbeten të përfaqësuar në mënyrë të pamjaftueshme.

Progres i caktuar u arrit lidhur me **romët**. U miratua Strategji për inkluzionin e Romëve 2012-2014, bashkë me planin aksional. Edhe krahas kufizimeve buxhetore, përkrahja financiare për programe për Romët u mbajt në nivelin e viteve 2009 dhe 2011. Vendi kryesoi me Dekadën e inkluzionit të romëve dhe organizoi disa konferenca dhe seminare rajonale. Ai filloi t'i zbatojë konkluzionet operative të seminarit për inkluzionin social të romëve nga korriku i vitit 2011. Programi për ndërmjetësit shëndetësorë të Romëve filloi në 16 komuna. Kërkesat për legalizimin e shtëpive pa leje u parashtruan në komunat në pajtim me legjislacionin, ndërsa procesi është në vijim e sipër. U hapën qendra të reja për romët, me qëllim që t'i kushtohet vëmendje problemit të personave pa dokumente. Vazhdojnë së realizuari projektet arsimore, ndërsa shkalla e regjistrimit të fëmijëve romë në shkollat e mesme zmadhohet në masë të vogël.

Nuk janë implementuar ndryshimet e fundit legjislative, të cilat synojnë shqyrtimin e përfaqësimit shumë të madh të fëmijëve-romë në shkollat speciale. Qasja në shërbimet themelore shëndetësore mbetet e vështirë. Romët kanë shkallë mbimesatare të mortalitetit të fëmijëve të sapolindur, ndërsa shumë fëmijë nuk janë vaksinuar plotësisht ose aspak nuk janë vaksinuar. Shkalla e lartë e papunësisë vazhdon, ndërsa qasja në ndihmë sociale për të papunësuarit mbetet problematike. Vazhdon diskriminimi i romëve, përfshirë stereotipizimin e vazhdueshëm në mediet dhe rrjetet sociale të Internetit. Femrat-rome dhe romët me nevoja të veçanta ballafaqohen me kushte të këqija jetësore për shkak të diskriminimit të dyfishtë.

Në korrik 2012 kishte 1.162 **refugjatë dhe persona të shpërngulur të brendshëm**

**(PSHBV)** në vend, shumica prej të cilëve janë romë nga Kosova<sup>7</sup>. 257 persona në mënyrë vullnetare janë kthyer në Kosovë dhe Serbi në vitin 2011. Qeveria vazhdoi t'i zbatojë politikat e integritit për refugjatët-romë. U formalizuan qasja në shërbime për shëndetin publik dhe masat e tregut aktiv të punës, ndërsa qasja në banim u përmirësua.

Numri i personave të shpërngulur brenda vendit (PSHBV) u zvogëlua nga 611 në vitin 2012 në 474 në vitin 2011. Shumica e ankesave të parashtruar nga PSHBV kundër shtetit për dëmet nga konflikti i vitit 2011 janë ende para gjykatave.

*Përgjithësisht*, u arrit progres i caktuar në sferën e të drejtave kulturore dhe pakicave. Shqyrtimi i Marrëveshjes kornizë të Ohrit u fillua, i cili përfshinte rekomandime për shqyrtimin e sfidave vijuese. Ky moment duhet të mbahet përmes aktiviteteve konkrete të njëpasnjëshme. Brengë shkaktoi tensioni ndëretnik i krijuar si rezultat i incidenteve të dhunshme. Qeveria u përgjigj me pjekuri dhe nevojitet të sendërtohet me përforsim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve ndëretnike dhe pajtimit. Lidhur me romët, janë marrë disa masa, veçanërisht që të shqyrtohet problemi me personat pa dokumente dhe të integrohen PSHBV dhe refugjatët-romë. Sidoqoftë, zbatimi i strategjive ekzistuese dhe bashkëpunimi ndërinstitucional duhet të përforsohen. Disa institucione që janë të autorizuar t'i nxisin të drejtat e komuniteteve kanë mungesë të resurseve financiare dhe administrative.

### 2.3. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Republika e Maqedonisë vazhdon plotësisht të bashkëpunojë me **Gjykatën penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GJPNJ)**. Nuk ka raste ose ankesa të pazgjidhura që janë në procedurë gjyqësore në Hagë. Nga katër rastet që GJNPJ-ja ua dorëzoi autoriteteve nacionale në vitin 2008, njëri u refuzua nga sistemi gjyqësor vendor, ndërsa tre rastet tjera u refuzuan në vitin 2012, me kërkesë të Prokurorisë publike dhe në bazë të Ligjit për amnisti.

Republika e Maqedonisë ende mban marrëveshje bilaterale për imunitet me SHBA-në, e cila mundëson përjashtimin e qytetarëve të SHBA-së nga kompetenca juridike e **Gjykatës penale ndërkombëtare**. Kjo nuk është pajtim me Pozicionet e përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të romëve ose me principe të ngjashme udhëheqëse të BE-së për marrëveshje bilaterale për imunitet.

**Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** paraqesin pjesë esenciale të progresit të shtetit drejt Bashkimit Evropian. Shteti vazhdon të marrë pjesë aktive në iniciativat rajonale duke përfshirë Procesin për bashkëpunim të Evropës Juglindore (PBEJL), Këshillin për bashkëpunim rajonal (KBR), Marrëveshjen për tregti të lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), Marrëveshjen për themelimin e Komunitetit energjetik dhe Marrëveshjen për Sferën e përbashkët evropiane të aviacionit (ECAA).

Vendi e mori përsipër Kryesimin me PBEJL në qershor 2012. Selia e Sekretariatit të rrjetit shëndetësor të Evropës Juglindore (SEEHN) u themelua në Shkup. Vendi vazhdoi të kontribuojë në misionin EUFOR-ALTEA në Bosnje dhe Hercegovinë.

Republika e Maqedonisë mban rol të plotë konstruktiv lidhur me **marrëdhëniet bilaterale me vendet tjera që janë pjesë e zgjerimit dhe vendet fqinje-anëtare të BE-së**.

Marrëdhëniet me *Shqipërinë* vazhdojnë të zhvillohen me hyrjen në fuqi të marrëveshjeve për udhëtime të ndërsjella të qytetarëve ndërmjet dy vendeve dhe për bashkëpunim, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. U nënshkrua marrëveshje për qendër të përbashkët për shkëmbimin e informatave ndërmjet shërbimeve të tyre përkatëse të policisë kufitare dhe të migrimit.

Marrëdhëniet me *Bosnje dhe Hercegovinën* edhe më tutje mbeten të mira. U nënshkruan disa marrëveshje për bashkëpunim gjyqësor dhe për bashkëpunim në sferat e shëndetësisë dhe arsimit.

Bashkëpunimi me *Malin e Zi* edhe më tutje përforcohet. Marrëveshja për ekstradim hyri në fuqi, njëjtë si edhe marrëveshjet për bashkëpunim ekonomik dhe për procesin e anëtarësimit në BE. U nënshkruan marrëveshje për readmision të personave të cilët qëndrojnë pa leje dhe për bashkëpunim policor.

Marrëdhëniet me *Serbinë* edhe më tutje mbeten të mira. U realizuan vizita të ndërsjella të kryetarëve në dhjetor 2011 dhe në janar 2012, që u përcollën me atmosferë pozitive. U nënshkruan marrëveshje për kushtet e udhëtimit dhe për kompensim për mbrojtje shëndetësore. Nuk ka zhvillim lidhur me kontestin ndërmjet kishave ortodokse të të dy vendeve.

Bashkëpunimi me *Kosovën* vazhdon të zhvillohet me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për rregullimin kufitar të komunikacionit hekurudhor dhe me nënshkrimin e marrëveshjes për kontroll dhe mbikëqyrje të përbashkët kufitar. Patrullat e përbashkëta mbikëqyrëse përgjatë kufirit me Kosovën duhet t'i përkushtojnë vëmendje tregtisë joligjore me mallra dhe migracionit joligjor.

Marrëdhëniet e afërta me *Turqinë* avancohen edhe më tutje në sferën e diplomacisë, ekonomisë dhe kulturës. Hyri në fuqi marrëveshja për komunikacion të përhershëm ajror ndërmjet të dy vendeve.

Vazhdojnë lidhjet e afërta me *Bullgarinë*, veçanërisht në sferën ekonomike. Zhvillimi gjatë periudhës së njoftimit e theksoi nevojën për dialog më të thellë për tejkalimin e keqkuptimeve të mundshme dhe perceptimeve të ndryshme lidhur me çështje në bazë historike, kulturore dhe etnike. Deklaratat e fundit të nivelit më të lartë e vërtetuan vullnetin për vazhdimin e mëtutjeshëm.

Marrëdhëniet me *Greqinë* mbeten të afërta edhe më tutje, veçanërisht në sferën ekonomike dhe turistike. Sidoqoftë, marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve mbeten nën ndikimin e kontestit për emrin. Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë miratoi aktgjykim lidhur me Marrëveshjen e përkohshme me Greqinë. Vendi vazhdoi të angazhohet në bisedime që janë nën patronazhin e KB-së dhe në kontakte të drejtpërdrejta me Greqinë. Bisedimet nën patronazhin e KB-së për zgjidhje të pranueshme reciproke duhet të zhvillohen me energji të zmadhuar, si dhe takimet dhe kontaktet e drejtpërdrejta bilaterale. Duhet të shmangen veprimet dhe deklaratat që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore.

*Përgjithësisht*, Republika e Maqedonisë merr pjesë aktive në bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale me fqinjët e saj. Kontesti me emrin vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet me Greqinë. Është e rëndësishme qasja konstruktive ndaj sfidave me fqinjët.

### **3. Kriteret ekonomike**

Gjatë shqyrtimit të ngjarjeve në sferën e ekonomisë në Republikën e Maqedonisë, Komisioni udhëhoq nga konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë nga qershori i vitit 1993, në të cilat theksohet se anëtarësimi në BE imponon ekzistimin e ekonomisë funksionale të tregut dhe kapacitetit për ballafaqim me presionin konkurrues dhe forcat tregtare në BE.

#### **3.1. Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut**

##### *Bazat e politikës ekonomike*

U mbajt konsensus i gjerë për karakteristikat themelore të strukturës së politikës ekonomike të vendit. Korniza afatmesme e politikave u përshkrua në programe të

ndryshime, siç janë Programi i gjashtë ekonomik paraaderues (PEP), i cili përfshin periudhën 2012-2014, Strategjia për tregun e punës për vitin 2015 dhe Plani aksional nacional për punësim për vitet 2011-2013. Në mënyrë plotësuese organet filluan dialogun paraaderues të nivelit të lartë me BE-në, i cili siguroi platformë plotësuese për përshpejtimin e reformave në ekonomi lidhur me aderimin. Vazhdoi bashkëpunimi me IMF, siç janë Banka botërore dhe FMN, edhe pse shqyrtimi i dytë i FMN për aranzhmanin financiar ende nuk mund të kompletohet. Vazhdoi dialogu strukturor me komunitetin e biznesit. *Përgjithësisht*, u mbajt konsensus i gjerë politik për bazat e politikës ekonomike.

#### *Stabiliteti makroekonomik*

Ekonomia u rrit për rreth 3% në vitin 2011, por u zvogëlua për rreth 1% në vit në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012, krahasuar me rritjen përafërsisht prej 5% në gjysmëvjetorin e parë të vitit paraprak. Shpenzimi i qëndrueshëm privat ndihmoi për pengimin e ngadalësimit më të ashpër, ndërsa zvogëlimi i shpenzimit publik kishte kontribut negativ për rritjen. Indikatorët e prodhimit vendor tregojnë ngadalësim të konsiderueshëm vjetor gjatë periudhës për të cilën njoftohet, me prodhim industrial mesatarisht 9% nga tetori i vitit 2011 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. PBV-ja mesatare për kokë banorë u përmirësua në krahasim me mesataren e BE-së duke u zmadhuar nga 35% nga mesatarja e BE-së në vitin 2010 në 36% në vitin 2011. *Përgjithësisht*, aktiviteti ekonomik u ngadalësua nga vjeshta 2011, edhe pse shpenzimi privat dhe investimet mbetën të qëndrueshme duke marrë parasysh rrethin e dobët ndërkombëtar.

Mosbalancimet e jashtme u zvogëluar, por financimi tyre u përkeqësua. Në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012, deficitin i llogarisë rrjedhëse ishte rreth -2.8% nga PBV-ja e vlerësuar vjetore, krahasuar me -3.5% nga PBV-ja në vitin paraprak. Faktori më i rëndësishëm për përmirësim ishte zmadhimi i mëtutjeshëm i transfereve rrjedhëse deri rreth 10% nga PBV-ja e vlerësuar vjetore. Bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve u përkeqësua, duke arritur 12% nga PBV-ja e vlerësuar vjetore, krahasuar me -11% nga PBV-ja në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i të hyrave më të vogla nga eksporti. Teprica e llogarisë kapitale dhe financiare u zvogëlua për nivel të ngjashëm, duke u zvogëluar në rreth 2.6% nga PBV-ja deri në qershor 2012, krahasuar me tepricën prej 4% në vitin paraprak. Të hyrat nga IDH dhe investimet tjera u zvogëluar në rreth 1% nga PBV-ja e vlerësuar vjetore dhe 0.6% nga PBV, krahasuar me 2% nga PBV-ja dhe 4% nga PBV-ja në vitin paraprak. Si rezultat i kësaj, financimi i deficitit në llogarinë rrjedhëse nuk ishte aq i bazuar në të hyrat nga investimet, sa në kreditë e jashtme.

Borxhi i jashtëm bruto u rrit në 61.2% nga PBV-ja në tremujorin e parë të vitit 2012, krahasuar me 59.7% në vitin paraprak. Shkak kryesor për këtë rritje ishte borxhi i jashtëm publik, i cili u rrit për 2.2 pikë përqindjeje nga PBV-ja, ndërsa borxhi privat u zvogëlua për 0.7 pikë përqindjeje. Rezervat e devizave ishin 2.1 miliardë euro (rreth 30% nga PBV-ja) në korrik, krahasuar me 1.8 miliardë euro (29% nga PBV-ja) në vitin paraprak. U përmirësua mbulimi i importit potencial me rezervat, duke pasqyruar jo vetëm zmadhimin e nivelit të rezervave devizore, por gjithashtu edhe importin e pritur të zvogëluar. *Përgjithësisht*, deficitin i llogarisë rrjedhëse u zvogëlua. Megjithatë, financimi i deficitit në masë të madhe u mbështet në huamarrje të jashtme, që solli zmadhimin e bruto borxhit të jashtëm publik.

Papunësia ishte shumë e lartë 31.2% dhe në masë të madhe mbeti e pandryshuar në nivel vjetor në tremujorin e dytë të vitit 2012, ndërsa gjatë dimrit ishte rreth 1 pikë përqindjeje më e lartë sesa në vitin paraprak. Papunësia ishte rreth 1% më e lartë sesa para një viti, por ndikimi i saj mbi papunësinë u kufizua, nga shkak që shumica

e personave të papunësuar me sa duket nuk kanë qenë të regjistruar në tregun e punës. Sektorët kryesorë me rritje të papunësisë në tremujorin e dytë të vitit 2012 ishin arsimi, industria e tekstit dhe shërbimet komunale. Papunësia të rinjtë u zmadhua, nga 54.6% në tremujorin e dytë të vitit 2011 në 54.9% në tremujorin e dytë të vitit 2012. Të rinjtë janë rreth 10% të fuqisë së punës, por pjesëmarrja e tyre e papunësisë u zmadhua prej 18.5% në tremujorin e dytë të vitit 2011 në 18.8% në tremujorin e dytë të vitit 2012. Papunësia ndërmjet më pak të arsimuarve, që përbëjnë përafërsisht 30% të fuqisë së punës u zvogëlua, nga 39% në tremujorin e dytë të vitit 2011 në 36% në tremujorin e dytë të vitit 2012. Punësimi në sektorin publik u zmadhua për rreth 1% në nivel vjetor, kryesisht në sektorin e arsimit. Megjithatë, si pjesëmarrje në papunësinë e përgjithshme, pjesëmarrja e papunësisë në sektorin publik u zvogëlua prej 22% në gjysmëvjetorin e vitit 2011 në 21% në gjysmëvjetorin e vitit 2012. *Përgjithësisht*, gjendja e tregut të punës mbetet e dobët. Papunësia mbetet shumë e lartë, veçanërisht te personat e rinj dhe te personat më pak të arsimuar.

Politika monetare në mënyrë të kujdesshme e përkrahu rimëkëmbjen graduale, ndërsa politika e kursit devizor mbeti e orientuar në mbajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe *de facto* lidhjen me euron. Banka qendrore e zvogëloi shkallën e saj referuese të kamatës, nga 4% në 3.7%. Me qëllim që të përkrahen aktivitetet e kreditimit të sektorit financiar, Banka qendrore i ndryshoi rregullat për kërkesat për rezervën dhe kolateralen minimale. Ajo gjithashtu futi numër të madh masash për stimulimin e aktivitetit të tregut financiar, siç janë krijimi i instrumenteve monetare, depozitë e re në disponim brenda natës dhe depozita në disponim për 7 ditë, repoankande dhe me zvogëlimin e shkallës së kamatës ndërmjet shkallëve të depozitave brenda natës dhe bonave të thesarit të Bankës Qendrore. *Përgjithësisht*, politika e kursit devizor dhe politika monetare mbetën stabile.

Inflacioni ishte në mënyrë të konsiderueshme më i ulët në krahasim me vitin paraprak, me shkallë mesatare të inflacionit në tetë muajt e parë të vitit 2012 nga 2.4% në krahasim me 4.4% në periudhën e njëjtë para një viti. Megjithatë, gjatë muajve të fundit, presioni i inflacionit u zmadhua. Burimet kryesore të zmadhimit qëndrojnë në çmimet më të larta të energjisë, por gjithashtu edhe në zmadhimin e çmimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të qiramarrjes. Çmimet e ushqimit dhe pijeve janë rreth 40% nga shporta e shpenzimit. Inflacioni bazik, që e përjashton ndikimin e çmimeve të energjisë dhe ushqimit mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve, mbeti stabil dhe nën 2%.

Deficiti i publikuar i pushtetit qendror për vitin 2011 ishte në pajtim me qëllimin për 2.5% nga PBV-ja. Të hyrat, që janë rreth 30% nga PBV-ja, ishin rreth 7.5% më të ulëta sesa ato të priturat. Me qëllim që të përmbushet qëllimi lidhur me deficitin, shpenzimi u zvogëlua për rreth 7%, kryesisht për blerje të mallrave dhe shërbimeve, të cilat u mbajtën rreth 19% nën qëllimin e tyre në buxhetin fillestar. Investimet kapitale, gjithashtu, u mbajtën rreth 16% në nivel më të ulët nga ato të planifikuara. Prapëseprapë, si pjesëmarrje në PBV-në shpenzimet kapitale u zmadhuan, nga 3.5% në vitin 2010 në 3.8% në vitin 2011, ndërsa shpenzimet e përgjithshme u zvogëluan nga 32.0% të PBV-së në 31.2%. Në vitin 2012, të hyrat mbetën nën shkallën e paraparë dhe u zvogëluan për 3% në shuma reale. Që të kompensojnë për mungesën, organet miratuan rebalanc të buxhetit dhe e zmadhuan deficitin për vitin 2012 nga -2.5% të PBV-së në -3.5%. Deri tani, sfera kryesore e zvogëlimit të shpenzimeve ishin shpenzimet kapitale, të cilat në korrik ishin rreth 1.8% nga PBV-ja e vlerësuar vjetore, krahasuar me 2.4% në vitin paraprak. Në shtatë muajt e para të vitit 2012, të dhënat e publikuara tregojnë deficit prej rreth 2% të PBV-së së vlerësuar vjetore, që paraqet nivel të ngjashëm si viti paraprak. Raporti i borxhit shtetëror u zmadhua në rreth 30% të PBV-së në korrik të vitit 2012, krahasuar me rreth 25% në

vitin paraprak, kryesisht për shkak të huamarrjes së zmadhuar vendore. Edhe krahas obligimeve ekzistuese ligjore, as strategjia fiskale dhe strategjia për borxhin publik, as Programi për investimet publike ende nuk janë azhurnuar për periudhën 2012-2014. Edhe më tutje, organet nuk parashtruan njoftim fiskal, që duhet të përmbajë të dhëna të pushtetit qendror në format të krahasueshëm me standardet e BE-së.

Vazhdoi decentralizimi fiskal. Deri në mesin e vitit 2012, 84 prej 85 komunave kaluan në fazë të dytë të decentralizimit. Më tutje, u zmadhua pjesëmarrja e komunave në ndarjen e të hyrave. Ende duhet të përforcohet efikasiteti i njësive lokale kompetente për menaxhimin financiar, me përmirësimin e menaxhimit dhe kompetencave, me sigurimin e nivelit adekuat të ekipimit kadrovik dhe me shkurtimin e procedurave administrative.

Politika fiskale mbetet e orientuar në plotësimin e qëllimeve të deficitit, edhe pse për shkak të të hyrave më të vogla nga atë të priturat, qëllimi fiskal duhet të ngritet në vjeshtë të vitit 2012. Planifikimet dhe realizimet buxhetore u përkeqësuan dhe cilësia e shpenzimit publik vazhdon të jetë në nivel të ulët. Procesi buxhetor vazhdon të ballafaqohet me vlerësime tepër optimiste për të hyrat, mungesë të planifikimit afatmesëm, vendime për shpenzim afatshkurtër dhe përkeqësimin e menaxhimit të shpenzimit publik, që rezultojnë në zmadhimin e borxheve të pashlyera, transparencë të zvogëluar të vendimeve për shpenzim dhe zvogëlim të autenticitetit të llogarive të sektorit publik. Kjo jo vetëm që i bën të paqarta informatat për pozicionin fiskal të vendit, por gjithashtu ka edhe efekte anësore negative mbi gjendjen lidhur me likuiditetin e sektorit privat.

*Përgjithësisht*, politika vazhdon të jetë e orientuar në stabilitet. Kushtet monetare ishin në drejtim të përkrahjes së rritjes, duke pasur parasysh politikën në vend *de facto* për lidhjen e denarit me euron. Shpenzimi publik në masë të madhe ishte në pajtim me të hyrat. Megjithatë, planifikimi buxhetor dhe menaxhimi me shpenzimet publike në mënyrë të konsiderueshme u përkeqësuan dhe cilësia e shpenzimit publik mbeti e dobët. Papunësia vazhdon të jetë shumë e lartë, veçanërisht te personat e rinj, që paraqet sfidë kryesore për politikën. Rreziqet makrofiskale janë kryesisht të lidhura me shokime të jashtme, siç është zvogëlimi i mëtutjeshëm i kërkesës së jashtme, çmimet më të larta të importit dhe/ose zvogëlimi i transfereve rrjedhëse.

#### *Veprimi i ndërsjellë i fuqive të tregut.*

Privatizimi në masë të madhe ka përfunduar dhe ekonominë kryesisht e lëvizin fuqitë e tregut. Roli i sektorit privat në mënyrë të pakonsiderueshme u zmadhua nga 82% nga vlera e përgjithshme e shtuar në vitin 2010 në 82.4% në pranverë 2012, kryesisht si rezultat i zmadhimit të vlerës së shtuar në ndërtimtari dhe tregti. Qeveria miratoi disa vendime të cilat e zmadhuan rolin e shtetit në ekonomi, siç janë pajtimi për zëvendësimin e borxhit për kapital aksionar me disa kompani problematike. Njëkohësisht, programi i qeverisë për shitje të tokës shtetërore krijoi të hyra, por gjithashtu e zvogëloi nivelin e aktivitetit të shtetit. Nuk ishin të suksesshme tentimet për privatizimin e disa prej kompanive në pronësi shtetërore. Përgjithësisht, vlera e aktivitetit të pronës e cila është plotësisht ose pjesërisht e kontrolluar nga ana e shtetit mbetet në masë të madhe e pandryshuar në rreth 13% nga PBV-ja. Pjesa më e madhe e kapitalit shtetëror, përafërsisht 80% është koncentruar në pesë kompani, kryesisht ndërmarrje publike. Sektori publik punëson rreth 20% të fuqisë së punës dhe furnizimet publike janë rreth 11% nga PBV-ja. Pjesëmarrja e çmimeve të administruara dhe të rregulluara në shportën e CPI (Indeksi i kostos së shpenzimit) mbeti i pandryshuar në 13.1%. Çmimet e rregulluara të cilat janë rreth 12% nga shporta e CPI-së, zakonisht i mbulojnë shpenzimet. Megjithatë, çmimet e energjisë elektrike ende janë të çrregulluara si rezultat i humbjeve të vazhdueshme të larta



teknike dhe çmimeve të cilat nuk i mbulojnë shpenzimet. Çmimet e rregulluara, siç janë furnizimi me ujë dhe mënjanimi i hedhurinave që janë rreth 1,4% nga shporta e CPI-se, zakonisht i mbulojnë shpenzimet. *Përgjithësisht*, roli i shtetit në masë të madhe mbeti i pandryshuar dhe i kufizuar.

#### *Hyrje dhe dalje në treg*

Qeveria i vazhdoi përpjekjet e saj për lehtësimin e hyrjes dhe daljes në treg. Megjithatë, pjesërisht për shkak të mjedisit ekonomik ndërkombëtar i cili ofron mjete ndihmëse, numri i kompanive të sapothemeluara u zvogëlua për më pak se nën 10% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve. Qasja e kufizuar e financave ende e pengon rritjen e shumë kompanive, veçanërisht rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Faza e tretë e projektit "gjyqësorë rregullator", e cila fokusohet në zvogëlimin e ngarkesave administrative, u realizua dhe filloi faza e katërt, e cila koncentrohet në masat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Progres plotësues është arritur në pjesën e mbylljes së kompanive të cilat nuk funksionojnë. Në periudhën prej tetori 2011 deri në gusht 2012, numri i procedurave të falimentimit ishte më i lartë për rreth 32% në krahasim me vitin paraprak. U zvogëlua kohëzgjatja mesatare për likuidimin e kompanisë. *Përgjithësisht*, u arrit progres i caktuar plotësues në lehtësimin e hyrjes dhe daljes në treg.

#### *Sistemi juridik*

U vendos sistemi juridik për funksionimin e ekonomisë së tregut në masë të madhe. Në mënyrë praktike përfundoi regjistrimi i pronës së patundshme. Organet miratuan numër të madh reformash për zmadhimin e efikasitetit dhe transparencës së gjykatave, si dhe për përsheptimin e procedurave ligjore. Numri i lëndëve të pazgjydhura në gjykatën e tregut u zvogëlua, nga 5782 në fund të vitin 2011 në 2152 lëndë në mesin e vitit 2012. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mbeti në masë të madhe e pandryshuar. Rreth një e treta e lëndëve u zgjidhën në afat prej tre muajsh, ndërsa rreth 60% në afat prej gjashtë muajsh. Pjesëmarrja e lëndëve të cilat zgjasin më shumë se pesë vite, u zvogëlua në mënyrë plotësuese, nga 1.2% në vitin 2010 në 0.8% në vitin 2011. Edhe krahas procedurave të thjeshtësuara dhe futjes së instrumenteve të reja juridike me të cilat përforcohet disiplina e pagesës, zbatimi i marrëveshjes ende është i vështirë, me çka pengohet mjedisi afarist, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndonjëherë, procesi legjislativ vuan nga diskutimi i pamjaftueshëm me palët e prekura, që shpie në nevojën për ndryshime më të shpeshta të legjislacionit të sapomiratur. Nevojitet përforcim plotësues i zbatimi të legjislacionit ekzistues.

U përforcuan pavarësia juridike dhe financiare dhe disponimi i resurseve të disa organeve rregullatore dhe mbikëqyrëse. Megjithatë, në disa raste, siç është Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital (MAPAS), Komisioni Shtetëror për Ankesa për Furnizime Publike dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, disponimi dhe/ose ndikimi i resurseve njerëzore dhe resurseve IT janë ende të pamjaftueshme. Në mënyrë plotësuese duhet të përmirësohet cilësia e vendimeve të Komisionit për mbrojtje të konkurrencës.

Përcjellja e raporteve të Entit shtetëror për revizion (ESHR) nga ana e Kuvendit është joadekuate dhe mungojnë mekanizma të Qeverisë për ballafaqimin e mangësive të cilat janë të identifikuara në raportet e ESHR.

*Përgjithësisht*, funksionimi i sistemit juridik vazhdoi të përmirësohet gradualisht. Megjithatë, dobësitë lidhur me procedurat e gjata, korrupsionin dhe zbatimin e vështirë të marrëveshjeve vazhdojnë ta pengojnë mjedisin afarist.

## *Sektori financiar*

Rëndësia e sektorit financiar dhe funksioni i tij i ndërmjetësimit u përmirësuan edhe më tutje. Edhe krahas krizës financiare ndërkombëtare, aktivi i sektorit u zmadhua në mënyrë pakonsiderueshme nga 71% të PBV-së në fund të muajit shtator të vitit 2011 në 72% nga fundi i muajit qershor të vitit 2012. Depozitat në masë të madhe mbetën të pandryshuara në rreth 50%. Bruto kreditë u rritën nga 44% të PBV-së në 47%, kryesisht për shkak të kreditimit të zmadhuar nga ana e bankave me madhësi mesatare. Depozitat mbeten burim kryesor i likuiditetit të sektorit, të cilat mbulojnë më shumë se 112% të kredive të pashlyera. Sektori në pjesën më të madhe vazhdon të jetë në pronësi të kompanive të huaja, me 13 nga gjithsej 17 banka në pronësi të huaj. Pjesëmarrja e pronësisë së huaj u rrit në 75% të PBV-së në mesin e vitit 2012, krahasuar me 73% në vitin paraprak. Pjesëmarrja pronësore e shtetit në sektor mbetet e vogël, me rreth 7% nga aktivi i sektorit. Prona kryesore e shtetit përbëhet nga pjesëmarrja e shumicës në bankën e vetme për zhvillim në shtet dhe nga numri i kufizuar i aksioneve tjera pakicë. Koncentrimi i tregut mbetet i lartë, por e njëjta është zvogëluar pak. Aktivat e pesë bankave më të mëdha në krahasim me pjesëmarrjen e tyre në aktivin e përgjithshëm kanë pësuar një rënie të vogël, nga 67% në mesin e vitit 2011 në 66% në mesin e vitit 2012. U bë përmirësim i vogël i efikasitetit të sektorit bankar. Profitabiliteti i sektorit në tërësi u përmirësua në tremujorin e dytë të vitit 2012. Rritja e kredisë u përtëri nga vjeshta vitin e kaluar, duke arritur rreth 8.5% në shtatë muajt e parë të vitit 2012. Shkallët e ponderuara të kamatës në sektorin privat u zvogëluar rreth 8.4% në korrik, ndërsa shkallët e depozitave u zvogëluar pak më shpejtë, në rreth 5%. Si rezultat i kësaj, shtrirja në mënyrë të pakonsiderueshme u përhap në 3.4 pikë përqindjeje. U mbajt stabiliteti financiar, me likuiditet stabil, solvencë dhe përpjesëtim i kapitalit adekuat. Pjesëmarrja e kredive jofunksionale pësoi zmadhim të vogël në rastin e kompanive të mëdha dhe të vogla, ndërsa në rastin e bankave me madhësi mesatare, u përmirësua funksionaliteti i kredive. Raporti mesatar i kredive jofunksionale të sektorit mbeti afër 10% me përmirësime të cilat ende e tejkalojnë shumën e kredive të identifikuara jofunksionale.

Rregullimi i supervizionit në sektorin bankar në masë të madhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare. Rëndësia e ndërmjetësuesve të tregut financiar jobankar vazhdon të jetë e kufizuar, me aktiv i cili është rreth 10% nga aktivi i sektorit financiar ose rreth 8% të PBV-së. Institucionet e sigurimit kanë rreth 4% të aktivitetit të sektorit, ndërsa kompanitë dhe fondet pensionale kanë lizing rreth 3%. Vlera e tregut të kapitalit vazhdon të zvogëlohet në rreth 30% nga PBV-ja.

*Përgjithësisht*, vazhdoi trendi në thellimin dhe zgjerimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar. Megjithatë, niveli i ndërmjetësimit financiar dhe konkurrencës së tregut mbetën në nivel të ulët, duke e kufizuar rritjen më dinamike të sektorit privat, veçanërisht të NVM. Krahas kësaj, trupa të caktuar rregullatorë dhe mbikëqyrës vazhduan ende të pengohen nga niveli i pamjaftueshëm i disponimit të mjeteve dhe ndikimit.

### **3.2. Kapaciteti për ballafaqimin me presionin konkurrues dhe fuqitë e tregut në BE**

*Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut.*

*Përgjithësisht*, është mbajtur stabiliteti makroekonomik. Procedurat për hyrje dhe dalje në treg janë përmirësuar. Janë ndërmarrë hapa të caktuara për përforcimin e sundimit të së drejtës. Megjithatë, deri më tani, masat e tilla ende nuk kanë ndikim të konsiderueshëm. Kualiteti i planifikimit dhe menaxhimit me financat publike u

përkeqësua dhe kualiteti i shpenzimit ngeli i dobët. Papunësia ngelet shumë e lartë, sidomos në mesin e të rinjve. Rrethi afarist vazhdon të vuajë nga dobësitë institucionale dhe administrative, zbatimi i vështirë i marrëveshjeve dhe korrupsioni.

#### *Dispozicioni i kapitalit njerëzor dhe fizik*

Niveli i dispozicionit të kapitalit njerëzor ende është i ulët. Autoritetet vazhduan ta përmirësojnë infrastrukturën fizike për arsim, ta rrisin numrin e mësimdhënësve dhe t'i modernizojnë programet mësimore. Numri i mësimdhënësve u rrit për 1,5% në vitin shkollor 2011-2012, pas rritjes prej 4,4% në vitin paraprak. Si edhe në vitin paraprak, rritja që kryesisht për punësime plotësuese në shkollat fillore dhe të mesme. Janë ndërmarrë masa për rritjen e shkallëve të regjistrimit, edhe pse në disa sfera kjo politikë u ballafaqua me vështirësi. Mjetet buxhetore për arsimin u rritën në mënyrë marginale në vitin 2011, prej 4,6% nga BPV në vitin 2010 në 4,7% nga BPV, ndërsa për vitin 2012 buxheti parasheh zvogëlim në 4,5% nga BPV. Krahas tentimeve të vazhdueshme, niveli i përgjithshëm i arsimit të forcës punuese ende është relativisht i ulët dhe papajtueshmëria e aftësive ende është e konsiderueshme. Ekziston hapësirë e konsiderueshme edhe për përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve publike për arsimin dhe për përmirësimin e kualitetit të arsimit. *Përgjithësisht*, masat për përmirësimin e nivelit të kualifikimit vazhdojnë. Megjithatë, ende niveli i ulët i arsimit, kërkon përpjekje të qëndrueshme të mëtejshme me qëllim të përmirësimit të kapitalit njerëzor në dispozicion në vend.

Dispozicioni i kapitalit në shtet ngelet në nivel relativisht të ulët dhe kualiteti i tij është i penguar me investimin e zvogëluar me dekada më parë. Investimet publike u rritën në afër 3,8% nga BPV në vitin 2011. Megjithatë, ekzistojnë shumë informata të kufizuara për prioritetet e tanishme të konsumit. Bruto akumulimi i kapitalit ishte ende i lartë në afër 36% nga BPV në tremujorin e fundit të vitit 2011, por u zvogëlua në 22% në tremujorin e parë të vitit 2012. Autoritetet nuk sigurojnë të dhëna të shpejta të veçanta për bruto investimet, të cilat do të mundësonin kuptim më të mirë të faktorëve zhvillimorë pas vendimeve për investim. Hapa të kufizuara të caktuara janë ndërmarrë për përmirësimin e infrastrukturës transportuese të shtetit. Gjendja e investimeve të huaja u rrit prej 51,5% nga BPV në mesin e vitit 2011 në 53% në mesin e vitit 2012. Përgjithësisht, shpenzimet për përforcimin e ekonomisë së bazuar në dituri ngelën në nivel të ulët. Përpjekjet për rritjen e kapitalit publik vazhdojnë të pengohen me kapacitetin e dobët për zbatim, por gjithashtu edhe me shfrytëzimin e mjeteve për dedikime më pak produktive, siç është zbukurimi i kryeqytetit. *Përgjithësisht*, kapitali i shtetit ngelet në nivel të ulët.

#### *Struktura e sektorit dhe struktura e ndërmarrjeve*

Nuk ka ndryshime më të mëdha në sferën e ristrukturimit të ndërmarrjeve. Industrinë e rrjeteve janë nën dominimin e një numri shumë të vogël të furnizuesve të tanishëm, që shpesh e minon konkurrencën efikase. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) deri më tani vazhdojnë të jenë grupi më i madh i kompanive, duke siguruar punësim për më shumë se 80% nga të punësuarit në sektorin privat ose përafërsisht 60% nga punësimi i përgjithshëm. Qasja në financa u përmirësua, pjesërisht duke falënderuar mundësitë plotësuese ndërkombëtare kreditore, kryesisht të siguruar nga Banka Investuese Evropiane (BIE). Në mënyrë plotësuese, Qeveria vazhdon me subvencionimin e shpenzimeve kamatarore për kreditë e NVM, edhe pse me vëllim të rënies në buxhetin për vitin 2012.

Sektori joformal, i përkrahur me dobësitë në politikën tatimore dhe politikën e konsumit, si dhe në zbatimin e ligjeve, ngelet sfidë kryesore. Kjo e zvogëlon bazën tatimore dhe suksesin e politikave ekonomike.

*Përgjithësisht*, ndryshimet strukturore ndaj shumëllojshmërisë dhe aktivitetet me vlerë të shtuar më të madhe ngelen të kufizuara. Konkurrenca në industrinë e rritit ngelet e kufizuar me furnizuesit ekzistues dominues. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ende ballafaqohen me vështirësi në qasjen të kapitali dhe tregjet edhe krahas përkrahjes së rritur.

#### *Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën*

Niveli i përgjithshëm i intervenimit shtetëror sistematik është i kufizuar. Të dhënat e arritshme sugjerojnë në nivelin relativisht të ulët të ndihmës shtetërore, që është më pak se 1% nga BPV. Megjithatë, ky numër nuk është i krahasueshëm me të dhënat për ndihmën shtetërore të grumbulluara në pajtim me standardet e BE-së. Është themeluar Komisioni për Mmbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, kualiteti i vendimeve të tij duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohet, ndërsa vetëdija për parashtrimin e raporteve e dhënësve të ndihmës shtetërore nuk është mjaftë e zhvilluar. *Përgjithësisht*, ndikimi i shtetit mbi konkurrencën ngeli i kufizuar.

#### *Integrimi ekonomik me BE-në*

Shteti është i vogël, ekonomia e hapur, me tregti të përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 120% nga BPV në vitin 2011. Integrimi tregtar me BE-në është në fazë të avancuar. Afër 64% nga eksporti i tërësishëm momentalisht shkon në BE-27 dhe afër 56% nga importi rrjedh prej atje. Sfera e dytë më e rëndësishme tregtare e vendit është CEFTA, e cila arrin afër 24% nga eksporti dhe afër 11% nga importi. Është përmirësuar struktura eksportuese, me pjesëmarrje të rritur të artikujve me vlerë më të lartë për njësi, siç janë katalizatorët për gazra shfryrës të automjeteve. Megjithatë, tekstili, veshja dhe prodhimet nga hekuri i përpunuar ende arrijnë më shumë se një e treta nga eksporti i përgjithshëm. SDI arrijnë afër 50% nga BPV, ndërsa 80% nga investimet vijnë nga BE. Kursi devizor në lidhje me euron ngeli stabil në kushte nominale. Konkurrenca e çmimeve ngeli në masë të madhe e pandryshuar. Kjo është reflektuar në kursin efektiv real të pandryshueshëm devizor, i cili në mesin e vitit 2012 ishte për afër 1% më i ulët nga viti paraprak. *Përgjithësisht*, integrimi tregtar me BE-në është në fazë të avancuar. Përbërja e mallrave për eksport është përmirësuar, edhe pse prodhimet tradicionale, siç janë tekstili, veshja dhe çeliku ende janë dominuese. Konkurrenca e çmimeve në suaza ndërkombëtare ngeli në masë të madhe e pandryshuar.

#### 4. AFTËSIA QË TË MERREN OBLIGIMET NGA ANËTARËSIMI

Në këtë pjesë shqyrtohet aftësia e Republikës së Maqedonisë për marrjen e obligimeve nga anëtarësimi – përkatësisht *acquis*, siç është shprehur nëpërmjet marrëveshjeve, legjislacionit sekondar dhe politikave të Unionit. Gjithashtu analizohet kapaciteti administrativ i Republikës së Maqedonisë që ta zbatojë *acquis*. Analiza është strukturuar në pajtim me listën nga 33 kapituj nga *acquis*. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit e mbulon përparimin e arritur gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe mblidhet niveli i përgjithshëm i gatishmërisë së vendit.

##### 4.1. Kapitulli 1: Qarkullimi i lirë i mallrave

Përparim i kufizuar mund të vërehet në lidhje me **parimet e përgjithshme**. Zbatimi i planit aksional për harmonizim me nenet 34 deri 36 nga Marrëveshja për funksionim të Bashkimit Evropian përparon pas ndryshimit të 26 akteve juridike (prej gjithsej 42).

Ekziston përparim në sferën e **masave horizontale**. Infrastruktura e kualitetit u përmirësua pas planit strategjik për zbatimin e *acquis* në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave. Në sferën e *standardizimit*, është arritur përparim i mirë. Ligji për standardizim u ndryshua që të përmirësohet organika e Institutit për standardizim (ISRM). Gjithsej 16,500 Standarde Evropiane (SE) u miratuan si standarde nacionale. Prej tyre, 3210 janë të ashtuquajtura KE të harmonizuara në kuadër të rëndësisë së direktivave nga qasja e re. U tërhoqën të gjitha standardet jugoslllovene dhe konfliktuozë. ISRM u bë anëtar me të drejta të plota i Komitetit Evropian për Standardizim (CEN) dhe i Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC). Anëtarësimi i kuvendit të ISRM u zgjerua në 97 palë të interesuara. Kapaciteti administrativ i ISRM është përmirësuar me sistem të ri për menaxhim me dokumente/standarde, i cili gjithashtu mundëson shitjen elektronike të standardeve. ISRM është certifikuar në pajtim me standardin EN ISO 9001:2009.

Në sferën e *vlerësimit të përputhshmërisë*, vërehet përparim i vogël. Numri i lejeve të dhëna për trupa për vlerësimin e përputhshmërisë u rrit prej një në nëntë. Certifikimi i prodhimeve është në fazë të hershme të zhvillimit. Harmonizimi i plotë i Ligjit për sigurinë e prodhimeve me *acquis* horizontal prej vitit 2008 (Kornizë e re ligjvënëse) ende nuk është arritur. Është miratuar rregullativë nacionale për kornizën e përbashkët për plasimin e mallrave në treg dhe njoftimin e KE-së. Kjo rregullativë është me qëllim që të pranohen elementet horizontale të *sui generis* Vendimi nr. 768/2008/KE, por harmonizimi ngelet të vërtetohet.

Ka përparim të caktuar në sferën e *akreditimit*. Instituti për akreditim (IARM) ka kapacitet adekuat për menaxhimin me përfshirjen momentale të akreditimeve. Ka gjithsej 107 trupa të akredituar për vlerësimin e përputhshmërisë, që paraqet rritjen e rëndësishme prej 76 për një periudhë prej një viti. Megjithatë, IARM duhet t'i përcaktojë ose përmirësojë kapacitetet e veta për akreditim në sferat e reja. IARM nënshkroi Marrëveshje për pranimin e ndërsjellë të certifikatave për akreditimin e laboratorëve për testim dhe kalibrim, trupa inspektues dhe certifikues me Organizatën evropiane për akreditim dhe Marrëveshje për pranimin multilateral të akreditimeve për sferat testim dhe kalibrim (ILAC-MRA) me organizatën botërore për akreditim – Organizata ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve (ILAC). Përparim të mirë ka në sferën e *metrologjisë*. Ligji për metrologji është ndryshuar për thjeshtësimin e lëshimit të certifikatave dhe për sigurimin e bazës juridike për

inspektim dhe mbikëqyrje të instrumenteve për matje. Numri i certifikatave për kalibrim dhe vërtetim të lëshuara nga ana e Byrosë për metrologji (BM) u rrit për 43% në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010. Pajisja në laboratorë të ndryshëm të BM-së u kalibrua sërish dhe laboratorët për peshë, temperaturë, vëllim, rrjedhje, presion janë akredituar nga ana e trupit nacional për akreditim. Megjithatë, kapaciteti i BM-së për kalibrim të instrumenteve për matje nuk shfrytëzohet mjaftë.

Përparim plotësues të dobët ka në sferën e *mbikëqyrjes së tregut*. Në vitin 2011, trupi koordinues për mbikëqyrjen e tregut ka realizuar gjithsej 390 inspektime të koordinuara dhe 340 aksione mbikëqyrëse, prej të cilave pjesa më e madhe (80%) ishin të lidhura me legjislacionin për siguri të lodrave. Inspektorati shtetëror i tregut ka punësuar katër inspektorë për aktivitete për hetimin e sigurisë së prodhimeve. Resurset njerëzore dhe financiare nuk janë të mjaftueshme që të realizohen kontrole gjithëpërfshirëse për harmonizimin teknik të prodhimeve. Përgatitjet në sferën e masave horizontale janë avancuar, por harmonizimi i plotë i Ligjit për hetimin e tregut me të drejtën e BE-së ngelet në të ardhmen të arrihet.

Vërehet përparim në qasjen e vjetër të **legjislacionit për prodhime**. Për zbatimin e Ligjit për kimikate u përcaktua listë e substancave me rrezik të lartë dhe rregullore për metodat për hulumtimin dhe regjistrimin e kimikateve. Në tetor të vitit 2011, raportet për statusin e kimikateve dhe plani aksional nacional për qasje strategjike në menaxhimin me kimikate gjithashtu u miratuan. Është themeluar trup ndërsektorial për koordinimin e aktiviteteve të lidhura me Ligjin për kimikate. Të punësuarit nga Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor morën trajnim të specializuar. Përgatitjet në sferën e “qasjes së vjetër” në legjislacionin për prodhimet janë avancuar.

Përparim i caktuar gjithashtu vërehet në **qasjen e re dhe globale të legjislacionit për prodhime**. U miratuan ndryshime të rregulloreve për makina, kablo, ashensorë, pajisje nën presion, enë të thjeshta nën presion dhe tjera që të mundësohet zbatimi i Marrëveshjes për pranimin e ndërsjellë të certifikatave për akreditim me Organizatën Evropiane për Akreditim. Është arritur harmonizim plotësues me direktivat përkatëse të BE-së për makina, lodra, mjete ndihmëse mjekësore, pajisje nën tension të ulët dhe përputhje elektromagnetike; harmonizimi me *acquis* duhet të vërtetohet. Janë miratuar tre anekse nacionale të Eurokodeve EC1, EC7 dhe EC8 për dizajn strukturor të punëve ndërtimore. Në sferën e qasjes së re dhe globale legjislacioni për prodhime, vendi shënon progres.

Tek **masat procedurale** vërehet përparim i caktuar. Dekreti për njoftimin e Komisionit Evropian për rregullat teknike dhe të paharmonizuara dhe standarde teknike është ndryshuar. Megjithatë, ende nuk është arritur harmonizimi i plotë. Vendi shënon përparim në këtë sferë.

### *Konkluzion*

Në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave vërehet përparim i mirë, posaçërisht në sferën e standardizimit, akreditimit dhe metrologjisë. Sfera të caktuara nga *acquis-i* kornizë horizontal ngelen plotësisht të harmonizohen. Harmonizimi me nenet nga 34 deri 36 nga Marrëveshja për funksionimin e Bashkimit Evropian ngelet të arrihet. Përgatitjet në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave shënojnë progres.

#### 4.2. Kapitulli 2: Qarkullimi i lirë i punëtorëve

Mund të vërehet përparim i caktuar në lidhje me **qasjen në tregun e punës**. Ligji për nëpunësit publikë mbetet të ndryshohet, me qëllim që t'u jepet qytetarëve të BE-së qasje në vendet e punës në sektorin publik.

Nuk ka përparim në lidhje me përgatitjen për pjesëmarrje në Rrjetin EURES (Shërbimet Evropiane për Punësim).

Mund të vërehet një përparim i vogël në sferën e **koordinimit të sistemeve për siguri sociale**. Marrëveshja bilaterale me Kanadën për koordinimin e sistemeve për sigurimin social hyri në fuqi dhe vazhduan negociatat për lidhjen e marrëveshjeve me Italinë dhe Shqipërinë. Gjithashtu, vazhdoi puna për zgjidhjen e çështjeve në lidhje me sigurimin social me Kosovën. Përgatitjet në këtë sferë përparojnë mesatarisht. Është arritur një përparim i caktuar në sferën e **Kartelës Evropiane për Sigurimin Shëndetësor (KESSH)**. Hungaria dhe Rumunia e pranuan iniciativën e Fondit për sigurim shëndetësor për fillimin e negociatave për KESSH. U nënshkruan marrëveshje për kompensim paushall të shpenzimeve për mbrojtje shëndetësore me Malin e Zi dhe Serbinë. Përgatitjet në këtë sferë përparojnë mesatarisht.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim i caktuar në sferën e qarkullimit të lirë të punëtorëve. Harmonizimi me *acquis-in* është në fazë të hershme.

#### 4.3. Kapitulli 3: E drejta për themelim dhe liria e dhënies së shërbimeve

Është vërejtur përparim i caktuar në sferën e **të drejtës së themelimit**. Vazhdojnë përpjekjet për thjeshtësimin e procedurave dhe zvogëlimin e shpenzimeve për themelimin dhe marrjen e lejeve. Portali për parashtrimin elektronik të kërkesave për themelim filloi të funksionojë. Megjithatë, edhe më tutje ekziston informimi i dobët për themelim në formë elektronike. Vazhdojnë përpjekjet për themelimin e sistemit njësportel për regjistrimin e investitorëve të vendit dhe të huaj, që është e barabartë me "pikën unike për kontakt" sipas direktivës për shërbime.

Mund të vërehet progres i caktuar në harmonizimin me Direktivën për shërbime në lidhje me themelimin dhe shërbimet tejkufitare. Vazhdon kontrolli i legjislacionit nacional, si pjesë e planit aksional për harmonizim me Direktivën për shërbime. Ministria e Ekonomisë siguron koordinim ndërmjet trupave kompetentë. Megjithatë, kërkesat e ndaluara me Direktivën për shërbime mbeten në sektorë të caktuar për shërbime, duke përfshirë në mjekësinë veterinare, arsimin privat, turizmin dhe profesionet e rregulluara. Edhe më tutje ekziston informim i dobët për Direktivën për shërbime, ndërsa kapacitetet administrative të trupave të ndryshëm administrativë duhet të përforcohen. Tarifat minimale të përcaktuara me Ligjin për ndërtimtari nuk përputhen me *acquis*. Përgatitjen në sferën e të drejtës së themelimit janë në rrugë të mbarë.

Mund të vërehet progres i vogël në sferën e **lirisë së sigurimit të shërbimeve tejkufitare**. Kushti për themelim të përhershëm mbetet rregullë e përgjithshme për operatorët e huaj që sigurojnë shërbime në vend. Kjo nuk përputhet me *acquis*. Për shërbime të caktuara kushti për themelim është mënjanuar, por kjo do të zbatohet nga data e pranimi të vendit në BE. Në sferën e **lirisë së sigurimit të shërbimeve**

**tejkufitare** vendi pjesërisht i plotësoi prioritetet.

Është vërejtur përparim i mirë në sferën e **shërbimeve postare**. Ligji në fuqi për shërbimet postare në masë të madhe përputhet me *acquis*. Megjithatë, në të ardhmen duhet të përfundohet me harmonizim të plotë sa i përket periudhës për caktimin e dhënësit universal të shërbimeve dhe financimin e neto shpenzimeve për obligimin për shërbime të përgjithshme postare. Janë rregulluar parimet e metodës për zbatimin e kontabilitetit të veçantë dhe kontabilitetit shpenzues të dhënësit universal të shërbimeve. Me kapacitetin e vet si trup nacional rregullator, Agjencia e Postave vazhdoi të miratojë legjislacionin për rregullimin e tregut postar. Janë miratuar rregulla për kontroll dhe mbikëqyrje të tregut, ndërsa janë përcaktuar edhe kushte të përgjithshme për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme postare dhe për qasje në to. Servisi për mbikëqyrjen e rregullatorit filloi punën. Dhënësi universal i shërbimeve e ka për obligim që t'u lejojë dhënësve tjerë të shërbimeve postare qasje në rrjetin postar. Janë përcaktuar standardet për kualitet të shërbimeve të përfshira me shërbimet e përgjithshme postare, ndërsa është miratuar edhe metoda që duhet ta zbatojë dhënësi universal i shërbimeve në lidhje me këtë. Megjithatë, dhënësi i shërbimeve të përgjithshme postare në të ardhmen duhet të përcaktojë kontabilitet të veçantë për shërbimet e përgjithshme postare. Procedurat e reja për njoftim nxitën rritje të tregut postar, me shumë operatorë aktivë në treg. Megjithatë, ai mbetet të konsolidohet. Vëllimi i njësisë të dërguara me postë është rritur. Rregullatori miratoi rregullore të obligimeve për dhënësit e shërbimeve postare. Puna e dhënësit të shërbimeve postare që mban monopol të shërbimeve për dërgesa me peshë nën 50 gramë është e dobët. Nuk ka përparim sa i përket privatizimit të dhënësit të shërbimeve të përgjithshme postare, i cili është në pronësi të shtetit. Në aspekt të kapacitetit administrativ, Agjencia e Postave ka numër të mjaftueshëm të punësuarve që t'i zbatojë detyrat. Kapaciteti për krijimin e politikave i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në fushën e shërbimeve postare mbetet i pamjaftueshëm. Përgatitjet në sferën e shërbimeve postare janë në rrugë të mbarë.

Mund të vërehet përparim i caktuar në lidhje me **pranimin e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**. Është formuar grup koordinues ndërresorjal në të cilin ka përfaqësues nga trupa të ndryshëm për autorizim, ndërsa është definuar edhe mandati i tij. Është krijuar komiza organizative me role të qarta dhe përgjegjësi për institucione të veçanta, ndërsa është siguruar edhe analizë për palët e interesuara. Është caktuar koordinatori nacional për pranimin e kualifikimeve profesionale siç imponohet me Direktivën për kualifikime profesionale. Megjithatë, kapaciteti administrativ i trupave të ndryshëm për autorizim mbetet i dobët. Ligji për pranimin e kualifikimeve profesionale ende nuk është plotësisht i harmonizuar me *acquis*. Në të ardhmen duhet të arrihet harmonizim me Direktivat për avokatë, agjentë komercialë, si dhe përdorimi profesional i prodhimeve toksike. Përgatitjet në sferën e pranimin të ndërsjellë të kualifikimeve profesionale mesatarisht përparojnë.

#### *Konkluzion*

Në sferat e të drejtës së themelimit dhe lirisë së dhënies së shërbimeve mund të vërehet një përparim i caktuar, posaçërisht në sferën e shërbimeve postare. Janë të nevojshme përpjekje plotësuese që të harmonizohet legjislacioni me *acquis*, posaçërisht në lidhje me zbatimin e direktivës për shërbime, themelim të pikës unike për kontakt dhe pranim të ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Marrë përgjithësisht, në sferat e të drejtës së themelimit dhe lirisë së dhënies së shërbimeve shteti përparon mesatarisht.



#### 4.4. Kapitulli 4: Qarkullimi i lirë i kapitalit

Vendi i përmbushi kërkesat nga faza e parë e Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim (MSA) në vitin 2008 në sferën e **qarkullimit të kapitalit dhe pagesave**. Përparimi i paradokohshëm është i kufizuar në lëshimin e ndalesave të caktuara për hapjen dhe posedimin e llogarive jashtë vendit, por vetëm për personat që qëndrojnë atje përkohësisht. Liberalizimi i mëtejshëm i qarkullimit të kapitalit dhe pagesave është kushtëzuar nga kalimi në fazën e dytë të MSA duke pritur vendimin e Këshillit për Stabilizim dhe Asocim. Shtetasve ende nuk u lejohet të blejnë aksione të huaja, të hapin llogari në bankat e huaja ose të blejnë pronë të patundshme jashtë vendit. Qytetarëve të BE-se nuk u lejohet të blejnë tokë bujqësore. Mbeten ndalesat për shumat që persona të cilët nuk janë banorë të përhershëm mund t'i bartin përmes llogarive të tyre lokale dhe të huaja devizore. Përgatitjet në sferën e qarkullimit të kapitalit dhe pagesave janë të avancuara mesatarisht.

Vërehet përparim i kufizuar në sferën e **sistemeve për pagesë**. Në kuadër të Këshillit nacional për sistemet për pagesë, vërehet përparim në përgatitjet për harmonizim me Direktivën për shërbime pagesore dhe për zbatimin e standardeve nga sfera unike për pagesa në euro (SEPA) dhe programin për ngarkim direkt me borxh. Shumica e arkëtimit për transaksione tejkufitare të pagesës elektronike ende janë joproporcionale me ato transaksione vendore të arkëtimit elektronik. Në sferën e sistemeve për pagesë, vendi pjesërisht i përbush qëllimet e veta..

Është arritur përparim i caktuar në **luftën kundër larjes së parave**. Ligji për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit, i cili në vete i përmban rekomandimet e përmirësuara të Grupit operativ për masa financiare në luftën kundër larjes së parave (FATF), pësoi ndryshime. Qeveria e miratoi strategjinë nacionale për luftën kundër larjes së parave dhe financimin e terrorizmit për vitin 2012-2014 dhe formoi Këshill për luftën kundër larjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Strategjia i përcakton aktivitetet e të gjitha institucioneve të përfshira me qëllim që t'i përmbushë qëllimet në lidhje me legjislacionin, ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstitucional dhe ngritjen e vetëdijes. Këshilli i kryeson drejtorin e Agjencisë për Zbulim Financiar (AZF), e cila më herët quhej Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit (DPLPFT), kurse përbëhet nga përfaqësues të 14 institucioneve që njoftojnë, si dhe nga trupa hetues dhe trupa që realizojnë hetim. Ajo i koordinon edhe mbikëqyr aktivitetet e përcaktuara në strategjinë dhe e informon Qeverinë. Këshilli siguron platformë për përforcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. AZF i përsosë IT sistemet që ta përmirësojë grumbullimin e të dhënave, përpunimin dhe analizën. Megjithatë, niveli i njoftimit mbetet i pamjaftueshëm dhe sugjeron për mangësi të pandërprera në zbatim. Në vitin 2011, numri i raporteve për transaksione të dyshimta të paraqitura në AZF është zvogëluar për 32 % dhe ka arritur 165. Numri i procedurave gjyqësore dhe dënimeve mbetet shumë i ulët (dy aktakuza dhe një aktgjykim). Përgatitjet për luftën kundër larjes së parave janë mesatarisht të përparuar.

#### *Konkluzion*

Vërehet përparim i caktuar në sferën e qarkullimit të lirë të kapitalit, posaçërisht në përmirësimin e kornizës institucionale për luftën kundër larjes së parave. Zbatimi i politikave kundër larjes së parave është i dobët. Ekzistojnë plane për liberalizim të mëtejshëm të qarkullimit të kapitalit dhe pagesave pas kalimit në fazën e dytë të MSA-s. Përgatitjet në sferën e qarkullimit të lirë të kapitalit janë në rrugë të mbarë.

#### 4.5. Kapitulli 5: Furnizimet publike

Është arritur përparim i caktuar në lidhje me **parimet e përgjithshme**. Ligji për furnizime publike (LFP) u ndryshua që të vendoset, mes tjerash, publikimi i detyrueshëm i shpalljes për marrëveshje nën 5 000 euro, dialog teknik për marrëveshje mbi 130 000 euro dhe ndalesë e përkohshme me kohëzgjatje prej 6 muajve për aktivizim të sërishëm të tenderëve të anuluar. U vendos listë e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dhënë referencë negative të cilët duhet të përjashtohen nga pjesëmarrja në tenderët e mëtejshëm në afat prej 1 deri 5 vjet, në të ardhmen duhet të vërtetohet harmonizimi me asquis. U publikuan gjashtë pjesë të legjislacionit për zbatim, duke përfshirë edhe Kodeksin e sjelljes për furnizime publike. Programi nacional për parandalimin e korrupsionit 2011-2015 përfshiu masa mbrojtëse në sferën e furnizimeve publike. U miratua Ligji i ri për koncesione dhe partneritet publik privat (LKPPP) dhe ai është harmonizuar me asquis. U miratua legjislacioni për zbatim, por 16 ligje sektoriale në të ardhmen duhet të harmonizohen me LKPPP. Kapaciteti i seksionit në Ministrinë e Ekonomisë që merret me koncesione dhe PPP nuk është i mjaftueshëm që t'u përgjigjet kompetencave të rritura për zbatimin e LKPPP. Direktivat e BE-së për furnizime në sferën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe direktiva për pagesë të vonuar ende duhet të transponohen. Në lidhje me parimet e përgjithshme, vendi është në rrugë të mbarë.

Është arritur përparim i caktuar në lidhje me **ndarjen e marrëveshjeve publike**. Përdorimi i e-ankandëve për konkurse të shpallura u rrit prej 70% në 100%. Sistemi elektronik për furnizime u zgjerua që t'i përfshijë, gjithashtu, edhe koncesionet edhe konkurset për PPP dhe listën e referencave negative. Trajnimet e organeve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë janë ngadalësuar. Numri i anulimeve të procedurave të tenderëve u rrit prej 20% në vitin 2010 në 29% në vitin 2011 dhe u rrit përdorimi i procedurave me negociim pa shpallur konkurs. Trajnimet e bëra speciale për organet kontraktuese në lidhje me kriteret për kualitet, specifika të tenderit dhe menaxhim me marrëveshje në të ardhmen duhet të zhvillohen. Në lidhje me ndarjen e marrëveshjeve publike, vendi ka përparuar mesatarisht.

Mund të vërehet përparim në lidhje me sistemin për **mjete juridike**. Kompetencat e Komisionit shtetëror për ankesa për furnizime publike (KSHAFP) u zgjeruan që t'i përfshijnë ankesat në sferën e koncesioneve dhe PPP. Afër 14% e të gjithë tenderëve të cilët filluan në vitin 2011 ishin lëndë e ankesave. Numri i përgjithshëm i rasteve të KSHAFP u zvogëlua prej 868 në vitin 2010 në 690 në vitin 2011. KSHAFP e ruajti nivelin e rasteve të zgjidhura prej mbi 95%. Në katër raste Gjykata Administrative i refuzoi vendimet e KSHAFP. 33 vende të punës në KSHAFP mbeten të lira dhe në vitin 2012 u zvogëlua buxheti i KSHAFP. Në LFP nuk është mbrojtur e drejta e ankesës për operatorë ekonomikë të cilët janë vënë në listën e referencave negative. Harmonizimi i plotë me Direktivën e ndryshuar të BE-së për mjete juridike në të ardhmen duhet të arrihet. Të dhënat gjyqësore statistikore për rastet e lidhura me furnizimet publike janë pjesërisht të arritshme dhe metodologjia për grumbullimin e tyre nuk është gjithëpërfshirëse. Në 7 prej 45 rasteve të pranuar, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dyshon për sjellje korruptive gjatë shpenzimit të mjeteve publike financiare dhe rekomandon që Prokuroria publike të paraqesë aktakuza penale. Zbatimi i neneve të Kodit penal të cilët janë të lidhur me furnizimet publike rezultoi me një aktgjykim në gjysmën e parë të vitit 2012. Në lidhje me sistemin për mjete juridike, vendi ka përparuar mesatarisht.

### *Konkluzion*

Marrë përgjithësisht, është arritur përparim i caktuar në sferën e furnizimeve publike. Harmonizimi i legjislaturës për koncesione dhe partneritet publik privat me *acquis* ka përparuar, me përjashtim të mjeteve juridike dhe furnizimit në sferën e mbrojtjes. Përdorimi i e-ankandit është i detyrueshëm. Kapacitetet administrative në sferën e mjeteve juridike dhe koncesioneve dhe partneritetit publik privat mbeten të dobëta. Marrë përgjithësisht, përgatitjet në aferën e furnizimeve publike janë avancuar.

#### **4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare**

Është arritur përparim i mirë në sferën e të drejtës së shoqërive tregtare. Është miratuar Ligji për grupe evropiane ekonomike të interesit. Ai do të zbatohet pas hyrjes së vendit në BE. Zgjerimi i sistemit njësportel t'i përfshijë edhe Agjencinë për supervizion të sigurimit, Drejtorinë e të hyrave publike dhe Agjencinë për supervizion të sigurimit pensional me financim të plotë është në rrjedhë. Regjistri Qendror ka 300 të punësuar në mbarë vendin, që është numër i mjaftueshëm i të punësuarve. Disa nga rregullat për pjesëmarrje të të punësuarve janë të transponuarasipas konceptit të *Societas Europaea*, megjithatë neni 16 i Direktivës së dhjetë të Ligjit për shoqëri tregtare për bashkëngjitje tejkufitare në të ardhmen duhet të transponohet. Sektori juridik i Ministrisë së Ekonomisë me 13 persona tani është përgjegjës për harmonizim të Ligjit për shoqëri tregtare me *acquis*. Në sferën e të drejtës së shoqërive tregtare, vendi mbetet në rrugë të mbarë.

Është bërë përparim i mirë në **kontabilitetin korporativ**. Është miratuar Ligj për kryerjen e punëve të kontabilitetit që të definohen kriteret e profesionin të kontabilitetit, të vendosen masa disiplinore në rast të shkeljes së Kodeksit etik të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe të themelohet Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar si dhomë profesionale përgjegjëse për dhënien e licencave dhe të mbajë trajnime të vazhdueshme për kontabilistë profesionistë. Standardet ndërkombëtare për informim financiar (SNIF) për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të përkthyer dhe tani zbatohen.

Është arritur përparim i vogël për sa i përket **revizionit**. Është themeluar Këshill për përparim dhe mbikëqyrje të revizionit me qëllim që ta përparojë profesionin e revizionit, të sigurojë kontroll të kualitetit dhe të kryejë mbikëqyrje të Institutit të revizorëve të autorizuar (IRA); Këshilli ka mbajtur takime të rregullta. IRA ka realizuar provime për revizorë të autorizuar dhe mban ligjërata për përmirësim të vazhdueshëm profesional. Numri i të punësuarve në IRA është rritur në 3 persona, por megjithatë është i pamjaftueshëm që të zbatohet kontroll efektiv i garancisë për kualitet. Kualifikimet e revizorëve të autorizuar të marra në vende të huaja ende nuk pranohen. Marrë përgjithësisht, në sferën e kontabilitetit korporativ dhe revizionit, vendi shënon përparim mesatar.

### *Konkluzion*

Është arritur përparim i mirë në të drejtën tregtare, veçanërisht me miratimin e legjislationit për Grupe ekonomike evropiane të interesit. Kapaciteti administrativ i Institutit të revizorëve të autorizuar është i dobët. Kualifikimet e revizorëve të autorizuar të marra në vend në huaj në të ardhmen duhet të pranohen. Marrë përgjithësisht, përgatitjet në sferën e të drejtës tregtare shënojnë përparim mesatar.

#### 4.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme**. U rregullua shumica e kompensimit unik të drejtë për reproduksion për përdorim privat të veprave të shkruara, fonogrameve dhe videogrameve; harmonizimi me *acquis* në të ardhmen duhet të vërtetohet. Komisioni për ndërmjetësim në sferën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme tani është institucion i cili është përgjegjës që të sigurojë mendim për skemat tarifore të shoqatave për menaxhim me të drejtat kolektive (SHMDK) të cilët duhet të marrin licenca. Momentalisht aktive janë dy SHMDK. Bashkëpunimi i Sektorit përgjegjës për të drejtat e autorit në Ministrinë e Kulturës ishte i kufizuar me institucionet përkatëse. Në këtë sferë, vendi ka përparim. Përparim plotësues vërehet në sferën e të **drejtave të pronësisë industriale**. U ratifikua Marrëveshja e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës Evropiane për patenta e cila ka për qëllim zvogëlimin e shpenzimeve për përkthimin e patentës. U përcaktua regjimi për licenca për vlerësues të kualifikuar në sferën e pronësisë industriale. U miratua legjislacioni për zbatim lidhur me regjistrimin e shenjës së prejardhjes dhe shenjës gjeografike të prodhimeve bujqësore. Enti Shtetëror Pronësisë Industriale (ESHPI) ka vazhduar me bashkëpunimin me Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale, Organizatën Evropiane të Patentave, Akademinë Evropiane të Patentave dhe trupat tjerë përkatës. Vazhdojnë trajnimet dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI). Në vitin 2011, Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë ka realizuar 16 trajnime për mbrojtjen e DPI-së. Strategjia nacionale për pronësi intelektuale në të ardhmen duhet të azhurnohet. Vendi shënon përparim të konsiderueshëm në sferën e të drejtave të pronësisë industriale.

Përparim i caktuar mund të vërehet në aspekt të **zbatimit**. Ligji për masa doganore për mbrojtjen e DPI-së u ndryshua që të mundësojë përpunim falas të kërkesave për masa të tilla. U miratua Strategjia për masa doganore për mbrojtjen e DPI-së 2011-2013. Kompetencat e rritura të Inspektoratit Shtetëror të Tregut (ISHT) gjatë konfiskimit të sendeve të falsifikuara kanë pasur ndikim pozitiv. 49 inspektorë policorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) punojnë me shkeljet e DPI. Byroja e Barnave (BB) konfiskoi barna të falsifikuara homeopatike të cilat janë shitur në barnatore, por nuk ekziston vetëdije lidhur me kërcënimet e barnave të falsifikuara për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Trupi koordinues për pronësi intelektuale (TKPI) ka ndërmarrë 12 aktivitete koordinatave në vitin 2011, që paraqet rënie përgjysmë në krahasim me vitin 2010. Bashkëpunimi i TKPI-së me Agjencinë për Menaxhim me Pronë të Konfiskuar vazhdon, por numri i mallrave të cilat janë asgjësuar publikisht në mënyrë të konsiderueshme u zvogëluar në vitin 2011. Kompetencat për DPI janë zgjeruar në më shumë institucione për zbatimin e ligjit (TKPI, ISHT, MPB, BB, Drejtoria Doganore, Ministria e Drejtësisë etj.), që krijon sistem më shumë të ndërlikuar sesa efikas për mbrojtjen e DPI-së. Në vitin 2011 filluan gjithsej 126 procedura gjyqësore për shkelje të DPI-së. Afër 15 dënime me burg dhe një numër i madh i dënimeve për vepra penale iu shqiptuan personave fizikë nga ana e seksioneve të specializuara në gjykata për DPI-në. Zhvillimi i metodologjisë për grumbullimin dhe këmbimin e të dhënave statistikore për DPI-në është në fazë të hershme; megjithatë, këmbimi i të dhënave ndërmjet institucioneve për zbatimin e ligjit nuk është sistematik. Vetëdija se falsifikimet negativisht ndikojnë edhe në produktet ushqimore, kozmetikën, prodhimet higjienike, barnat, lodrat, pajisjet teknike dhe elektronike, është e ulët dhe ato mallra shiten në rrugë dhe në tregjet e gjelbra. Tregtia me barna të falsifikuara dhe produkte të rreme përmes

internetet akoma nuk është lëndë e ndjekjes penale. Bashkëpunimi ndërmjet organeve për përcjelljen e kanaleve për falsifikim dhe zgjidhja e problemit me "piramidën e falsifikimit" është i kufizuar, edhe në nivel nacional, edhe në nivel ndërkombëtar.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim i caktuar në sferën e pronësisë intelektuale, edhe lidhur me kornizën e legjislacionit, edhe në lidhje me kapacitetin administrativ. Zbatimi mbetet sfidë dhe sistemi për menaxhim me të drejta kolektive ende është i zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme. Në të ardhmen duhet të përcaktohet evidencë e qëndrueshme për përcjelljen e hetimeve, ndjekjes penale dhe analizimit të rasteve të lidhura me DPI-në, pasi shkeljet e DPI-së vazhdojnë. Niveli i vetëdijes për DPI-në ndërmjet institucioneve dhe publikut mbetet i ulët. Marrë përgjithësisht, përgatitjet në sferën e DPI-së janë të avancuara mesatarisht.

#### **4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës**

Është arritur përparim i mirë në sferën e antitrusteve, duke përfshirë edhe bashkëngjitjet. Janë miratuar Udhëzime për kufizime lidhur me koncentrimet dhe më shumë akte nënligjore. Në krahasim me vitin 2011, aktivitetet për zbatim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) janë përmirësuar në kualitet dhe kuantitet. Nga 1 tetori 2011, KMK ka miratuar tri vendime për marrëveshje të ndaluara, tri për keqpërdorim të pozicionit dominues dhe 23 për koncentrimet. KMK gjithnjë e më shumë i heton sferat e rëndësishme ekonomike, veçanërisht telekomunikimet dhe radiodifuzionin. Të punësuarit detyra e të cilëve janë antitrustet dhe bashkëngjitjet duhet të shfrytëzohen në mënyrë më efektive. Të punësuarit në KMK-në fitojnë shkathtësi të mira bazike, por do të kishin dobi nga trajnimi më i avancuar. Buxheti i përgjithshëm i KMK-së për vitin 2012 ka mbetur afër 30% më i vogël se në vitin 2009, e sipas kësaj edhe i pamjaftueshëm. Zbatimi efektiv i masave të lëshimit të parapara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës është kufizuar për shkak të dispozitave kundërtënëse në Kodin penal. Përveç kësaj, nëse paraqitet ankesë, zbatimi i vendimeve nga ana e KMK-së në procedurat kundërvajtëse përkohësisht ndërpritet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Administrative, që e zvogëlon efektivitetin e vendimeve të KMK-së. Numri i vendimeve të përcaktuara nga ana e Gjykatës Administrative është rritur nga 3 në vitin 2011 në 6 në 9 muajt e parë të vitit 2012, me ç'rast realizimi u përforcua. Gjykatësit e Gjykatës Administrative kaluan trajnime të caktuara për antitruste dhe bashkëngjitje. Përgatitjet në sferën e antitrusteve, duke përfshirë edhe bashkëngjitjet janë në fazë të avancuar.

Është shënuar përparim i caktuar në sferën e ndihmës shtetërore. Zbatimi i Ligjit për ndihmës shtetërore është i mjaftueshëm. Në nëntë muajt e parë të vitit 2012, KMK-ja miratoi njëmbëdhjetë vendime në sferën e ndihmës shtetërore, duke përfshirë vendime *me detyrë zyrtare*, që paraqet rritje në krahasim me vitin 2011. Kualiteti i disa prej tyre mund të përmirësohet. Numri i të punësuarve që punojnë në sferën e ndihmës shtetërore është përkatës. Në sferën e ndihmës shtetërore vendi është në rrugë të mbarë.

Nuk është shënuar përparim në sferën e liberalizimit të tregut.

#### *Konkluzion*

Në aspekt të konkurrencës, është arritur përparim i mirë. Legjislacioni i miratuar në fuqi e përmirësoi kornizën e legjislacionit. Trendi për zbatim vazhdoi të përmirësohet

në kualitet dhe kuantitet. KMK-ja nuk disponon resurse buxhetore përkatëse. Numri i të punësuarve është përkatës por duhet në mënyrë më efikase të shfrytëzohet. Përgjithësisht, përgatitjet në këtë sferë janë avancuar.

#### 4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Ka përparim të mirë në sferën e **Bankave dhe konglomerateve financiare**. Ligji për supervizion plotësues të konglomerateve financiare u miratua me qëllim që të harmonizohet me Direktivën e konglomerateve financiare. Ligji i përcakton rregullat për supervizion plotësues të bankave, shoqërive të sigurimit dhe firmave brokere të cilat janë pjesë e konglomeratit financiar. Në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve, Banka Qendrore (BPRM) filloi trajtimin e çështjeve të ngritura në ankesat me kryerjen e kontrolleve të përgjithshme të bankave. Zbatimi i legjislacionit bankar për mbrojtjen e konsumatorëve po përmirësohet. Megjithatë, mbrojtja e konsumatorëve mbetet sfidë dhe duhet të trajtohet në mënyrë përkatëse.

BPRM-ja në mënyrë plotësuese i ka përmirësuar rregullat për kërkesat kapitale për rrezikun kreditor. U përcaktua metodologjia e njëjtë për kërkesat kapitale për mbulimin e tregut, kreditë, valutën dhe rreziqet operative. Ajo është e harmonizuar pjesërisht me Direktivën për përshtatshmëri kapitale. Bashkëpunimi me organet e supervizionit të vendeve bankat e të cilave posedojnë disa prej bankave më mëdha në vend është e mirë. Me gjithsej 53 persona personel i cili punon në seksionin për supervizion bankar, kapaciteti i BPRM-së është i mjaftueshëm për zbatimin përkatës dhe realizimin e rregullave. Aplikimi i qasjeve të standardizuara nga shtylla 1 nga Korniza Bazel II filloi në korrik 2012. Qasjet e përsosura do të vendosen nga viti 2013, për çfarë do të nevojitet kapacitet plotësues. Vendi është në rrugë të mbarë në sferat e bankave dhe konglomerateve financiare.

Ka përparim të mirë por jo të barabartë në sferat e **sigurimit dhe sigurimit pensional profesional**. Agjencia për supervizion të sigurimit (APS) publikoi legjislacion për kontabilitet dhe informim financiar, supervizion të rrezikut dhe mbrojtje të konsumatorëve, me ç'rast pothuajse ka përfunduar korniza juridike për supervizion të sigurimit. Përgatitjet për zbatimin e Direktivës për Solvencë II (2009/138/KE) janë në rrjedhë. U instalua softuer i ri për supervizion jashtëterreni. Në batë të kontrolleve të kryera, APS-ja ka shqiptuar masa të supervizionin për shoqëri të sigurimeve. Kapaciteti i APS-së dhe bashkëpunimi i saj me organet e supervizionit të kompanive të sigurimit të cilat kanë degë lokale janë përkatëse. APS-ja mori pjesë në tri kolegje të supervizionit, me vende partnere dhe kreu dy kontrolle të përbashkëta me rregullatorët e sigurimit në vendin amë. Kjo është prezantuar në forumin për supervizion me Shoqatën Ndërkombëare të Supervisorëve të Sigurimit. Margjinat për kapital dhe solvencë ende janë mbi nivelet e nevojshme dhe fondi garantues për josolvencë të siguresve është i mjaftueshëm. U vendosën targa të reja të regjistrimit për luftë kundër vozitjes së pasiguar, megjithatë vozitja e pasiguar mbetet sfidë dhe evidenca për zbatimin e luftës kundër kundërvajtjeve të bëra nga shoferët e pa siguar është e dobët. Ministria e Punëve të Brendshme vlerëson se numri i automjeteve të pasiguruara është zvogëluar prej 17% në 10%. Dispozitat e Ligjit për sigurim të detyrueshëm në komunikacion e autorizojnë Ministrinë e Financave që të konfirmojë premi, pasi sigurimi i automjeteve motorike është barrierë efikase për konkurrencë ndërmjet kompanive të sigurimit dhe nuk është në pajtim me *acquis*.

U miratua Ligji për pagesë të pensioneve nga fondet e sigurimit të detyrueshme

(shtyllës së dytë) dhe të padetyrueshme (shtyllës së tretë) për sigurim financiar kapital. Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital (MAPAS) ka miratuar doracakë të rinj për supervizion të rrezikut të modeluar sipas praktikave më të mira për skema të pensionit me kontribute të definuara të Organizatës Ndërkombëtare të Supervizorëve Pensionalë (IOPS). Kufiri prej 50% për investime në letra me vlerë, që është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, mbetet. U vendosën dispozita të reja ligjore për ndalimin e fondeve pensionale që të investojnë në fletobligacione dhe letra tjera me vlerë të lëshuara dhe të garantuara nga ana e shtetit me të cilat nuk tregtohet në tregun vendor. Ligji për sigurim pensional me financim kapital u ndryshua që të sigurohet pavarësi e plotë nga MAPAS-i. Megjithatë, kapaciteti i plotë për realizim nuk është i mjaftueshëm. MAPAS-i ende ka ndikim të kufizuar mbi institucionet në të cilat kryen supervizion. Në sferën e sigurimit dhe pensionieve profesionale, vendi ende nuk është i harmonizuar mjaftë me *acquis*.

Ka përparim të vogël në sferën e **infrastrukturës financiare të tregut**. Të gjithë rregullatorët e shërbimeve financiare e ndryshuan legjislacionin për vendosjen e analizës së rrezikut të bazuar në vlerësimet e agjencive ndërkombëtare për rejting kreditor, në vend të kriterëve për anëtarësim në BE dhe OECD. Harmonizimi me Direktivën për barazim përfundimtar (98/26/KE), të dyja të ndryshuara me Direktivën nr. 2009/44/KE, ende është në rrjedhë. Në sferën e infrastrukturës financiare të tregut, vendi ende nuk është mjaft i harmonizuar me *acquis*.

Ka përparim të caktuar në sferën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese**. Legjislacioni vendor për keqpërdorim të tregut, tregjeve në instrumentet financiare, skemat investuese për kompensim, transparencë dhe prospekte është në pjesë të madhe i harmonizuar me *acquis* përkatës. Përgatitjet për harmonizim me Direktivën nr. 2007/16/KE dhe proceset tjera zhvillimore me *acquis* lidhur me aktivitetet për investim kolektiv në letra me vlerë me të cilat tregtohet (pakoja UCITS IV ) tashmë kanë filluar. Komisioni për letra me vlerë miratoi akte nënligjore në pikëpamje të zbatimit të plotë të legjislacionit. Shpeshësia me të cilën rregullativat e supervizionit ndryshohen e minon stabilitetin juridik për pjesëmarrësit në treg. KLV-ja e vazhdoi bashkëpunimin me rregullatorët e tregut të kapitalit nga rajoni, me qëllim që të përcaktohet platformë e përbashkët për listat, tregtinë, transparencën dhe themelimin. Numri i personelit të KLV është i mjaftueshëm për vëllimin rrjedhës të punës. KLV-ja dhe Banka Qendrore i përmirësuan bashkëpunimin, këmbimin e informatave dhe koordinimin në sferën e supervizionit gjatë tregtimit me letra me vlerë. Në sferën e tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese, vendi përparon mirë.

### *Konkluzion*

Është arritur përparim në sferën e shërbimeve financiare, veçanërisht në sistemin bankar, sigurim dhe tregje të letrave me vlerë. Harmonizimi i kornizës juridike për supervizion të sigurimit me *acquis* përparon mirë. U miratua Ligj për pagesë të pensioneve nga fondet për sigurim pensional me financim kapital dhe MAPAS-i e mbajti pavarësinë e plotë juridike dhe financiare. Megjithatë, vozitja e pasiguar mbetet sfidë dhe evidenca për zbatim në luftën kundër kundërvajtjeve të bëra nga ana e shoferëve të pasiguar është e dobët. Mbetet të arrihet harmonizimi me *acquis* kyç në sferën e infrastrukturës financiare të tregut. Përgjithësisht, në sferën e shërbimeve financiare, harmonizimi me *acquis* shënon përparim mesatar.

#### 4.10. Kapitulli 10: Shoqëria informatike dhe mediet

Mund të vërehet përparim i mirë në sferën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive informatike dhe të komunikimit**. Ligji për komunikime elektronike është ndryshuar dhe janë miratuar rregullativa në kuadër të periudhës raportuese me qëllim të përmirësimit të konkurrencës në treg. Korniza juridike e BE-së për vitin 2009 në të ardhmen duhet të transponohet në legjislacionin nacional. Përgjegjësitë për legjislacionin dhe krijimin e politikave për komunikime elektronike dhe shoqëri informatike i janë bartur Ministrisë së re të Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA). Kapaciteti në Ministrinë e re ka nevojë për përforsim. Roli i përgjegjësive të Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE), si trup nacional rregullator, janë sqaruar në legjislacionin. AKE-ja publikoi strategji pesëvjeçare rregullatore (2012-2016) dhe vendosi konsultime të rregullta me publikun, duke përfshirë edhe për planin e vet vjetor. Është arritur përparim me zbatimin e masave konkurruese për mbrojtje, siç janë obligimet në aspekt të kontabilitetit për rrjete fikse dhe mobile dhe gjenerata e ardhshme e rrjeteve qasëse. AKE-ja caktoi dhënës të shërbimit universal dhe ndërtoi kapacitet të vet për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Rregullatori, gjithashtu, zhvilloi regjistër elektronik të infrastrukturës elektronike të komunikimit. Janë bërë ndryshime të legjislacionit me qëllim që të harmonizohen shpenzimet rregullatore të operatorëve dhe përdorimi i tepricës së mjeteve. Megjithatë, kjo ende duhet të zbatohet. Bartja e tepricës së mjeteve rregullatorit në sfera që janë jashtë kompetencave të komunikimeve elektronike e cenon autoritetin e rregullatorit. Koordinimi i masave të imponuara nga AKE-ja dhe trupi nacional për konkurrencë duhet të përmirësohet. Është shpallur thirrje publike për ndarjen e zhvillimit të gjeneratës së katërt të telefonisë mobile. Numri për raste urgjente 112 nuk është vendosur për shkak të kufizimeve financiare. Përgatitjet në sferën e komunikimeve elektronike dhe teknologjive informatike janë avancuar.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **shërbimeve të shoqërisë informatike**. Janë inicuar projekte plotësuese elektronike qeveritare për zgjerimin e mundësive për qytetarët dhe ndërmarrjet të mund të komunikojnë me administratën publike. Është miratuar metodë për vlerësim të vlerës së teknologjisë informatike. Lidhshmëria e regjistrave dhe bazave të të dhënave ndërmjet institucioneve shtetërore vazhdon. Dy dhënës të akredituar të shërbimeve ende lëshojnë certifikata për nënshkrim të kualifikuar elektronik. Megjithatë, ekziston kërkesë e vogël e certifikatave dhe qasja në treg është e vështirësuar, pasi zbatimi i legjislacionit imponon, në praktikë, regjistrim para se të mund të lëshohen certifikatat. Tregu i domeneve të internetit nuk është i liberalizuar dhe MAR-Net mbetet regjistër i vetëm i emrave të domen-emrave në vend. Derisa interneti penetrimi rritet dhe rrjetet sociale përmes internetit bëhen gjithnjë më me ndikim, ende ka pengesa për e-tregti, duke përfshirë edhe "pragun" e imponuar për tregti me internet nga ana e organit doganor. Përgatitjet në sferën e shoqërisë informatike janë avancuar.

Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e **politikës audiovizuale**. Kuvendi i miratoi ndryshimet e Ligjit për veprimtari radiodifuzive me të cilin parashihen taksa më të larta radiodifuzive dhe rritet koha për reklamim në programet e servisit radiodifuziv publik. Shkallët për arkëtim të shkallës radiodifuzive filluan të rriten dhe parashikojnë financim përkatës të servisit radiodifuziv publik dhe Këshillit Radiodifuziv. Këshilli Radiodifuziv i rriti aktivitetet e veta për përcjelljen dhe transparencën e punës së vet, por problemet për pavarësinë e tij mbesin. Është



rritur numri i përgjithshëm i rasteve të hetuara të koncentrimit ilegal medial. Janë bërë përpjekje për zbatimin e Ligjeve për të drejtën e autorit dhe për pronësinë e medieve dhe koncentrimin medial, por ato ende janë të pamjaftueshme. Heqja e licencës stacionit televiziv A2 ngriti çështje dhe sugjeroi dobësi në kornizën juridike dhe praktikën për imponimin e sanksioneve. Këshilli radiodifuziv duhet t'i shqyrtojë praktikën e veta dhe kornizën juridike me qëllim që të ballafaqohet me këto probleme. Këshilli radiodifuziv ka mungesë të resurseve për përcjelljen dhe zbatimin e ligjit në nivel rajonal dhe lokal. Aktivitetet për përcjelljen e përmbajtjeve mediale mbeten të dobëta dhe të pamjaftueshme.

Pavarësia e servisit publik radiodifuziv (RTVM) është paraparë në Ligjin për veprimtari radiodifuzive. RTVM-ja inicion reforma të caktuara nën udhëheqësinë e re që ta rrisë efikasitetin e vet dhe kualitetin e ofertës. Mbetet ndërmarrja e përpjekjeve të mëtejshme të konsiderueshme që të sigurohet se RTVM-ja e plotëson misionin e servisit publik, mes tjerash, përmes sigurimit të barazpeshës dhe mbulimit pluralist të lajmeve. Procesi i përpilimit të legjislationit të ri për medie, në pajtim me direktivën për shërbime mediale audiovizuale, është avancuar, por inkluziviteti dhe transparenca e procesit në të ardhmen duhet të garantohen.

Përgatitjet për kalim në televizion digjital vazhdojnë dhe priten të përfundojnë në vitin 2013. Janë bërë ndryshime në Ligjin për komunikime elektronike me rregullimin e procesit të digjitalizimit. Ekziston koordinim i vogël i planit për kalim në digjitalizim ndërmjet institucioneve dhe nuk ka mekanizëm afatgjatë për planifikim dhe mbikëqyrje të kalimit në digjitalizim me pjesëmarrje të të gjitha palëve të prekura. Rrjeti DVB-T është ndërtuar me qëllim të emitimit dhe transmetimit të programeve të servisit publik radiodifuziv. Operatori i posaçëm multipleks DVB-T në të ardhmen duhet të zgjidhet. Me këtë në formë digjitale do të emitoen programe të kanaleve televizive komerciale. Përgatitjet në sferën e politikës audiovizuale janë në fazë të hershme.

#### *Konkluzion*

Mund të vërehet përparim në sferën e shoqërisë informatike dhe mediet, veçanërisht në sferën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë informatike. Në rastin e politikës audiovizuale, aktivitetet e Këshillit për Radiodifuzion rriten, por duhet të sigurohet qasje jodiskriminuese. Miratimi i Ligjit për medie në pajtim me acquis-in e BE-së mbetet prioritet. Vendi pjesërisht i plotëson prioritetet e veta në sferën e shoqërisë Informatike dhe mediat. Përgjithësisht, përgatitjet në këtë sferë janë avancuar mesatarisht.

#### **4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural**

Është shënuar përparim i vogël lidhur me çështjet horizontale. Programi nacional për miratimin e acquis ka përcaktuar kornizë ambicioze të përkohshme për harmonizimin e ligjeve në këtë sektor. Për vitin 2012 gjithsej janë ndarë 130 milionë euro për skemat për përkrahje të drejtpërdrejtë. Kjo përfshinë pagesa direkte për sipërfaqe dhe numër për kokë, pagesa të premive dhe subvencione hyrëse për prodhime të konsiderueshme strategjike dhe pagesa në bazë jo të mallit, si dhe përkrahje për bujqit e rinj.

Përgjithësisht, është vërejtur rritje e numrit të të punësuarve. Megjithatë, në sferën e politikës për përkrahjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, kualiteti i prodhimeve bujqësore dhe verës është miratuar vetëm legjislacioni sekondar i kufizuar, kryesisht i natyrës teknike. Kapaciteti institucional edhe më tutje mbetet problem i konsiderueshëm.

Mund të vërehet përparim i mirë në vendosjen e sistemit të integruar administrativ dhe kontrollues (SIAK). Është vendosur bazë juridike për Sistemin e identifikimit të parcelave tokësore (SIPT) dhe sistemi funksionon. Regjistrimi është në rrjedhë dhe më shumë përfshinë 45% nga ekonomitë e paraqitura. Kadastru i patundshmërive për tokë bujqësore është i kompletuar. Regjistri i fermave, i cili si mbulim ka sistem të automatizuar për teknologji informatike, është plotësisht funksional. Kapaciteti i internetit dhe serverëve paraqet problem, veçanërisht në momente të përgjegjësisë së madhe. Edhe pse Regjistri i fermave tani është i integruar me informata të Sistemit për identifikim të parcelave tokësore, ende nuk është arritur harmonizim i plotë ndërmjet dy regjistrave për të dhënat. Pas mbajtjes së debatave publike dhe konsultimeve, është miratuar strategji nacionale për përfundim të parcelave të tokës, e cila përfshinë edhe plan operativ. Kapaciteti institucional për përparim dhe mirëmbajtje të SIPT-së është i pamjaftueshëm.

Kapaciteti i agjencisë pagesore (Agjencia për Përkrahje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - APFBZHR) edhe më tutje është shkak për brengosje, duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë të përgjegjësive të saj. Personeli i APFBZHR-së është përgjegjës edhe për skemat nacionale për përkrahje edhe për masa të Instrumentit për ndihmë adreuese për zhvillim rural. (IPARD). Numri i tij mbetet i pamjaftueshëm edhe krahas punësimeve plotësuese. Vendosja e bazës së të dhënave për çmime referente paraqet zhvillim pozitiv në menaxhim me masat e IPARD-it.

Është vërejtur përparim në zhvillimin e sistemit të qëndrueshëm informatik në bujqësi me vendosjen e elektronike të të dhënave dhe ueb faqja e cila mundëson qasje në të dhënat e tregut. Aktivitetet e pilot rrjetit për të dhëna të kontabilitetit të fermave (FADN) vazhdon dhe tani përfshinë numër të madh të bujqve dhe lloje të fermave. Përgatitjet në sferën e çështjeve horizontale janë avancuar.

Vërehet përparim i dukshëm në fushën e rregullimit të përbashkët të tregjeve, veçanërisht për prodhimet të cilat janë me rëndësi të madhe për vendin. Harmonizimi i legjislacionit me *acquis*- vazhdon për prodhime të caktuara dhe përfshinë miratimin e legjislacionit sekondar i cili ka të bëjë me trupave të klasifikuara të kafshëve. Ekziston bazë juridike për zbatimin e masave për përkrahje të tregut, si p.sh. intervenim jo i obligueshëm për një numër të caktuar të bagëtive, përparimi i konsumimit dhe organizatat e prodhuesve. Ligji për verë u ndryshua që të sigurohet harmonizimi i plotë me *acquis*- dhe u miratua legjislacioni sekondar i cili veçanërisht e cenon regjistrimin e prodhuesve, rrushin dhe prodhimtarinë e rrushit. Harmonizimi me *acquis*- në sferën e kulturave të specializuara është në rrugë të mbarë. Harmonizimi i rregullimit të përbashkët të tregut me BE-në është i kufizuar në pjesën e shpezëve, vezëve dhe kualitetit të qumështit, ndërsa për prodhime të tjera është përcaktuar kornizë ambicioze juridike e përkohshme. Përgatitjet në këtë sferë janë

në fazë të hershme.

Vërehet përparim i vogël në sferën e zhvillimit rural. Zbatimi i programit IPARD në kuadër të komponentit të V-të vazhdon për tre masa. Kanë përfunduar pesë thirrje për parashtrimin e ofertave dhe e gjashta është në rrjedhë, për të cilën ekziston obligim prej 5,32 milionë euro përkrahje nga IPA në kuadër të komponentit të V-të. Kapaciteti absorbues për komponentin V mbetet problem i konsiderueshëm. Qeveria miratoi plan aksional për përmirësimin e menaxhimit me dhe kontrollin mbi IPARD dhe për përkrahjen e absorbimit më të madh të fondeve. Është përforcuar kapaciteti institucional i Trupit për menaxhim me IPARD të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave (MBPEU).

Vërehet përparim shumë i kufizuar në përgatitjet për zbatim të masave plotësuese IPARD. Përgatitjet në këtë sferë janë avancuar mesatarisht.

Vërehet përparim në politikën për kualitet. Është miratuar legjislacioni sekondar për t'u vendosur shenjat nacionale dhe shenjat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e kualitetit dhe të identifikohen llojet mbrojtëse të prodhimeve të ndryshme. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrugë të mbarë.

Është vërejtur përparim i mëtejshëm tek bujqësia organike. Është përmirësuar ligji për prodhimtari organike me qëllim të harmonizimit të tij me *acquis*. Numri i prodhuesve të regjistruar organike dhe prodhimtaria e plotë organike edhe më tutje rritet. Në vitin 2012 është ndarë buxhet prej 2,11 milionë euro për përkrahjen e prodhimtarisë organike, si dhe pagime plotësuese për prodhuesit të prodhimeve organike dhe përkrahje për përpunimin e tregtisë me prodhime organike. Kapaciteti Administrativ edhe më tutje nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e obligimeve të cilat dalin nga *acquis*. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrugë të mbarë.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim i caktuar në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Përparim i mëtejshëm është arritur në vendosjen e sistemit të integruar kontrollues dhe administrativ. Nevojitet harmonizimi i mëtejshëm me *acquis*. Kapaciteti administrativ në tërë sektorin edhe më tutje mbetet problem. Në përgjithësi, përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim mesatar.

#### **4.12. Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinarë dhe fitosanitare**

Është arritur përparim i mirë në **sigurinë e përgjithshme të ushqimit**. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka miratuar plan nacional shumë vjeçar për kontroll të mbikëqyrjes shtetërore mbi qarkullimin e ushqimit, dokumenti strategjik për shëndetësi të kafshëve dhe bimëve dhe programi shumëvjeçar për trajnime. Kanë filluar përgatitjet për këtë strategji për sigurinë e ushqimit (2013-2015) dhe plani i përgjithshëm për zbatimin e krizës. Është vendosur sistem i brendshëm për kryerjen e kontrollit dhe revizion në kuadër të AUV-së. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrugë të mbarë.

Vërehet përparim i mirë në sferën e **politikës veterinare**. Sa i përket sistemeve për kontroll të importit dhe kërkesave për import të kafshëve të gjalla dhe prodhimeve të kafshëve, AUV kryen azhurnime të rregullta sipas ndryshimeve të *acquis* relevant dhe masave më të reja të sigurimit të BE-së. Sistemi për kontrolle të zvogëluara të dërgesave në stacionet kufitare për kontroll ende nuk është realizuar. Kanë filluar aktivitetet për vendosjen e sistemit për identifikim dhe regjistrimin e derrave. Baza e të dhënave për identifikim dhe regjistrim të kafshëve është përmirësuar dhe paraqet pjesë qendrore nga niveli i integruar i sistemit të integruar informatik veterinar.

Është arritur përparim i mirë në sferën e masave kontrolluese për sëmundje tek kafshët. AUV zbaton program për vaksinim oral të dhelprave kundër tërbimit. Janë vendosur programe për mbikëqyrje të tërbimit dhe murtajës klasike tek derrat. Janë miratuar masa për kontroll dhe çrrënjosje të sëmundjeve vezikulare tek derrat dhe sëmundje të caktuara tek kafshët e ujit për shkak të harmonizimit me *acquis*. Është miratuar plan për rrethana të parapara gjatë çrrënjosjes të murtajës klasike tek derrat. AUV zbaton program për vaksinim masiv të derrave shtëpiakë kundër sëmundjes klasike të murtajës te derrat. Megjithatë, ekziston brengosje rreth mënyrës në të cilën është kryer vaksinimi dhe se procedura e imunitetit është e ulët. Zbatohet plani nacional për kontroll të salmonelës tek pulat. Përparim i caktuar vërehet në sferën e tregtisë në kuadër të Komunitetit me kafshë të gjalla, farë për pllenim, vezë - qeliza dhe embrione me miratimin e ligjeve për zbatim me të cilat transponohet *acquis*. Komisioni Evropian e miratoi Programin vjetor për përcjelljen e subvencioneve të ndaluara dhe kontrollin e rezervave. Është arritur përparim i caktuar në sferën e mirëqenies së kafshëve. Është miratuar legjislacioni sekondar me të cilin kryhet transponimi i mëtejshëm i *acquis*. Përparim i caktuar vërehet edhe në sferën e çështjeve zoo teknike me regjistrimin e rritjes së bagëtive dhe miratimin e ligjeve për zbatim për harmonizim me *acquis*. Buxheti 2012 për harxhimet të veterinarisë së shëndetit të kafshëve është rritur për 45% në krahasim me vitin 2011. Megjithatë vonesat e dukshme të pagimit të qendrave të autorizuara private të veterinarisë me qëllim të zbatimit të programeve të ndryshme të AUV e rrezikojnë zbatimin e tyre. Kapaciteti i laboratorëve të Fakultetit të Shkencave të Veterinarisë është përforcuar, veçanërisht për diagnozën e tërbimit dhe murtajës klasike tek derrat. Përgatitjet në sferën e politikës së veterinarisë janë avancuar.

U arrit përparim në pikëpamje të plasimit të ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe nusprodhimeve me prejardhje shtazore. U miratuan akte të caktuara nënligjore që kanë të bëjnë me rregullat për higjienë. Legjislacioni ekzistues e transponon *acquis*-in që ka ë bëjë me rregulla të veçanta, kontrolle dhe kontrolle të veçanta për prodhimet shtazore. Skemat për ndihmë të sistemit të analizës së rreziqeve dhe pikave kontrolluese kritike (NASSR) u vazhduan deri në vitin 2012 dhe u kryen trajnime për subjektet e përfshira në industrinë ushqimore. Subjektet e përfshira në industrinë ushqimore jo çdoherë i zbatojnë procedurat e bazuara të sistemit NASSR saktësisht, ndërsa kontrollet zyrtare nuk kryhen çdo herë në pajtim me kërkesat ligjore. Aktivitetet e planifikuara për përmirësimin e kualitetit të qumështit të papërpunuar ende nuk janë zbatuar.

u miratua legjislacioni dytësor që ka ë të bëjë me përparimin e nusprodhimeve me prejardhje shtazore dhe u filluan përgatitje për strategjinë për përparimin me nusprodhimet me prejardhje shtazore. Mungesa e lokacionit të arritshëm për hedhjen ose përpunimin e nusprodhimeve me prejardhje shtazore mbetet pengesa

më e madhe për zbatimin e strategjisë.

Vërehet përparim në sferën e rregullave për siguri të ushqimit. U miratuan akte nënligjore që kanë të bëjnë me sigurinë e shtesave ushqimore, ushqimit të pasuruar, ushqimit për përdorim të veçantë ushqyes, prodhimet e reja ushqimore dhe ujrat minerale; harmonizimi me *acquis*-in së pari duhet të vërtetohet. Legjislacioni ka për qëllim harmonizimin e mëtejme me *acquis*-in që ka të bëjë me etiketimin, aditivët e ushqimit, shpërbërësit me ekstraktim, aromatët, materialet që vijnë në kontakt me ushqimin, prodhimet e ngrira ushqimore, ndotësit dhe rrezatimin jonizues.

U miratua programi vjetor për ndjekjen e sigurisë së ushqimit dhe është në fazë të zbatimit. Nuk ka kriteret e kategorizimit të rrezikut të bazuar, as për kontroll të institucioneve që manipulojnë me ushqim me prejardhje joshtazore. Kapaciteti i shërbimeve inspektuese është përforcuar, por edhe më tej është i pamjaftueshëm sipas procedurave kontrolluese dhe resurseve njerëzore. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrugë të mirë.

U arrit përparim në lidhje me rregullat e veçanta për ushqim të kafshëve. U miratuan akte të caktuara nënligjore që kanë të bëjnë me aditivët e ushqimit për kafshë dhe ushqimin e medicinuar për kafshë. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrugë të mirë.

Vërehet përparim i vogël në sferën e politikës fitosanitare. U miratuan akte të caktuara nënligjore që kanë të bëjnë me shëndetin e bimëve dhe kualitetin e farave dhe materialit faror. Nuk janë marrë kurrfarë veprimesh për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për masa fitosanitare, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, certifikimin e eksportit dhe përcaktimin e statusit të dëmtuesve në sferë të caktuar. Kontrolli i vendeve për plasim të prodhimeve për mbrojtje të bimëve bëhet me zgjidhje të rastit, ndërsa nuk kryhen kurrfarë kontrollesh për zbatimin e tyre. Koordinimi ndërmjet organeve të Ndryshme për politikë fitosanitare nuk është përmirësuar. Kapaciteti administrativ i Drejtorisë Fitosanitare është i dobët.

Kapaciteti i Laboratorit Fitosanitar Shtetëror edhe më tej është shfrytëzuar për shkak se roli i tij në sistemin nacional për përcjelljen e sigurisë së ushqimit nuk është definuar dhe nuk merr ekzemplarë në bazë të rregullt. Përgatitjet në këtë sferë nuk kanë përparuar shumë.

Vërehet përparim i caktuar në harmonizimin me *acquis*- që ka të bëjë me organizmat e modifikuar gjenetikisht me miratimin mëtejme të legjislacionit dytësor.

#### *Konkluzion*

U arrit përparim i mirë në sferën e sigurisë së ushqimit dhe politikës veterinare dhe fitosanitare, veçanërisht në pikëpamje të përforcimit institucional të Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari dhe realizimin e programeve të ndryshme për çrënjtosjen e sëmundjeve të kafshët. Përgatitjet në sferën e sigurisë së ushqimit dhe politikës veterinare janë në rrugë të mirë. Përparim i vogël është vërejtur në sferën e politikës fitosanitare, ku kapaciteti administrativ dhe koordinativ i organeve kompetente nuk është përmirësuar. Nuk janë zbatuar standardet ndërkombëtare për masa fitosanitare. Përgatitjet në sferën e politikës fitosanitare janë në fazë të hershme.

#### **4.13. Kapitulli 13: Peshkataria**

Kërkesat e UE-së në lidhje me menaxhimin, inspeksionin dhe kontrollin e resurseve dhe flotës nuk kanë të bëjnë me peshkimin në ujërat tokësorë dhe prandaj nuk janë të zbatueshme, përveç atyre për kontroll të plasmanit dhe rrjedhshmërisë së

peshqve dhe prodhimeve të peshqve.

me miratimin e legjislacionit dytësor, peshkimi komercial i ujërave të ëmbla përsëri filloi pas në pauze të caktuar , në mënyrë që pas peshkimit paraprak të tepërt të mundësohet peshkim me lloje vendore.

Kapacitetet administrative të Seksionit për peshkatari dhe akuakulturë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) dhe Seksionit përkatës në kuadër të Inspektoratit Bujqësor Shtetëror edhe më tej janë të pamjaftueshme. Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme.

U arrit përparim i kufizuar në pikëpamje të aktiviteteve strukturore. U miratua legjislacioni dytësor plotësues që ka të bëjë me kontrollin dhe procedurat gjatë kontrollit të peshkimit rekreativ.

U arrit përparim i kufizuar në sferën e politikës së tregut.

Regjistri i ndihmë së miratuar shtetërore në sektorin e peshkatarisë është funksional. Megjithatë, skemat nacionale në një të ardhme duhet të harmonizohen me politikën strukturore dhe politikën për ndihmë shtetërore të UE-së, veçanërisht në lidhje me mbështetjen për peshkim në ujërat për peshkim.

Nuk ka marrëveshje ndërkombëtare formale. akoma ekzistojnë procedura joformale të punës me Shqipërinë dhe Greqinë për menaxhim me resurset e tre liqeneve ujërat e të cilave janë të përbashkët.

#### *Konkluzion*

U arrit përparim i kufizuar në sferën e peshkatarisë. Kapacitetet administrative akoma janë të pamjaftueshme. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që vendi është pjesë e madhe kontinentale e *acquis*-it e cila ka të bëjë me peshkatarinë nuk është relevante.

#### **4.14. Kapitulli 14: Politika transportuese**

U arrit përparim i caktuar në komunikacionin rrugor. Vazhdoi zbatimi i legjislacionit për takografë digjital. legjislacioni për zbatim është miratuar për orë pune, për praninë në profesionin operator për komunikacion rrugor dhe për qasje në treg. Duhet të bëhet përparim plotësues në legjislacionin në lidhje me qasjen në tregun ndërkombëtar për shërbime të autobusit me qëllim të harmonizimit me *acquis-in* më të shpejtë. Këshilli për sigurim të rrugëve punonte me buxhet të zvogëluar si rezultat i ndryshimeve të Ligjit për sigurim. Si rezultat i kësaj, numri i fushatave për siguri të rrugëve është i zvogëluar. Kapaciteti administrativ për zbatimin e politikës për siguri të rrugëve duhet të përmirësohet në mënyrë plotësuese. Inspeksionet shtetërore për transport u përforcuan, por kapaciteti administrativ i inspektoratit shtetëror për transport duhet të zmadhohet ende. edhe më tej nevojitet harmonizim plotësues me *acquis-in* më të ri për sigurimin e rrugëve dhe mallrave të rrezikshme. Përgatitjet në sektorin e komunikacionit rrugor kanë përparuar.

Mund të vërehet përparim i vogël në komunikacionin hekurudhor. Niveli i kompensimeve për qasje në hekurudhë që grumbullohen nga trenat ngarkues akoma ka ndikim negativ në konkurrencën e komunikacionit hekurudhor krahas atij rrugor dhe si rezultat i niveleve më të larta të linjës nga Korridori X, bën diskriminimin krahas komunikacionit ndërkombëtar. Procedurat afatgjata për lëshimin e licencave dhe certifikatave për siguri, bashkë me procedurat rrjedhëse gjyqësore i kthyen operatorët hekurudhorë nga hyrja në treg. Ndryshimi i Ligjit për hekurudha për mbylljen e tregut për të gjithë operatorët hekurudhorë, përveç atij

shtetëror, deri te qasja e la prapa harmonizimin me *acquis* të arritur në vitet paraprake. Detyrimet e larta dhe mbyllja e tregut në mënyrë plotësuese e prishin situatën e keqe me të hyrat e drejtuesit të infrastrukturës, pa u dhënë efektet e dëshiruara sociale pozitive në operatorin shtetëror. U themelua edhe Organi i sigurisë, por kapaciteti i tij administrativ duhet të përforcohet edhe më tej. Procedura për vendosjen e trupit të ri për hulumtim të fatkeqësive në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë akoma nuk ka përfunduar. U nënshkrua marrëveshje për pika të përbashkëta kufitare me Kosovën. Edhe më tej nevojitet harmonizim me *acquis* për hekurudha.

U arrit përparim i caktuar në sferën e komunikacionit të brendshëm ujqor. Në rrjedha janë inspektonet për siguri dhe për dhënie të licencave. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar.

Mund të vërehet përparim i vogël në komunikacionin e kombinuar. Në prill 2012 filloi përpunimi i studimit strategjik për nyjat multimodale. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedha.

U arrit përparim i caktuar në komunikacionin ajror. Ligji për aviacion u ndryshua që të vendosen subvencionet shtetërore për operatorët me qëllim të zgjerimit të turizmit dhe komunikacionit ajror. Megjithatë, harmonizimi i këtyre ndryshimeve me dispozitat e sferës së përbashkët të aviacionit evropian kontrollonhet në bazë të të dhënave që janë grumbulluar në vizitën e misionit vlerësues të vitit 2012. Deri në një të ardhme të afërt duhet të vlerësohet përparimi në lidhje me fazën e parë të marrëveshjes për EZVO të këtyre të dhënave. Mund të vërehet përparim i mirë sa i përket menaxhimit me komunikacionin ajror. Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror edhe më tej është me kuadër të pamjaftueshëm. Agjencia për Aviacion Civil, në kapacitetet e veta si organ i pavarur rregullator, i vazhdoi aktivitetet e veta, por resurset njerëzore për inspeksione edhe më tej dihet të përforcohen. Tre anëtarë u emëruan si hulumtues të pavarur për hulumtim të fatkeqësive dhe incidenteve të rënda. Pavarësia e trupit për hulumtim të fatkeqësive edhe më tej duhet të konfirmohet. Përgatitjet në sferën e komunikacionit ajror kanë përparuar mesatarisht.

Nuk ka përparim në navigacionin satelitor.

### *Konkluzion*

Ka përparim të vogël në politikën e transportit. në komunikacionin rrugor ka përparim të caktuar në harmonizimin me *acquis*, por siguria e rrugëve duhet të përmirësohet edhe më tej. Legjislacioni i hekurudhave duhet të harmonizohet në mënyrë plotësuese me *acquis*. Ndryshimi i Ligjit për mbylljen e tregut hekurudhor për konkurrencë deri në aderimin në UE e la prapa harmonizimin tani më të arritur me *acquis*. Kapaciteti administrativ i Organit për siguri të hekurudhës edhe më tej duhet të përforcohet. Komisioni për hulumtim të fatkeqësive në komunikacionin hekurudhor duhet të bëhet funksional me qëllim që të veprohet si trup i pavarur. marrë në përgjithësi, përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar mesatarisht.

### **4.15. Kapitulli 15: Energjetika**

U arrit përparim i vogël në sferën e sigurisë për furnizim. Në bazë të Ligjit për energjetikë, u miratuan disa akte nënligjore, me qëllim të harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit nacional për siguri në furnizimin me energji elektrike dhe furnizimin me gaz natyror. Në fillim të vitit 2012, rezervat e naftës u zmadhuan pak, por ende ishin të njëjta në konsum mesatar vetëm 34-ditor. Në sferën e sigurisë në furnizim, vendi është në fazë të hershme.

U arrit përparim i caktuar në sferën e tregut të brendshëm të energjisë. U miratua bilanci energjetik për vitet 2012-2016. Për tu lidhur me ligjin e ri për energjetikë, Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRE) miratoi numër të madh të rregulloreve të cilat përfshijnë të hyra të rregulluara maksimale, sisteme tarifore dhe çmime për energji elektrike. U miratuan rregulla të reja të tregut. Afatet e parapara për miratimin e legjislacionit dytësor për hapje të tregut u anuluan. si pasojë e kësaj, ë gjithë konsumatorët që nuk janë ekonomi familjare dhe të cilët nuk janë përfshirë në sistemin distributiv, ndërsa duhej t'i plotësonin kushtet pas miratimit të ligjit për energjetikë, mbeten në sistemin rregullator dhe nuk kanë qasje në tregun konkurrent. Çmimet e energjisë elektrike për konsumatorë tariforë u zmadhuan dy herë në vitin 2012, në janar për rreth 7,8%, ndërsa në gusht për rreth 9,8%. Vitin 2012, do të merren masa për lehtësimin e varfërisë energjetike që janë rreth 2,400,000 EUR për subvencionimin e ekonomive më të prekura familjare. Zbatimi i ligjit për zbatim i përmirësoi shkallët për arkëtim të llogarive për energji elektrike. Vendi duhet t'i fillojë përgatitjet për harmonizim me „pakon e tretë për tregun e brendshëm të energjisë“ të UE-së.

Bilanci energjetik për 2012-2016 parashikon zmadhim të konsumit të gazit natyror në vitin 2012 për 4,9%, si rezultat i gazifikimit në Kumanovë dhe Strumicë dhe vënien në përdorim të objektit të kombinuar për energji termike dhe elektrike. Në pajtim me ligjin e ri për energjetikë KRE miratoi rregullore për rregullimin e tarifave dhe çmimeve për bartje, transport, distribuim, furnizim dhe shitje të gazit natyror. Në bazë të kësaj, tarifat për bartje dhe funksionim të sistemit për bartje u zmadhuan për rreth 7,5%. Duhet të miratohet legjislacion plotësues për zbatim. Kontesti për pronësinë e sistemit për bartje të gazit mbetet i pa zgjidhur ndërmjet qeverisë dhe kompanisë private për distribuimin e gazit. Kapaciteti administrativ i Ministrisë së Ekonomisë mbetet i pamjaftueshëm që të mund tu përkushtojë vëmendje të gjitha sfidave në politikën energjetike. Të dhënat statistikore të miratuara nga autoritetet nacionale jo çdo herë i plotësojnë kërkesat e bashkësisë energjetike. Vendi arriti përparim në sferën e tregut të brendshëm të energjisë.

U arrit përparim i caktuar në sferën e burimeve ripërtëritëse të energjisë me miratimin e rregullores për prodhues të autorizuar të energjisë elektrike nga burimet ripërtëritëse dhe Dekreti për tarifa të autorizuar për energji elektrike nga burimet ripërtëritëse. Në vitin 2012, u ndanë 21 koncesione të reja për hidrocentrale të vogla, me çka numri i përgjithshëm arriti 68. Hidrocentrali „Shën Petku“, me fuqi të instaluar prej 36,4 MW/orë filloi të funksionojë, ndërsa filloi edhe ndërtimi i parkut të erës me fuqi të instaluar prej 36,8 MW/orë. Mjetet për ndërtim të hidrocentralit „Ura e Boshkut“ me fuqi 117,54 GW/orë u siguruan nëpërmjet huas nga Banka evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBOR) dhe të mbështetura me garanci nga Qeveria. Çmimet e ulëta të energjisë elektrike për shfrytëzuesit e fundit dhe procedurat e vështira administrative për autorizim, leje dhe licencim vazhdojnë të jenë pengesa për shfrytëzim të burimeve rigjeneruese të energjisë në vend. Përgatitjet në sferën e burimeve ripërtëritëse të energjisë janë në rrjedha, edhe pse vendi nuk e shfrytëzon në mënyrë efikase potencialin e burimeve ripërtëritëse të energjisë.

U arrit përparim i caktuar në sferën e efikasitetit energjetik. Ministria e Ekonomisë e miratoi Rregulloren për shënim të efikasitetit energjetik për pajisje të ndryshme. Qëllimi indikativ për kursime energjetike për vitin 2012 është vendosur 4,04% nga konsumi mesatar i energjisë gjatë periudhës prej 2002- 2006 . Agjencia për Energjetikë lëshoi Udhëzime për zbatimin e masave për efikasitet energjetik në furnizimet publike. U përgatit program nacional për efikasitet energjetik në ndërtesat publike dhe u diskutua nga aksionarët. 100,000 EUR u ndanë si subvencione për ekonomi familjare me kolektorë solarë për vitin 2012. Gjashtë komuna kishin përfitim nga kontrollet energjetike dhe modernizimi i numrit të madh



të ndërtesave. Agjencia për Energjetikë ka kapacitet të kufizuar administrativ për t'i kryer të gjitha detyrat në përgjegjësi të saj. Në tërësi, në sferën e efikasitetit energjetik vendi filloi të përkushtojë vëmendje të qëllimeve të veta, por legjislacioni i nevojshëm dytësor së shpejti duhet të hyjë në fuqi.

Vendi nuk ka energji nukleare.

U arrit përparim i caktuar në sferën e sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga radiacioni. Drejtoria për Siguri të Radiacionit (DSR) lëshoi rregullore për lokale, pajisje kualifikime dhe gjendje shëndetësore të personave të cilët punojnë me burime të rrezatimit jonizues. U miratua Plani strategjik i DSR-së për vitet 2012-2014, i cili ndër të tjera, shërben si udhëzues për detyrat afatmesme dhe prioritetet e DSR-së, ndërsa zbatimi i tij pritet ta përforcojë efikasitetin e transparencës së DSR-së. U formua trupi koordinues nacional për parandalim, zvogëlim dhe mbrojtje nga armët dhe materialet kimike, biologjike, radioaktive dhe nukleare.

#### *Konkluzion*

U arrit përparim i caktuar në sektorin energjetik, veçanërisht në miratimin e legjislacionit për zbatimin e Ligjit për energjetikë të vitit 2012. ende nuk janë miratuar një numër i madh aktesh për zbatim. Së shpejti duhet të arrihet liberalizim i plotë i tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. U arrit përparim i caktuar në sferën e burimeve ripërtëritëse të energjisë. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim mesatar.

#### **4.16. Kapitulli 16: Tatimimi**

Nuk ka përparim në harmonizimin e legjislacionit në sferën e tatimit indirekt. Legjislacioni për TVSH dhe legjislacioni në sferën e akcizave vetëm pjesërisht janë të harmonizuara me *acquis-in*. Akciza për disa prodhime edhe më tej mbetet më e ulët nga ajo minimale e cila është paraparë me *acquis-in*. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

Në sferën e tatimit direkt nuk është arritur përparim. Së shpejti duhet të punohet në harmonizimin në të ardhmen me Direktivën për kompani amë dhe degë, Direktivën për bashkim dhe Direktivën për kamatë dhe tanieme. disa dispozita nacionale për zona speciale për zhvillim teknologjik dhe industrial ende nuk janë harmonizuar me Kodeksin e sjelljes të UE-së për tatimim afarist. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim mesatar.

Është bërë përparim i caktuar në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë. Drejtoria e të Hyrave Publike (DHP) nënshkroi memorandum për këmbim elektronik të të dhënave me Drejtorinë për Policinë Financiare dhe Drejtorinë për Zbulim Financiar. U miratuan instruksione operative për të punësuarit në DHP në lidhje me veprimin gjatë këmbimit të informatave me organe tatimore të vendeve tjera. Numri i marrëveshjeve të lidhura me vende - anëtare të UE-së edhe më tej mbetet 23. Këto marrëveshje nuk përfshijnë kthim të borxheve as këmbim automatik të informatave. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

U arrit përparim i caktuar në fushën e kapacitetit operativ dhe kompjuterizimit. U zgjeruan autorizimet e DHP-së që të përfshihen aspektet e parandalimit të terrorizmit i cili përfshin larje parash si dhe mbikëqyrjen e lojërave të fatit. DHP-ja në mënyrë plotësuese i zhvilloi veglat e saj elektronike me zgjerimin e parashtrimit elektronik të fletëparaqitjeve tatimore nga individët, duke përfshirë arkivimin

elektronik të formularëve të TVSH-së të parashtruara me shkrim dhe duke e bërë fletëparaqitjen elektronike të TVSH-së dhe tatimit mbi fitim detyrimisht nga viti 2013. U përfshinë procedura të reja për shitjen e mjeteve të konfiskuara. DHP-ja gjithashtu miratoi rregulla të reja për zbatimin e tatimit mbi fitim, tatimin personal mbi të ardhura dhe regjistrimin e TVSH-së për pagesa me para n dorë. në sferën e resurseve njerëzore, u lëshuan drejtime të reja për parandalimin e korrupsionit të ë punësuarve në DHP. U zgjerua vlerësimi i rezultateve nga puna për tërë personalin e DHP-së. Akademia tatimore e filloi programin e saj për trajnim. Megjithatë, edhe më tej ka mungesë të të punësuarve veçanërisht në pikëpamje të parandalimit të mashtrimeve tatimore me rrezik të lartë dhe fshehjeve tatimore. Kapaciteti TI administrimit tatimor mbetet në nivel të ulët. Nevojitet përforsim plotësues i efikasitetit të inspeksioneve, arkëtimit të detyrueshëm dhe revizioneve të brendshme. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar edhe më tej.

#### *Konkluzion*

Mund të vërehet përparim i kufizuar në fushën e tatimit. Ende janë të domosdoshme përpjekjet për harmonizim të legjislacionit nacional me , për tu përforsuar parandalimi i mashtrimeve tatimore dhe fshehjeve tatimore dhe të merren parasysh kapacitetet TI dhe kapacitetet kadrovike. Përgjithësisht, përgatitjet në sferën e tatimit kanë përparuar mesatarisht.

#### **4.17. Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare**

Në sferën e politikës monetare, vendi është i harmonizuar mirë me asquis. Është arritur përparim i caktuar në përforsimin e kapacitetit institucional të Bankës Popullore me futjen e planifikimit afatmesëm strategjik dhe azhurnimin e modelit për parashikimet makroekonomike. Instrumentet e politikës monetare të cilat i shfrytëzon Banka Popullore u zhvilluan në mënyrë plotësuese. Nuk është vërejtur përparim në politikën ekonomike. Programi paraaderues ekonomik (PPE) për vitin 2012-2014 u dorëzua në kohë. Politika fiskale u drejtua ndaj ndryshimit të theksit nga shpenzimi më i vogël produktiv ndaj investimeve kapitale. Megjithatë, ky qëllim u ndryshua me rishqyrtimin e buxhetit në vitin 2012 për shkak të deficitit të madh në të ardhura. Me mbështetjen e rritur në kreditë e huaja për financimin e deficitit, ekonomia u bë më e ndejshme nga rreziqet e jashtme. Në vitin 2012 u paraqit raport fiskal. Informatat në PPE është e domosdoshme të përmirësohen në lidhje me përmbajtjen, sasinë dhe kualitetin e të dhënave. Posaçërisht, informata më të sakta jashtë vitit 2012 do të kontribuonin ndaj relevancës së tij si dokument i rëndësishëm për politikën afatmesme. Pjesa strukturore i përket numri të madh të reformave, pa u bartur ato në masa të posaçme të përcaktuara në kornizë të qartë konceptuale. Krahas obligimeve të vazhdueshme ligjore, për periudhën 2012-2014 nuk u azhurnuan Strategjia fiskale dhe strategjitë për menaxhimin me borxh publik, e as Programi për investime publike. Kapaciteti për formulimin dhe koordinimin e politikës ekonomike mbetet e pamjaftueshëm dhe në mënyrë të rëndësishme dallohen në nivel qendror dhe lokal. Në sferën e politikës ekonomike, përgatitjet kanë përparuar mesatarisht.

#### *Konkluzion*

Është vërejtur përparim i vogël në politikën ekonomike dhe monetare. Kapaciteti i krijimit të politikës monetare të Bankës popullore u përforsua në mënyrë plotësuese. Mbetet të përforsohet kualiteti i programit paraaderues ekonomik. Kapaciteti për formulimin dhe zbatimin e politikës ekonomike ende dallohet shumë ndërmjet nivelit

qendror dhe lokal. Marrë në përgjithësi, në sferën e politikës ekonomike dhe monetare është vërejtur përparim në vend.

#### **4.18. Kapitulli 18: Statistika**

Ka përparim sa i përket **infrastrukturës statistikore**. Enti shtetëror për statistikë (ESHS) e miratoi Planin strategjik për periudhën 2012-2014. U arrit përparim plotësues në këmbimin e të dhënave. Me 34 të punësuar të ri, seksioni i grupeve etnike në kuadrin e përgjithshëm të ESHS-së u rrit në 27%. Gjendja e përgjithshme me burime në ESHS duhet vtë përmirësohet në mënyrë plotësuese. Përgatitjet në këtë sferë janë të avancuara.

Mund të vërehet përparim në fushën e **klasifikimeve dhe regjistrave**. Është përmirësuar kualiteti i regjistrimit statistikor në ferma dhe u arrit përparim plotësues në kalimin ndaj NACE Rev. 2 në statistikën afariste. Megjithatë, është e nevojshme koordinim më i fortë ndërinstitucional që të përmirësohet harmonizimi i të dhënave administrative me klasifikimet e standardizuara dhe përkufizimet. Përgatitjet në këtë sferë janë të avancuara mesatarisht.

Është arritur përparim i caktuar në **statistikën e sektorëve**. Regjistrimi i popullatës dhe amvisërisë filloi në tetor të vitit 2011, por u ndërpre dhe u anulua që kur Komisioni shtetëror i regjistrimit paraqiti dorëheqje (shih Kriteret politike, seksioni 2.1 - *Demokracia dhe sundimi i së drejtës*). Si rezultat i kësaj, nuk ka të dhëna më të reja për popullatën dhe amvisërinë. Kjo ndikon në saktësinë dhe qasjen e spektrit të gjerë të të dhënave statistikore.

Është arritur harmonizim plotësues në sferën e llogarive nacionale, duke përfshirë grumbullimin e tabelave për procedurë për deficit të tepruar, llogaritje të tremujorit të BPV dhe integrimi i të dhënave të sektorëve. Është arritur marrëveshje të dorëzohet përgjegjësia për statistikave të llogaritjeve financiare të Bankës Qendrore. Përfshirja e statistikave për bilancin e pagesave është zgjeruar dhe është përmirësuar harmonizimi i statistikave për borxh të jashtëm. Mund të vërehet përparim i rëndësishëm në lidhje me përgatitjen e statistikave afariste, posaçërisht në sasinë dhe kualitetin e të dhënave të cilët barten për EUROSTATIN. Janë bërë përmirësime metodologjike në të dhënat afatshkurtra statistikore, të dhënat transportuese statistikore dhe të dhënat bujqësore statistikore.

Megjithatë, nevojitet progres plotësues drejt miratimit të standardeve të ESA 95 me qëllim të arrihet harmonizim i plotë. Në fushën e statistikave sociale, janë instaluar hulumtime të reja. Përgatitjet në fushën e statistikave sektoriale janë avancuar në nivel modest, por janë vështirësuar nga mungesa e të dhënave të azhurnuara të regjistrimit.

#### **Konkluzion**

Ka progres në fushën e statistikës, veçanërisht në harmonizimin e statistikave sektoriale dhe transferimit të të dhënave. Fillimisht duhet të arrihet harmonizim i plotë me *acquis*. Anulimi i regjistrimit të popullatës dhe mungesa e vazhdueshme e resurseve theksojnë se do të nevojitet angazhim plotësues me qëllim që të arrihet progres i konsiderueshëm në këtë kapitull. Mungesa e të dhënave të azhurnuara ndikon mbi cilësinë dhe arritshmërinë e të dhënave në statistikave sektoriale. Përgjithësisht konsideruar, në mënyrë të matur janë avancuar përgatitjet në fushën e statistikës.

#### 4.19. Kreu 19: Politika sociale dhe punësimi

Është arritur progres i caktuar në lidhje me **të drejtën e punës**. Është miratuar Ligji për këshillat evropiane të punëtorëve. Janë bërë disa ndryshime në Ligjin për marrëdhëniet e punës, me qëllim, *ndër të tjerat* të përmirësohet zbatimi efikas i të drejtës së punës. Megjithatë, mbetet i dobët bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përkatëse. Harmonizimi me *acquis*-in në këtë fushë është në fazë të hershme.

Progres i caktuar mund të shënohet edhe në fushën e **sigurisë dhe shëndetit gjatë punës**. Është ndryshuar Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe janë miratuar disa rregullore për tu harmonizuar në mënyrë plotësuere me Direktivën kornizë (Direktiva 89/391/KEE). Është filluar fushatë për ngritje të vetëdijes për mënyrat të garantohet siguri më e madhe e punëtorëve në sektorin e ndërtimitarisë. Kapaciteti inspeksional në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës mbetet i pamjaftueshëm. Zbatimi i strategjisë për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe i planit aksionar për vitin 2011-2012 është i ngadalshëm dhe mungon koordinim ndërmjet organeve përkatëse. Këshilli nacional për siguri dhe shëndet gjatë punës nuk funksionon. Ende mungon evidencë e konsoliduar e të dhënave për aksidente gjatë punës. Harmonizimi me *acquis* në këtë fushë përparon në mënyrë të matur.

Është arritur progres sa i përket **dialogut social**. Është fuqizuar roli i Këshillit ekonomik-social si forum për dialog politik. Është caktuar numër i barabartë i përfaqësuesve nga sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve në përbërjen e re të Komitetit për caktim të përfaqësimit të sindikatave dhe shoqatave të punëdhënësve. Janë formuar tre këshilla e para lokale ekonomiko-sociale në komuna. Dialogu social dypartiak dhe trepartiak është pak i përmirësuar, veçanërisht në sektorin privat dhe veçanërisht në marrëveshjen kolektive. Pjesëmarrje e rregullt nga partnerët social në procesin e krijimit të politikave është e kufizuar vetëm te çështjet për legjislacionin e punës. Kapaciteti i partnerëve socialë mbetet i dobët.

Është bërë progres i vogël në **politikën e punësimit**. Në nivel nacional është caktuar pagë minimale. Papunësia ka qenë e lartë në vitin 2011 në 31.4% dhe është rritur në mënyrë plotësuere në 31.6% në tremujorin e parë nga viti 2012. Nuk është zvogëluar punësimi në ekonominë informale. Inspektorati shtetëror i punës ka ndërmarrë masa të caktuara në nivel qendror për tu ngritur vetëdija për nevojën për luftë kundër punës së paparaqitur. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet organeve për zbatim nuk janë përmirësuar dhe pjesëmarrja në tregun e punës ende është e ulët. Papunësia afatgjatë, shkalla e lartë e papunësisë të rinjtë dhe pjesëmarrja shumë e vogël nga femrat në tregun e punës nxisin brengosje të madhe. Buxheti nacional i dedikuar për programin aktiv për tregun e punës është i vogël. Agjencia për Punësim ka vështirësi në zbatimin e masave aktive për tregun e punës. Përcjellja dhe vlerësimi i programit aktiv për tregun e punës janë të dobëta për arsye se themelohen pothuaj se vetëm në qasje bazike kuantitative analitike.

Ekziston progres i vogël në përgatitjet për pjesëmarrje në **Fondin Evropian Social**. Furnizimi i projekteve të kofinancuara nga shpërndarja e parë për Program Operativ për zhvillim të resurseve njerëzore (IPA komponenti IV) është në fazë përfundimtare dhe filloi zbatimin e shumicës së projekteve. Megjithatë, kapaciteti administrativ i dobët ka ndikim negativ mbi cilësinë e projektit dhe menaxhimin me programin.

Është realizuar progres i vogël për **përfshirje sociale**. Duhet të sigurohen resurse përkatëse institucionale dhe financiare me qëllim të zbatimit efikas të tanimë politikave të miratuar dhe planeve strategjike. Është adaptuar strategjia nacionale për reduktim të varfërisë dhe përjashtimit social për 2010-2020 të prioritetëve për BE

2020. Megjithatë, mungon buxhet përkatës për zbatim. Është siguruar mbështetje financiare për komunat e zgjedhura për zbatim të planeve të tyre lokale aksionare për përfshirje sociale. Është formuar trup nacional për përcjellje dhe vlerësim të zbatimit të strategjisë për persona të vjetër për 2010-2020. Shteti ka kryesuar me Dekadën për përfshirje të Romëve. Poashtu, është miratuar strategjia për përfshirje të Romëve për 2012-2014. Janë ndërmarrë hapa për zgjidhje të problemeve në lidhje me personat pa dokumente, qasja për banim ose arsimim. Zbatimi i planeve aksionare nacionale dhe planet operative për përfshirje të Romëve është i ngadalshëm.

Në lidhje me personat me hendikep, janë ratifikuar Konventa e OON për të drejtat e personave me hendikep dhe Protokollit Opsional ndaj Konventës. Vazhdon kalimi nga kujdesa institucionale në komunale për njerëz me hendikep; tani ka 15 njësi banesore. Megjithatë, nuk avancohet zbatimi i strategjisë nacionale për të drejta të barabarta të personave me invaliditet (për 2010-2018). Përgatitjet në këtë fushë përparojnë ngadalë.

Mund të shënohet progres i caktuar për **mbrojtje sociale**. U ndryshua Ligji për mbrojtje sociale, me çka në mënyrë plotësuese rregullohen inspeksionet dhe të dhënat për ndryshim të rezervave dhe mbikëqyrja e sistemit për mbrojtje sociale. Është vendosur sistem për arsim të vazhdueshëm për profesionistë në institucionet për mbrojtje sociale. Reformat në sistemin pensional dhe shëndetësor përparojnë. Është e nevojshme të forcohet zbatimi i ligjit për mbrojtje sociale, si dhe programi nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale për vitin 2010-2021. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet administrative. Përgatitjet në këtë sferë përparojnë mesatarisht.

Mund të vërehet përparim i caktuar për **antidiskriminim**. U miratuan strategji nacionale për barazi dhe mosdiskriminim dhe plane strategjike aksionare për vitin 2011-2015 të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD), duke propozuar masa për përmirësimin e kornizës juridike, ngritjen e vetëdijes, forcimin e kapacitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Komisioni hyri në bashkëpunim formal me trupa të tjerë adekuatë siç janë Avokati i Popullit, Komiteti Parlamentar për Mundësi të Barabarta dhe Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Resurset njerëzore dhe financiare të Komisionit dhe Sekretariati i tij mbeten të pamjaftueshme. Kapaciteti kadrovik i Seksionit për mundësi të barabarta në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale është i pamjaftueshëm. Ligji kornizë për antidiskriminim në mënyrë të rreptë nuk ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual gjatë punësimit dhe aktivitetit dhe prandaj nuk është tërësisht i harmonizuar me acquis-in. Nuk është vendosur struktura dhe analiza sistematike e të dhënave për diskriminim. Është e nevojshme të intensifikohen aktivitetet për rritjen e vetëdijes për barazi dhe mosdiskriminim.

Mund të vërehet përparim i vogël për **mundësitë e barabarta**. Treguesit në tregun e punës në lidhje me femrat janë stabile. Shkalla e punësisë së femrave mbetet shumë e vogël në krahasim me mesataren e BE-së. Vendosja e mekanizimit në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale për menaxhim me ankesat për trajtim jo të barabartë nuk funksionon drejtë. Ekziston tendencë të përzihen çështjet në lidhje me mundësitë e barabarta me ato për antidiskriminim. Plani aksionar nacional për barazi gjinore për vitet 2008-2012 zbatohet pjesë pas pjese varësisht nga financimi i jashtëm. Te Seksioni për mundësi të barabarta në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale mungojnë resurse adekuate njerëzore dhe financiare. Kapaciteti i komisioneve për mundësi të barabarta në nivel lokal mbetet i kufizuar. U arrit pak për përmirësimin e gjendjes të grave në rajonet rurale ose kushtet e femrave Rome. Përkrahja për aktivitetet për luftë kundër traditave diskriminuese, traditat dhe stereotipet mbeten të kufizuara.

### *Konkluzion*

Është bërë përparim i vogël gjatë arritjes së inkluzionit efikas të tregut të punës. Papunësia shumë e lartë mbetet sfidë shumë e madhe, në veçanti në lidhje me femrat dhe të rinjtë. Dialogu social është përmirësuar, por është e nevojshme të forcohet në mënyrë plotësuese roli i partnerëve social. Varfëria mbetet e lartë, kurse përfshirja e Romëve, personave me invaliditet dhe personave tjerë socialë të përjashtuar është e kufizuar. Janë të nevojshme përpjekje plotësuese për antidiskrimim. Është e nevojshme të përforcohet kapaciteti i plotë administrativ me qëllim që të shpejtohet zbatimi. Në tërësi, përgatitjet në këtë sferë nuk janë shumë të avancuara.

#### **4.20. Kreu 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale**

Është vërejtur përparim i caktuar në sferën e principeve të **ndërmarrjeve dhe politikës industriale**. Projekti "Gjotina Rregullatore" edhe më tej ishte fokusuar në thjeshtësimin e kërkesave operative për zejtarë dhe ndërmarrje të vogla. U miratuan 80 masa për përmirësimin e konkurrencës së ekonomisë lokale. Është përmirësuar regjistrimi i të dhënave dhe funksionaliteti dhe interperabiliteti në Regjistrin Qendror. Organet nacionale mbanin bashkëpunim të afërt me përfaqësuesit nga sektori i biznesit. U formua Këshilli Nacional për sipërmarrësi dhe konkurrencë, si trup i përbashkët i sektorit publik dhe privat. Baza qendrore e të dhënave në të gjitha projekt aktet ligjore është në funksion; niveli i reagimit ose dhënia e vërejtjeve për propozim-ligjet nga palët e prekura (steikholler) duke shfrytëzuar këtë mekanizëm mbetet shumë i ulët.

U arrit përparim i caktuar në sferën e **instrumenteve të ndërmarrjeve dhe politikës industriale**. Sipërmarrësit dhe inovacioni u promovuan fuqishëm nëpërmjet projektit "Fabrika të biznes ideve". Rreth 120 firma e shfrytëzuan programin për subvencionim të shërbimeve këshillëdhënëse. U regjistruan tre klasterë të rinj, duke u bërë gjithsej 18. Megjithatë, mjetet buxhetore të shpërndara për programe për ndihmë në pajtim me Sektorin për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe Agjencia për Përkrahje të Sipërmarrësisë mbeten të pamjaftueshme. Me Ligjin për llogari u parapa zbatim më i mirë i marrëveshjeve, prapëseprapë, zbatohet vetëm për transaksione ndërmjet subjekteve nga sektori privat e jo ndërmjet subjekteve nga sektori privat dhe publik. Në vend ende nuk ka numër të mjaftueshëm të kërkesave të paraqitura për shfrytëzimin e mjeteve të cilat janë vendosur në dispozicion në pajtim me programin për konkurrencë dhe inoalicone të BE-së. Me Bankën Evropiane Investuese ishte kontraktuar linjë kreditore për 100 milionë euro plotësuese për sektorin privat. Qeveria edhe më tej jep subvencione që ta mbajë shkallën e ulët të kamatës për shoqëritë tregtare. Edhe më tej duhet të formohet portali për MSP, që kontribuon rëndë të vihet deri te informacionet relevante për MSP. Është arritur përparim mesatar në përgatitjet në fushën e instrumenteve të ndërmarrjeve dhe politikave industriale.

Është arritur përparim i caktuar në fushën e **politikave sektoriale**. Qeveria e miratoi strategjinë nacionale për zhvillim të turizimit. Vazhduan kampanjat intensive për promovim dhe ishin ndarë subvencione me qëllim që të tërheqin turistë nga jashtë. Komuna të shumta i ulën tatimet e tyre lokale për ndërtimin e hoteleve, restoranteve dhe institucioneve tjera në shumë deri në 95%. Zejtaria lokale ishte përkrahur me subvencione për blerjen e pajisjes. Megjithatë, mjetet buxhetore të ndara për strategjinë për zejtarë janë të kufizuara. Është e nevojshme të forcohet korniza e

politikave për zhvillim të gjelbër.

#### *Konkluzion*

Është vërejtur përparim i caktuar në sferën e ndërmarrjeve dhe politikës industriale. U miratuan strategji të ndryshme dhe masa, duke e treguar përpjekjen e fuqishme për përmirësimin e rrethit të biznesit. Zbatimi edhe më tej është ndarë mes moskoordinimeve të shumta dhe trupave financiare të pamjaftueshme . Masat në të ardhmen duhet të bëhen tërësisht efektive.

#### **4.21. Kreu 21: Rrjetet transevropiane**

Është arritur përparim i caktuar në **rrjetet transevropiane**. Vendi mban bashkëpunim aktiv sipas Memorandumit për mirëkuptim në lidhje me zhvillimin e rrjetit më të rëndësishëm transportues rajonal. Organet e pushtetit kontribuan në zbatimin e Memorandumit për mirëkuptim në lidhje me zhvillimin e rrjetit transportues juglindor evropian që ishte përfshirë në revizionin e drejtimeve për rrjetin transportues transevropian të propozuara nga Komisioni në tetor 2011.

Rekonstruimi në aeroportin e Ohrit dhe zgjerimi i pistës së aeroportit të Shkupit ishin kryer sipas marrëveshjes për koncesion. U nënshkruan marrëveshje për ndërtimin e aksit të autostradës përgjatë Korridorit X të observatoriumit transportues të Evropës Juglindore, nga Demir Kapia deri në Smokvicë, kofinancuar nga fondet IPA dhe punët ndërtimore filluan në shtator 2012. Pjesa që mungon në Koridorin hekurudhor VIII drejt Bullgarisë, kofinancuar nga fondet e kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor, do të kalojë në fazë detale projektuese. Duhet të forcohet kapaciteti administrativ dhe teknik. Përgatitjet në sferën e rrjeteve transportuese kanë përparuar mesatarisht.

Ka përparim të vogël në rrjetet energjetike. Vazhduan aktivitetet përgatitore në lidhje me ndërtimin e largpërçuesit të ri prej 400 kV me Serbinë. Janë përgatitur studime fizibiliteti për ndërtim të rrjetit të ri të largpërçuesit prej 400 kV mes Manastirit dhe Elbasanit dhe për zhvillim të sistemit nacional për gazifikim. Në sferën e rrjeteve për energji elektrike, vendi shënon përparim mesatar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e rrjeteve telekomunikuese. Është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim me BE-në në lidhje me programin për përkrahje të politikave për teknologji informative dhe komunikuese nga programi kornizë për konkurrencë dhe inovacione, duke siguruar qasje te programi.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim në sferën e rrjeteve transevropiane. Në përgjithësi, vazhdon zhvillimi i rrjeteve transportuese, energjetike dhe telekomunikuese dhe vendi në mënyrë aktive merr pjesë në opservatorin Transportues të Evropës Juglindore dhe Bashkësisë Energjetike. Në këtë sferë, përgatitjet kanë përparuar mesatarisht.

#### **4.22. Kreu 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

Në lidhje me kornizën ligjore, nuk ka përparim në sigurimin e programimit shumëveçar, fleksibilitetit buxhetor dhe kapaciteteve për kofinancim në nivel nacional dhe lokal. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për zbatimin e politikave të kohezionit në pajtim me rregullat dhe politikat e UE-së, në veçanti në sektorin e mjedisit jetësor. Në këtë sferë përgatitjet shënojnë përparim mesatar.

Ka përparim të kufizuar në lidhje me kornizën institucionale. Përmirësim i konsiderueshëm është i nevojshëm me qëllim që të rritet efikasiteti i strukturave operative për përgatitjen e zbatimit të projekteve në pajtim me ato paraprake me fondet Strukturore, komponentat III dhe IV të IPA. Përgatitja e projekteve për mjedisin jetësor nga ministria adekuate mbetet alarmuese. Sisteme më efikase për kontroll dhe menaxhim janë të nevojshme që të sigurohet vazhdimi i aktiviteteve dhe pagesave në pajtim me komponentat III dhe IV të IPA dhe për parandalimin të përsëritjes së mangësive të konstatuara paraprake. Koordinimi mes ministrive në suaza të strukturave operative duhet të forcohet më tej . Në këtë sferë përgatitjet shënojnë përparim mesatar.

Në sferën e **kapaciteteve administrative** shënohet kufizim i përparuar. Përkrahja teknike dhe trajnimi për institucionet e përfshira në zbatimin e IPA vazhdojnë. Analiza e nevojshme për trajnim ishte kryer nga ministrinë resoriale, Fondi Nacional dhe Sektori për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve (CFCD). Plani për trajnim vetëm pjesërisht u zbatua për shkak të vëllimit të madh të punës. Gjendja me personelin keqësohet pasi që autorizimet për menaxhim u bartën në institucionet adekuate në vitet 2009 dhe 2010. Analiza e vëllimit të punës zbuloi nevojën për përforcimin esencial të kapacitetit të personelit për zbatim të ndihmës paraaduese, duke e përfshirë analizën adekuate. Politika efikase për mbajtjen e personelit të trajnuar është me rëndësi të veçantë. Janë të nevojshme përpjekje më të mëdha për sigurimin e menaxhimit efikas dhe koordinim të të gjitha projekteve të planifikuara Kapaciteti administrativ i vendit në këtë sferë mbetet i pamjaftueshëm.

Në lidhje me **programimin**, është arritur përparim i caktuar. Programi operativ për zhvillim të resurseve njerëzore nga komponenta IV e IPA-s është reviduar për ndarje plotësuese financiare për vitin 2013-2013. Revizioni i programit operativ për zhvillim rajonal të komponentës III të IPA-s nuk ka mbaruar. Njohja dhe përgatitja e projekteve kompatible me qëllimet dhe mjetet e programeve operative, në veçanti në sektorin e mjedisit jetësor me komponentin III të IPA-s bëhet më e vështirë. Dokumentacioni i tenderit dhe procedurat për furnizime duhet të përmirësohet Janë të nevojshme koordinime më të përafërta dhe pjesëmarrje aktive nga të gjitha palët e intersuara në procesin e programimit. Në këtë sferë përgatitjet shënojnë përparim mesatar.

Ka përparim të caktuar në sferën e **monitorimit dhe vlerësimit**. Komitetet sektoriale monitoruese takohen rregullisht. Sistemet për menaxhim me informacione (SUI) janë në proces të shpërndarjes së plotë operative dhe doracakët për procedura dhe drejtime për struktura operative përfshijnë udhëzime te SUI. Do të jetë i nevojshëm përsosje e mëtejshme dhe mirëmbajtje e qëndrueshme . Doracaku për monitorim programor dhe vlerësim i përgatitur nga koordinatori nacional i IPA-s duhet të mbarohet duke përfshirë linjën efikase për njoftim. Vlerësimi i përkohshëm nga komponentat II dhe IV të IPA-s u përfunduan. Duhet të ndiqen rekomandimet adekuate. Kapaciteti administrativ për monitorim dhe vlerësim duhet të përforcet më tej . Në këtë sferë përgatitjet shënojnë përparim.

Në sferën e **menaxhimit financiar, kontrollit dhe revizionit**, është arritur përparim i caktuar. Udhëheqësia e lartë e organit të revizionit të IPA-s u zëvendësua në maj dhe buxheti i saj për vitin 2012 u rrit pak. Mungesa e personelit në CFCD përsëritet dhe me urgjencë duhet të trajtohet. Kapaciteti për menaxhim financiar adekuat duhet të përforcet më tej me qëllim që të sigurojë sistem efikas për



kontroll dhe menaxhim me fondet e BE-së. Seksioni për revizion të brendshëm në ministritë resoriale formalisht themelohen dhe kanë personel, por nuk kanë njohuri të mjaftueshme të qëllimeve dhe procedurave të IPA-s.

#### *Konkluzion*

Ka përparim të kufizuar në sferën e politikës rajonale dhe koordinim të instrumenteve strukturore. Menaxhimi me programet e IPA-s duhet të përmirësohet me qëllim që të sigurohet absorbim me kohë i fondeve të UE.-së Janë të nevojshme përpjekje plotësuese për trajtim të lëshimeve në sistemin për menaxhim, kontroll dhe revizion. Në veçanti, personeli dhe kualifikimet në suaza të strukturave operative dhe CFCD duhet të përforcohen esencialisht. Në përgjithësi, në këtë sferënpërgatitjet shënojnë përparim mesatar.

#### **4.23. Kapitulli 23: Gjyqësia dhe të drejtat themelore (shih dhe Kriteret politike)**

Është arritur përparim në sferën e **gjyqësisë**, por çështjet kryesore mbeten të zgjidhen.

Është arritur përparim i vogël në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë. Edhe pse zbatohen masa themelore mbrojtëse, duke e përfshirë rolin dhe përbërjen e Këshillit Gjyqësor, në praktikë janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme që të garantohet pavarësia dhe miratimi i vendimeve të drejta nga gjykatat. Janë të nevojshme përmirësime në sistemin për vlerësim dhe avancim, ku theks të veçantë kriteret kuantitative në vend të atyre kualitative për vlerësim e krijon rrezikun e miratimit formal të vendimeve. Bazat ekzistuese për shkarkimin e gjykatësve nuk janë të qarta, precize dhe të parashikueshme, që do mund të paraqesë kërcnim potencial për pavarësinë gjyqësore.

Sa i përket profesionalitetit dhe kompetencës së gjyqësisë, në fuqi hynë kriteret më të rrepta për pranim të trajnimit fillestar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (AGJPP), lidhur me vërtetimin e njohurive akademike dhe njohjes së gjuhës angleze. Gjenerata e katër nga nëntë studentë të diplomuar të AGJPP-së e përfundoi trajnimin fillestar në janar 2012. AGJPP-ja, gjithashtu, vazhdoi të sigurojë trajnime rrjedhëse për gjykatës, prokurorë, personel gjyqësor dhe për organet me autorizime të veçanta, me gjithsej 290 trajnime të ndryshme, të zbatuara gjatë periudhës për njoftim në të cilën merrnin pjesë 9571 pjesëmarrës. Buxheti i AGJPP-së për vitin 2012 u rrit për 10%, për rreth 425.000 euro; prapëseprapë, ende nuk ka hapësira dhe kuadër adekuat, duke pasur parasysh vëllimin e madh të aktiviteteve.

Kushti që të gjithë gjykatësit e ri të emëruar nga instanca e parë duhet të kenë mbaruar në AGJPP, ende nuk ka hyrë në fuqi. Edhe krahas dispozitave kalimtare të cilat parashohin se 50% nga emërimet e tilla duhet të jenë studentë të diplomuar nga AGJPP-ja, Këshilli Gjyqësor vazhdon tu japë përparësi më të madhe kandidatëve të cilët nuk kanë diplomuar në AGJPP. Nga 26 vende të lira në gjykatat themelore gjatë vitit 2011, Këshilli Gjyqësor emëroi vetëm 2 studentë të diplomuar nga AGJPP-ja dhe 22 kandidatë të cilët nuk kanë mbaruar në AGJPP (2 vende nuk u plotësuan), edhe krahas shkallës solide të aplikacioneve nga studentët e diplomuar të AGJPP-së. Kjo shkallë shkakton brengosje për kredibilitetin e dispozitave të tanishme dhe përkujdesjen e Këshillit Gjyqësor për punësim në bazë të meritave.

Në sferën e *përgjegjësisë*, 9 gjykatës u shkarkuan gjatë vitit 2011, kurse asnjë nuk ka marrë masë disiplinore. Nuk kishte raste të heqjes së imunitetit të gjykatësit nga Këshilli Gjyqësor në lidhje me procedurat penale kundër gjykatësve. Këshilli

Gjyqësor shqyrtoi 2.081 ankesa të parashtruara nga individë dhe kompani kundër gjykatësve dhe gjykatave gjatë vitit 2011. Arsye më e shpeshtë ishte gjatësia e procedurave gjyqësore. Ministria e Drejtësisë morri 658 ankesa në lidhje me zgjatjen e procedurës (rënie prej 952 në vitin 2010). Gjykata Supreme morri 1.884 ankesa gjatë vitit 2010 në lidhje me procedurat e paarsyeshme të gjata që paraqesin rritje prej 389 në vitin 2010. Në periudhën e njëjtë, ai vërtetoi 195 ankesa dhe lejoi kompensim në 180 raste. Shuma e përgjithshme e paguar ishte rreth 136.000 euro. Këshilli i shkallës së dytë në suaza të Gjykatës Supreme, i cili i shqyrtoi ankesat e këtij lloji të procedurës e rriti kompensimin në 17 raste.

Për sa i përket efikasitetit të gjyqësisë, përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për të siguruar mbledhjen dhe monitorimin e treguesve të saktë statistikorë, të tilla si norma e rasteve të përfunduara dhe u merr kohë gjykatave. Metodologjia për statistika gjyqësore për vitin 2011 ende nuk është kryer sistematikisht dhe softueri i lidhur me të ende nuk është në funksion. Trajnimi dhe ndërgjegjësimi nevojiten që të sigurohet se të gjitha gjykatat përdorin mjete të njëjta statistikore. Nuk ekziston asnjë mekanizëm për monitorimin që mbulon tërë kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, duke përfshirë të gjitha fazat dhe rastet, si dhe zbatimi i të cilit tani është nën juridiksionin e punonjësve profesionalë. Ky është instrument themelor për zbulimin e anulimeve të paarsyeshme dhe të arsyeve të tyre. Nuk ka sistem të zbatueshëm me të cilin do të identifikohen, dhe do të jepet prioritet "rasteve të vjetra" të cilat janë në sistemin gjyqësor për disa vite. Edhe krahas disa ligjeve dhe kampanjave për promovim të ndërmjetësimit, zgjidhja alternative të kontesteve ende është në nivel të ulët.

Është arritur përparim në uljen e numrit të përgjithshëm të rasteve të pazgjedhura në vend. Në dy vitet e fundit, 27 gjykata të shkallës së parë dhe 4 gjykatat e apelit zgjedhën së bashku një numër dukshëm më të madh të rasteve se sa kishin fituar. Kjo është pjesërisht për shkak të masave organizative, të tilla si kuotat mujore të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor. Megjithatë doemos duhet të kihet kujdes që të sigurohet se produktiviteti nuk ka prioritet mbi cilësinë aktgjyqësive. Ende ka probleme në Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Administrative, ku grumbullohen rastet e pazgjidhura për disa vite. Në prill 2012, Këshilli Gjyqësor përkohësisht zhvendosi katër gjykatësit nga Gjykata e Lartë Administrative në Gjykatën Administrative, me qëllim që të zgjidhet problemi. Numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura në gjykatat nacionale nga të gjitha instancat në fund të 2011 ishte 295.769. Në moment nuk ekziston sistem që të përcaktohet një pjesë nga këto raste paraqesin mbetje të rasteve të vjetra drejt rasteve të rregullta në rastet. Duke pasur parasysh dallimet momentale në vëllimin e punës të instancave të ndryshme gjyqësore, është e nevojshme të caktohen hapat që të sigurohet distribuim më efikas i resurseve njerëzore, duke përfshirë gjykatat, prokurorët dhe personelin gjyqësor, aty ku janë më të nevojshme. Në veçanti, strategjitë e ardhshme për resurse njerëzore dhe financiare duhet të mbajnë llogari për nevojat reale dhe nevojat e planifikuara të sistemit gjyqësor, dhe të themelohen në tregues të besueshëm gjyqësorë.

Buxheti gjyqësor për vitin 2012 është rreth 29 milion euro ( ose 0,4% nga BPSH), nga i cili 80 deri 85% është harxhuar për roga të gjykatësve dhe personelit administrativ. Numri momental i gjykatësve ( 678) është mbi 50% më i lartë nga mesatarja evropiane në raport të numrit të popullatës, kurse buxheti gjyqësor është një nga përqindjet më të larta nga BPV për banor. Strategjitë gjyqësore duhet të vlerësojnë qëndrueshmërinë e këtij shpenzimi, dhe duhet të fillojnë ta planifikojnë racionalizimin gradual të rjetit gjyqësor. Buxheti i Prokurorisë Publike është rreth 5.3 milion euro. Pjesa më e madhe (83%) harxhohet në roga , deri sa tjetra është e pamjaftueshëm që të mbulohet përfshirja e nevojshme e infrastrukturës IT të

prokurorisë, në veçanti në lidhjet me Sistemin e menaxhimit automatik me lëndët gjyqësore (SAUPS) të gjykatave, që duhet të zbatohet.

Gjykatat nga të gjitha instancat vazhduan të publikojnë aktgjykime në ueb faqet e tyre ( mbi 90.000 gjatë vitit 2011), që është mjet i rëndësishëm në promovimin e transparencës dhe qasjes te drejtësia. Sistemi duhet të thjeshtohet për përdorim, nëpërmjet klasifikimit të aktgjykimeve sipas lëndëve dhe nëpërmjet përfshirjes së funksionit të kërkimit.

Buxheti për ndihmë juridike për vitin 2012 është dyfish më i madh nga viti i kaluar dhe arrin 200.000 euro; 213 avokatë dhe 4 OJQ janë regjistruar të sigurojnë ndihmë juridike, prapëseprapë numri i rasteve ende është shumë i vogël.

Momentalisht, nuk ka fuqi strategjia për reforma në gjyqësi ose plan aksionar të cilat do lidhen me ato paraprake të cilat datojnë nga 2004-2009. Rekomandohet të zhvillohet strategji e re me qëllim të lehtësohet planifikimi strategjik, buxhetim dhe ndjekje të ngjarjeve të ardhshme të këtij sektori.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **politikave të antikorrupsionit**.

U miratuan ndryshime në Ligjin për financim të e partive politike të cilat i dhanë rol udhëheqës Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) në mbikëqyrje të financimit politik. Ende janë të nevojshme përpjekjet në praktikë që të sigurohet se ESHR merr qasje proaktive në hetim dhe zbatim, si dhe të sigurojë revizion të raporteve vjetore të partive politike dhe zbatim efikas të sanksioneve për kundërvajtje të rregullave për financim, në pajtim me rekomandimet e GREKOS. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave ishte ndryshuar dhe u miratua akt nënligjor në të cilën është përcaktuar procedura për kontroll të deklaratave nga funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar. Kodi penal ende duhet të ndryshohet, me qëllim që të ndërpritet mundësia gjykatat ta kthejnë rryshfetin personit i cili e ka dhënë dhe e ka paraqitur kundërvajtjen para se ajo të zbulohet.

Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK) i miratoi Programet vjetore për parandalim dhe represion të korrupsionit dhe për parandalim dhe uljen e konfliktit të interesit, së bashku me planin aksionar për vitin 2011-2015 duke siguruar masa antikorrupsioni në 11 sfera të ngjashme me korrupsionin të cilat përfshijnë financimin e partive politike, furnizime publike, shërbime shëndetësore dhe sociale, dogana, medie dhe gjyqësi. Këto programe nuk janë miratuar as lejuar në nivel qeveritar, që mund ta ul fuqinë dhe ndikimin e tyre.

Kapaciteti administrativ i organeve të obliguara për luftë kundër korrupsionit u përmirësua pak, me çka KSHPK morri një anëtar të ri, kurse Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme morri 11. Njësia e antikorrupsionit e Qendrës për Çrrenjosje të Krimin të Organizuar ende punon me 65% nga kapaciteti i tyre ( 11 nga 17 vende janë plotësuar). Në vitin 2012, buxheti i KSHPK-së u rrit për rreth 5%, kurse u ble dhe IT pajisje e re.

Në vitin 2011, KSHPK-ja pranoi 267 ankesa për korrupsion ( 40 % më pak se në 2010) dhe paraqiti 10 kërkesa deri te Prokurori Publike (JO) të iniciojë procedurë penale për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Pas zgjedhjes në vitin 2011 KSHPK ngriti procedurë kundërvajtëse kundër katër organizatorëve të kampanjës zgjedhore, sepse nuk kanë dorëzuar raporte financiare, dhe tri iniciativa për hetim penal për financim ilegal të kampanjës zgjedhore.

Kishte 125 aktgjykime për vepra penale lidhur me korrupsion në 2011, dhe 74 aktgjykime në gjashtë muajt e parë nga 2012 Veprat penale për rryshfet arrijnë më pak se 10% nga aktgjykimet, derisa më shumë kanë të bëjnë në keqpërdorimin e funksioneve publike. Në krahasim me 2010, gjykatat shqiptuan dënime më të

ashpra për vepra lidhur me korrupsionin. Urdhrat për konfiskim dhe marrjen e pronës mbetet si përjashtim. Dispozitat nga Kodi Penal për konfiskim të zgjeruar, pasurim të paligjshëm dhe përgjegjësi penale të personave juridikë në të ardhmen e afërt duhet të zbatohen në praktikë. Rallë shfrytëzohen masa të veçanta hetimi për zbulim dhe hetim të veprave korruptive. Vendimet nga prokurorët publikë, të mos ngritin akuza ende nuk janë lëndë e revizionit gjyqësor.. Kërkesat e KSHPK-së dhe ESHR-së të paraqitura te PTH-ja për të filluar hetimi penal, nuk rezultojnë me aktgjykime, që e dëshmon se efikasiteti i mekanizimit ekzistues për udhëzim duhet të përmirësohet. Grumbullimi i të dhënave joadekuate statistikore dhe ndarja mes trupave të ndryshme për zbatimin dhe parandalim e pengon identifikimin e sferave problematike.

Duhet të përmirësohet kapaciteti i përgjithshëm i gjykatave për parandalimin e rasteve të korrupsionit, në veçanti rasteve për profil të lartë të korrupsionit . Është mbajtur procedurë për numër të vogël të rasteve në korrupsion në nivel të lartë dhe të gjitha rastet mbeten në sistemin gjyqësor shumë vite, pasi që do të kthehen në rigjykim pas ankesës për hulumtim joadekuate të provave nga gjykata e instancës së parë.

Spektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme ngriti 15 procedura penale për vepra lidhur me korrupsionin në 2011. Pjesa më e madhe e akuzave ka të bëjë me keqpërdorim të pozitës zyrtare. Spektori ngriti 530 procedura disiplinore në vitin 2011 (në krahasim me 556 në 2010). Drejtoria e Doganave e forcoi sistemin e tij për kontroll të brendshëm. Në 2011 u ngritën 42 procedura disiplinore kundër nëpunësve të doganave (në krahasim me 21 në 2010). Në 26 raste u zbatuar masa disiplinore, kurse në 5 raste u paraqitën kallëzime penale (në krahasim me 1 rast në 2010).

Sa i përket aktiviteteve për parandalim nga korrupsioni, KSHPK-ja vazhdoi të zbatojë kontrole për zgjedhje të rastësishme të listave anketuese. Pas kontroleve të kryera në 2011, KSHPK-ja paraqiti 48 kërkesa te Drejtoria e të Hyrave Publike për të ngritur procedura për hetim të pronësisë. Si rezultat i asaj, 10 funksionarë të zgjedhur dhe të emëruar u ngarkuan me 70% shkallë tatimore nga të hyrat e tyre të paraqitura. Në vitin 2011, KSHPK pranoi 425 deklaratat për interes. KSHPK-ja përpunoi 128 raste të konfliktit të mundshëm të interesit, vërtetoi konflikt në 37 raste dhe lëshoi paralajmërim publik në 8 raste. Efikasiteti i legjislacionit të ri për zbatimin kontrollit sistematik duhet të rregullohet.

Ligji për qasje të lirë te informacionet me karakter publik mbetet i pamjaftueshëm . Përjashtim për qasje te informatat me karakter publik nuk janë të formuluar qartë, duke lënë hapësirë për interpretim të pabazë. Sanksionet e përcaktuara në ligj nuk janë të qarta dhe nuk zbatohen në praktikë. Partitë politike janë përjashtuara nga lista e poseduesve të informatave.

Në vitin 2011 Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë zbatoi 15 trajnime për 353 pjesëmarrës në luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Vazhdoi trajnimi intensiv i ligjit të ri për procedurë penale për gjykatës dhe prokurorë publikë.

Është arritur përparim i kufizuar dhe i caktuar në sferat e të **drejtave themelore**.

Është arritur përparim i caktuar në raport të parandalimit torturës dhe veprimit të keq dhe luftës kundër mosndëshkimit. Personeli i mekanizimit preventiv nacional nga zyra e Avokatit të Popullit kryen vizita të rregullta në burgje. Zyrat duhet të sigurojnë resurset e nevojshme buxhetore dhe njerëzore. Spektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka rritur kapacitetin e tij për të hetuar akuzimet e keqtrajtimit, por në të ardhmen e afërt duhet t'i jepet autorizim për të shqiptuar sanksione efikase. Mbetet mungesa e pavarësisë së funksionimit të kontrollit të brendshëm të policisë. Në 2011, 63 ankesa lidhur me përdorimin joproporcional ose joligjor të forcës fizike ose të paligjshme nga pjesëtarët e policisë, nga të cilët të gjithë ishin hetuar, 8 janë konsideruar si të

bazuara mirë dhe sollën shqiptimin e sanksioneve disiplinore. Kanë vazhduar akuzat lidhur me keq-trajtimin e personave të arrestuar në paraburgim policor nga inspektorët e krimit dhe nga anëtarët e njësisë "Alfa". Në 2011 nga 14 ankesa të cilat kanë të bëjnë me njësitin "Alfa", te prokurori publik janë dërguar 7, kurse për 8 vijojnë masa disiplinore. Është arritur përparim i caktuar në sferën e sistemit të burgut.

Numri i madh i masave u miratuan për risocializim të personave të dënuar. Është bërë doracak për vlerësimin e rrezikut duke identifikuar rreziqet dhe nevojat e të burgosurve. U miratuan procedura standarde në raport të menaxhimit me institucionet korrigjuese ndëshkuese, në veçanti procedurat për kontroll të higjienës, pranim dhe trajtim të të burgosurve, si dhe procedurat për zgjedhjen e sjelljes së dhunshme, punës, ikjes dhe vizitës së të burgosurve. U mbajtën aktivitete të shumta për trajnim të personelit të burgut. Vazhdoi zbatimi i projektit të madh për ripërtëritje të burgjeve. Megjithatë, në të ardhmen e afërt duhet të përgatitet strategji nacionale gjithëpërfshirëse për sistemin e burgut. Kapaciteti administrativ nga Drejtoria për Kryerjen e Sanksioneve dhe institucionet korrigjuese ndëshkuese është e dobët. Në të ardhmen e afërt duhet të vihen në praktikë programe të specializuara për veprim me grupet e prekura. Mungesa e mjeteve financiare edhe më tej është e kufizuar për qasjen e personave të dënuar te shërbimet adekuate shëndetësore. Aktivitete profesionale arsimore dhe aktivitete tjera për rehabilitim të të burgosurve mbeten jo adekuate.

Në raport të lirisë së shprehjes së medieeve, korniza ligjore është vendosur përgjithësisht, por ajo duhet të tërheq vëmendjen që të sigurohet se ajo zbatohet në mënyrë konsekuente, transparente dhe në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Qeveria i miratoi propozimet për dekriminalizim të shpifjes nëpërmjet ligjit të ri për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, i cila ka për qëllim të harmonizohet me principet adekuate të GJEDNJ . Kodi penal duhet të ndryshohet në pajtim me këtë qasje. U zbatua trajnim për nenin 10 nga GJEDNJ për gjyqësi dhe gazetari. Mbi 40 aktgjykime nga GJEDNJ në lidhje me nenin 10 u parapanë dhe u publikuan ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Akademia për gjykatës dhe prokuror publik. Duhet të vazhdojë trajnimin e mëtejshëm për të cilat merren me rastet e shpifje me qëllim të sigurohet se principet e GJEDNJ-së u zbatuan në praktikë nga gjykatësit.

Në raport të lirisë të takimit dhe bashkimit, situata gjithëpërfshirëse është e kënaqshme. Nuk kishte raste të keqpërdorimit të legjisllacionit ose ndalim për regjistrim.

Në përgjithësi është siguruar liri e mendimit, vetëdije dhe religjion

Është arritur përparim mesatar për të drejtat e femrave dhe barazinë gjinore. Është miratuar ligj i ri për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve Në sektorin për politikën e mundësive të barabarta pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale i mungojnë profesionaliteti adekuat personel dhe buxhet. Në komisionet lokale për mundësi të barabarta gjithashtu mungon profesionalizimi. Në praktikë ekziston hamendje e kapacitetit dhe mundësi të barabarta dhe antidiskriminim, që është lëndë e brengosjes. Janë bërë përpjekje të caktuara për zgjedhjen e nevojave shëndetësore të femrave mirëpo për shkak të kufizimeve financiare, vetëm numër i kufizuar i grave mund të përfitojnë nga përmirësimi. Përkrahje e pamjaftueshme e planit aksionar nacional për femrën Rome e bën zbatimin e tij pothuaj të pamundshëm. Pjesëmarrja e femrave në miratimin e vendimit në shoqërinë mbetet e ulët, në veçanti në nivel lokal.

Është arritur përparim i caktuar i kufizuar në sferën e të drejtave të fëmijëve. Janë

paraparë ndryshime në Ligjin për familje dhe Ligjin për arsim fillor për përforcimin e kornizës ligjore për adoptimin e fëmijëve dhe për përfshirjen e grupeve të cenushme në arsim. Është themeluar Trup nacional koordinues për mbrojtjen e fëmijëve. Qendrat për punë sociale ishin të pajisura me bazë të re të dhënave dhe sistem për menaxhim me raste për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve sociale të cilat i shfrytëzojnë fëmijët nga grupet e cenushme. Megjithatë, vlerësohet se vetëm 15% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë të përfshirë në arsim, kryesisht në institucionet e specializuara. Mungesa e psikologëve dhe defektologëve të punësuar në shkolla dhe diskriminimi i vazhdueshëm i fëmijëve me nevoja të veçanta, e pengon përfshirjen e tyre në sistemin arsimor. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale filloi aktivitete që të sigurohet regjistrimi i fëmijëve pa dokumente. Vlerësohet se ka rreth 1.000 fëmijë në rrugë, pothuajse të gjithë Romë. Numri i rasteve të paraqitura për keqpërdorim seksual dhe pedofili mbeti i njëjtë. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale miratoi protokoll për parandalimin e rasteve të pedofilisë, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Mund të vërehet përparim i kufizuar në veprimin me personat e cenuar socialë dhe/ose personat me nevoja të veçanta. Ishte ratifikuar Konventa e KB-së për të drejtat e personave me nevoja të veçanta. Vazhdoi hapja e njërive të banimit si pjesë e procesit të deinstitucionalizimit të personave me nevoja të veçanta. Megjithatë, zbatimi i strategjisë së reviduar nacionale për barabarësi të të drejtave të personave me nevoja të veçanta 2010-2018 është shumë i ngadalshëm. Kushtet materiale dhe sjellja johumane dhe degraduese në institucionet psikiatrike nuk është përmirësuar. Integrimi i personave me nevoja të veçanta në shoqëri mbetet i kufizuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e politikës së antidiskriminimit. Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi u bë anëtare-vëzhguese e Rrjetit Evropian për barabarësi ndërmjet trupave. Komisioni nënshkroi memorandum për bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit, Lobit të Grave dhe Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Komisioni dha 34 mendime në vitin 2011, në lidhje me ankesat e parashtruara kryesisht në bazë të statusit etnik, politik dhe shoqëror në sferat e marrëdhënieve të punës, sigurisë sociale dhe gjyqësisë. Komisioni ende nuk ka resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore; kapaciteti i Sekretariatit të saj është veçanërisht i dobët. Vetëdija te popullata për punën dhe parimet e Komisionit sipas Ligjit kundër diskriminim mbetet shumë e ulët. Një pjesë e zvogëluar e rekomandimeve të saj janë të pranuar nga autoritetet publike dhe ekziston brengosje për pavarësinë e tyre. Ligji kundër diskriminimit ende nuk është plotësisht i harmonizuar me acquis-in sepse nuk e ndalon diskriminimin eksplicit në bazë të orientimit seksual në punësim dhe profesion. Sipas Kodit penal dënohen veprat të lidhura me racizëm dhe ksenofobi. Të dhënat për paraqitjen e urrejtjes ose nxitjes në mediet grumbullohen nga Këshilli për Radiodifuzion.

Në lidhje me të drejtat e pronësisë, vendi i regjistruar tash përfshin 99,96% të territorit të vendit. Ishte miratuar Ligji i ri për shpronësim i cili e përfshin gjerësinë e interesit publik si në nivel nacional ashtu edhe në nivel lokal Ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë për shpronësim tashmë janë të rregulluara nga Gjykata Kushtetuese. Sistemi E-Kadastër ishte i zgjeruar në edhe 21 qytete në vend. Sistemi nacional për pozicionim (MAKPOS) u vu në përdorim komercial. Në dispozicion u vu indo-linjë e zyrës për marrëdhënie pronësore juridike, ndërsa edhe mëtej mbahen ditë të hapura për publikun. Vazhdon procesi i kthimit të pronës së konfiskuar në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Megjithatë, 168 ankesa të parashtruara te zyra e Avokatit të Popullit në vitin 2011 për shkeljen e të drejtave të pronësisë janë të lidhura vetëm me procesin e denacionalizimit. Vonimet e vazhdueshme në zbatimin e vendimeve përfundimtare për kthim dhe frenim në zgjidhjen e kontesteve pronësore edhe më tej shkaktojnë vonime në Gjykatën Administrative.

Është arritur përparim i kufizuar në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e bashkësive pakicë dhe të drejtave kulturore. Institucionet të cilat i nxitin të drejtat e bashkësive më të vogla i zmadhuan aktivitetet e tyre, veçanërisht në sferën e arsimit. Qeveria miratoi plan aksionar për përfshirjen e Romëve dhe është arritur përparim i caktuar në lidhje me arsimin e Romëve dhe identifikimin e personave pa dokumente. Megjithatë, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit edhe më tej nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për planifikim strategjik dhe standarde për kontroll të brendshëm. Institucionet përgjegjëse për promovimin e të drejtave të bashkësive më të vogla dhe Romëve edhe më tej nuk janë në mënyrë të mjaftueshme të financuara, që paraqet pengesë serioze për zbatimin e strategjive ekzistuese. Bashkëpunimi ndërinstitucional është i dobët. Tempa të zbatimit të Strategjisë për Romët është e ngadalësuar në sferën e shëndetësisë dhe kulturës. Ekziston brengosje në qëndrueshmërinë e disa projekteve të suksesshme, siç janë Qendrat Informative për Romët. Një sërë e incidenteve të dhunshme i vuri nën presion marrëdhëniet ndëretnike.

Është arritur përparim i mëtejshëm në mbrojtjen e të dhënave personale. U miratuan Strategjia nacionale për mbrojtjen e të dhënave 2012-2016 dhe plani përkatës aksionar. U zmadhua kapaciteti inspektues i Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale (DMDHP) me tre të punësuar të rinj. Mjetet buxhetore mbeten në nivel të njëjtë si dhe në vitin 2011. Bashkëpunimi ndërkombëtar është përmirësues plotësisht. Ishin shpallur Doracakë të ndryshëm në lidhje me kontrolluesit e të dhënave dhe procesorët e publikut të përgjithshëm. Megjithatë, numri i të lëndimeve të vërtetuara u zmadhua prej 176 në vitin 2010 në 319 vitin 2011, dhe medie të caktuara nuk e respektojnë të drejtën e privatësisë së individëve, që sjell deri në lëndime të shpeshta.

Nuk është arritur zhvillim i veçantë në lidhje me të drejtën e qytetarëve të UE-së.

#### *Konkluzion*

Përparim i caktuar është arritur në sferën e gjyqësisë, veçanërisht në zvogëlimin e frenimit të rasteve gjyqësore. Janë të nevojshme përmirësime plotësisht në punësimet gjyqësore në bazë të meritave, baza precize dhe të parashikueshme për zgjedhjen dhe përdorimin e rregullt të mjeteve statistikore. Në sferën e politikës së antikorupsionit, korniza ligjore është në fuqi dhe kapaciteti është pak i përforcuar, por janë të nevojshme përpjekje më të mëdha që të zhvillohet evidenti i hetimeve, aktakuzave dhe aktgjykimeve, sepse nuk është vërejtur përparim në këtë pikëpamje. Në lidhje me të drejtat kryesore, është arritur përparim i caktuar në sferën e lirisë së shprehjes, veçanërisht në dekriminalizimin e ofendimit. Institucionet relevante duhet të bëhen efikase në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore në praktikë. Marrëveshja Kornizë e Ohrit bëhet element i rëndësishëm për demokracinë dhe sundimit të të drejtës në vend. Përgatitjet në sferën e gjyqësisë dhe të drejtat themelore janë mesatarisht të përparuara.

#### **4.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria**

Është arritur përparim i vogël në sferën emigrimit. Vendosja e bazës së të dhënave për të huajt, e cila mbulon azil, migrim dhe viza, përparon ngadalë dhe ende është në fazë të testimit. Në vitin 2011 janë zbuluar mbi 469 migrantë ilegalë. Përqendrimi i lartë i emigrantëve ilegalë ishte paraqitur në kufirin me Serbinë. Kapaciteti strategjik për menaxhim me rrjedhat e migrimit nuk është i mjaftueshëm për ballafaqim me numrin e zmadhuar të emigrantëve që transitojnë në vend. Marrëveshja për readmisim me Serbinë hyri në fuqi, ndërsa tjetër ishte nënshkruar me Malin e Zi. Marrëveshja për readmisim me vendet e UE-së vazhdon të zbatohet me sukses .

Në vitin 2011, 1.022 persona janë të kthyer sipas marrëveshjes për readmisim të UE-

së. Në këtë sferë, vendi mirë përparon.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e azilit. Ligji për ndihmë juridike falas ishte i ndryshuar për shkak të përfshirjes së kërkuesve të azili. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sigurim shëndetësor garanton qasje në sistemin e shëndetësisë publike për persona të cilët kanë marrë azil. U miratua program për integrim për vitin 2012, me të cilin sigurohet financim shtetëror për përkrahje për banim të personave të cilët kanë marrë azil. Qendra për integrim vazhdon ta përsosë kapacitetin e saj që të sigurohen shërbime për persona të cilët kanë marrë azil. Është përmirësuar kapaciteti për praninë në qendrën për azil në Vizbeg. Qasja në informata për procedura për azil dhe të drejta sociale në mënyrë të parëndësishme zmadhohet. Në vitin 2011, janë regjistruar 740 kërkesa për azil, që paraqet zmadhim të përnjëhershëm për 180 për vitin 2010. Në këtë kontekst, kapaciteti i Seksionit për azil në Ministrinë e Punëve të Brendshme mbetet i pamjaftueshëm. Procedura për azil, veçanërisht për vendimet e supozuara të shkallës së parë për azil, është e ngadalshme dhe e pakënaqshme. Sistemi për ankesa në lidhje me përcaktimin e statusit të refugjatëve vazhdoi të përmirësohet, edhe pse vendimet ende jepen në mënyrë procedurale sesa në bazë tërësore. Nuk ka përparim në përshpejtimin e procesit të sigurisë së dokumenteve personale të azilkërkuesve. Interpretimi mbetet pengesë. Korniza ligjdhënëse dhe institucionale plotësisht është e kënaqshme por zbatimi duhet të përmirësohet. Duke pasur parasysh zmadhimin e regjistruar të numrit të kërkuesve të azilit, janë të nevojshme përpjekje plotësuese për planifikim strategjik. Në këtë sferë vendi përparon.

Është arritur përparim në politikën e vizave. Zbatimi i regjimit pa viza me UE-në është përmirësuar. Numri i kërkesave për azil të parashtruar nga shtetas të vendeve të UE-së është zvogëluar nga 7.550 në vitin 2012 në 5.545 në vitin 2011. Megjithatë, politikat afatgjate për përmirësimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të grupeve më të cënueshme të popullatës për të cilat ekziston gjasë të migrojnë mbeten të pazhvilluara dhe pa mjete të mjaftueshme. Trajnimi në vazhdimësi për dokumente të falsifikuara ishte i siguruar për të punësuarit në përfaqësitë diplomatiko-konsullore.. Tashmë ekziston shkallë e lartë e harmonizimit të listës pozitive të UE-së. Duhet të bëhen përpjekje të mëtejme në pikëpamje të harmonizimit me listën negative të UE-së deri në datën e aderimit. Në këtë sferë, vendi përparon mirë .

U arrit përparim i mirë në sferën e kufijve të jashtëm dhe zonës Shengen. U miratua legjislacioni për implementimin e Ligjit për kontroll kufitar. U nënshkrua protokoll për vendosjen e kontakt qendrave të përbashkëta për bashkëpunim policor me Serbinë, Kosovën dhe Shqipërinë. Protokolle për kufijtë e përbashkët u zbatuan nga patrullat e përziera me Bullgarinë, Kosovën dhe Shqipërinë. Vazhdoi bashkëpunimi i mirë me Fronteks-in. Zbatohet Rregullorja për analizë të rrezikut në sferën e krimit të organizuar tejkufitar dhe migrimit të paligjshëm. Programet për trajnim të policëve në terren dhe programi specifik për trajnim të policëve në nivel të lartë dhe të mesëm vazhdojnë të promovohen. Baza qendrore e të dhënave për dokumente të falsifikuara dhe origjinale dhe formulari për dokumente udhëtimi në mënyrë të rregullt azhurnohen. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme për kompletimin e kapacitetit kadrovik të njësisë së brendshme mobile të themeluar në nivel qendror. Kompetencat janë bartur në trup të ndëragjencisë, përkatësisht Qendrës Nacionale Koordinuese për Menaxhim Kufitar e cila e përfshin Këshillin e ri të sapoformuar për menaxhim të integruar kufitar, përgjegjës për përcjelljen dhe implementimin e strategjisë dhe planit aksionar për IGU. Janë të nevojshme përpjekje plotësuese të rëndësishme për përforcimin dhe kapacitetit institucional dhe funksional të këtyre trupave, veçanërisht për planifikim strategjik dhe menaxhim me resurset njerëzore.



Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme për përfundimin e kapacitetit kadrovik të njësisë së brendshme mobile të themeluar në nivel qendror. Vazhdon puna për zgjerimin e sistemit të radio komunikimit TETRA, e cila për momentin mbulon rreth 40% të vendit. Është arritur përparim në pajisjen teknike të policisë kufitare, veçanërisht me pajisje për video mbikëqyrje. Përfundoi rikonstruimi dhe rinovimi i 9 prej 20 stacioneve policore për mbikëqyrje kufitare. Gjithashtu, gjithsej 9 stacione policore ishin të lidhura me bazën qendrore të të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në rrjedhë është lidhja e të tjerave.

Menaxhimi me buxhetin e resurseve të policisë kufitare ishte pjesërisht i decentralizuar. Gjithsej, përgatitjet në sferën e kuufijve të brendshëm dhe zonës shengen kanë përparuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e bashkëpunimit gjyqësor në materien qytetare dhe penale. Emërimi i dy oficerëve për lidhje solli përmirësim plotësues të bashkëpunimit me Eurodrejtësinë (Eurojust). Në periudhën e njoftimit, Ministria e Drejtësisë përpunoi 1 017 kërkesa për materie penale dhe 3 880 kërkesa për materie qytetare. Marrëveshja bilaterale për ekstradim me Malin e Zi hyri në fuqi, dhe ishin ratifikuar marrëveshjet me Serbin dhe Kroacinë. Zbatimi i Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale prej vitit 2011 ishte e prolonguar si rezultati i hyrjes së prolonguar në fuqi të Ligjit të ri për procedurë penale. Në këtë sferë vendi mesatarisht ka përparuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e bashkëpunimit policor dhe luftës ndaj krimin të organizuar. Seksioni ndërkombëtar për koordinim të zbatimit të ligjeve, përgjegjës për këmbimin e informatave policore dhe të kundërzbulimit (ILECU) në kornizat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, fillojë me punë dhe ishte nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet organeve për zbatimin e ligjeve të cilët janë të përfshira. Janë dhënë 107 urdhëresa ndërkombëtare për burgosje në vend në vitin 2011. Ekziston bashkëpunim i mirë rajonal dhe ndërkombëtar për zbatimin e ligjeve nëpërmjet të Europolit dhe Interpolit. Sektori për bashkëpunim policor ndërkombëtar ishte emëruar për Njësi qendrore nacionale për bashkëpunim me nënshkrueset e Konventës për bashkëpunim policor në Evropën Juglindore. Marrëveshja për bashkëpunim operativ dhe strategjik me Europolin hyri në fuqi, por mbetet të emërohet oficer për lidhje me Europolin.

Qendra për trajnim të policëve vazhdoi të sigurojë trajnim të përparuar, të vazhdueshëm dhe të specializuar. Rreth 300 policë kandidatë për kadetë ishin zgjedhur të marrin trajnim bazë në Qendër. Qendra tash ka buxhet të veçantë, por të kufizuar. Është miratuar strategji për trajnim për definimin e qëllimeve dhe grupeve të qëllimit. Megjithatë, resurset njerëzore nuk janë në mënyrë efikase të balancuara ndërmjet organeve të ndryshme për zbatimin e ligjeve. Implementimi i plotë i strukturës së re për Byro për Siguri Publike dhe Sektorët Rajonal për Punët e Brendshme ende është i penguar nga financimi i pamjaftueshëm dhe ekipimi kadrovik. Është bërë vlerësim profesional i të punësuarve në Minsitrinë e Punëve të Brendshme. Profesionalizimi i resurseve njerëzore të policisë dhe politika e rreptë e punësimit e cila është e bazuar jashtëzakonisht në merita janë të nevojshme me qëllim që të zmadhohet kapaciteti operativ dhe efikasiteti i hetimeve. Trajnimi i mëtejme policor dhe formimi i mekanizmit të pavarur dhe stabil për mbikëqyrje të jashtme për shërbimet policore mbetet kryesor për reformat policore.

Implementimi i plotë i Ligjit të ri për procedurë penale (LPP), i cili ishte i miratuar në

vitin 2010 me hyrje të prolonguar në fuqi deri në nëntor të vitit 2012, tash prolongohet deri në dhjetor 2013 për shkak të mungesës nga resurset buxhetore dhe njerëzore dhe pajisjet. Qendrat e hulumtimit dhe policia gjyqësore të parapara me LPP të ri nuk janë themeluar. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme për zbatimin e Planit aksionar për zbatimin e LPP të ri, veçanërisht në sferat e resurseve, organizimit, pajisjes dhe trajnimit për përfaqësues të organeve për zbatimin e ligjit dhe prokurorëve.

Ende nuk ka përparim në lidhje me numrin e të punësuarve në Qendrën për zbardhjen e krimit të organizuar dhe serioz me rreth 62% vende të plotësuara (zvogëlim I vogël nga viti I kaluar). Baza nacionale e të dhënave të zbulimit të krimit ende nuk është operative dhe ende nuk është vendosur Qendër nacionale e koordinimit për luftë kundër krimit të organizuar. Përpjekjet e trupave relevante për zbatimin e ligjit (Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike, Drejtoria Doganore dhe Policia Financiare) për luftë kundër krimit të organizuar duhet të përforcohen. Problemet strukturore janë ende të dukshme në organet për zbatimin e ligjeve në luftën kundër krimit të organizuar.

Ishte ndryshuar ligji për përcjelljen e komunikimeve, me çka u përjashtua përfshirja e drejtpërdrejtë e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë lejimit të përcjelljes dhe me qëllim të kontrollit më të mirë dhe mbikëqyrjes së procesit nga prokurori publik dhe komiteti kuvendor relevant i mbikëqyrjes. Përdorimi i teknikave speciale të hetimit ende duhet të zmadhohet në praktikë, si dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare. Drejtoria Doganore dhe policia financiare ende kanë kapacitet të kufizuar për zbatimin e masave të veçanta të hetimit me çka dukshëm kufizohet efikasiteti I luftës kundër krimit të organizuar.

Në vitin 2011 programi për mbrojtjen e dëshmitarëve është aktivizuar në dy raste. Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve morri dy lokale plotësuere, por ende nuk ka pajisje përkatëse. Zbatimi i dispozitave ligjore për sigurimin e kompensimit i cili duhet të paguhet për viktimat e krimit të organizuar duhet të përmirësohet në praktikë.

Në vitin 2011, Njësia për zbulim financiar (FIU) paraqiti 22 raste të transaksioneve të dyshimta të lidhura me larjen e parave dhe 107 të cilat kanë të bëjnë me lloje tjera të krimit ekonomik dhe financiar, te organet hetuese dhe prokuroria. Shumica e rasteve të përpunuara kanë të bëjnë me fshehjen e tatimit. Gjatë vitit 2011, gjithsej 43 persona ishin të gjykuar në katër raste. Gjashtë persona ishin të gjykuar në dy raste. Niveli I paraqitjes dhe hetimit të larjes së parave dhe krimit financiar mbetet I dobët. Urgjentisht është e nevojshme qëndrim më aktiv.

Përparim mesatar ishte I arritur në zgjedhjen e tregtis me njerz. Njëmbëdhjetë viktima të tregtisë me njerz ishin identifikuar në vitin 2011, që është zvogëluar për 12 në vitin paraprak. Gjatë vitit rrjedhës, në Qendrën për viktima të tregtisë me njerz janë vendosur tetë viktima. Janë të nevojshme përpjekje që të sigurohet aftësi e qëndrueshme e Qendrës të sigurojë mbrojtje të plotë. Në vitin 2011, 35 persona ishin të akuzuar me dyshim për tregti të paligjshme me njerz në krahasim me 25 në vitin 2010, ndërsa 7 persona janë të gjykuar, zvogëlim prej 11 në vitin 2010. Ende duhet të zhvillohet qasje gjithëpërfshirëse, multi-disiplinore dhe qasje e orientuar ndaj viktimave, në pikëpamje të tregtisë me njerz, dhe duhet të përmirësohet identifikimi më aktiv I viktimave me njerz. Vendi mbetet burim, destinacion dhe vend transit për tregti me njerz dhe punë të detyruar.

Vendi është përparuar në sferën e bashkëpunimit policor dhe luftës ndaj krimit të

organizuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e luftës kundër terrorizimit. Vendi u bë anëtar i iniciativës për luftë kundër terrorizimit të Botës në Evropë. Bashkëpunimi bilateral dhe multilateralë vazhdon. Është miratuar strategji nacionale për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizimit për vitin 2012-2014. Këshilli për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizimit është themeluar si trup ndërresorjal për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Ishte nënshkruar Memorandum për bashkëpunim ndërmjet FIU dhe Agjencisë për Zbulim. Në vitin 2011, FIU parashtrori tre njoftime për transaksione të dyshimta në lidhje me financimin e terrorizimit, te agjencia për zbatimin e Ligjit për prokurori. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar mirë.

Mund të vërehet përparim i vogël në lidhje me bashkëpunimin në sferën e drogave. Pika lokale nacionale bashkëpunonte mirë me Monitoring-qendrën Evropiane për droga dhe varësi nga droga (EMCDDA) në projekte të përbashkëta. Në vitin 2011, sasia e drogës e konfiskuar në territorin e vendit mbeti e vogël, duke e vazhduar trendin e zvogëlimit nga viti i kaluar. Vendi mbetet në rrugën kryesore ballkanike për tregti me drogë, edhe krahas disa operacioneve të suksesshme ndërkombëtare policore për ndërprerjen e kanaleve ndërkombëtare për kontrabandë të lëndëve narkotike. Drejtoria Doganore duhet të japë më shumë përpjekje në gjetjen dhe konfiskimin e lëndëve narkotike në kufij. Duhet të përforcohen kapacitetet kadrovike të Seksionit për tregti të palejuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Vendi në pjesë më të madhe i plotëson kushtet e *acquis-it*.

Është vërejtur përparim i mirë në sferën e bashkëpunimit doganor. Drejtoria Doganore morri pjesë në tetë operacione ndërkombëtare për zbardhjen e tregtisë së palejuar e paraparë nga zyrat rajonale të kundërzbulimit për lidhje të Organizatës Botërore të Doganimit (OBD), të Qendrës për zbatimin e ligjeve të Evropës Juglindore (SELEC) dhe të pushteteve gjermane. Gjithashtu, vazhdon dhe intensifikohet bashkëpunimi dhe këmbimi i inteligjencës me organet doganore të vendeve fqinje. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë. *(Shikoni gjithashtu Kapitulli 29 – Unioni doganor).*

Për luftë kundër falsifikimit të euros, shikoni kapitullin 32 – Kontrolli financiar.

### *Konkluzion*

Është arritur përparim në sferën e drejtësisë, lirisë së sigurisë, veçanërisht në kufijtë e jashtëm dhe bashkëpunimit doganor, si dhe për përcjelljen e komunikimeve. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme për përmirësimin e efikasitetit të procedurës për azil, sigurimin e punësimit në polici i cila bazohet jashtëzakonisht në merita, përforcimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe përmirësimi i konfiskimit të drogës. Urgjentisht është i nevojshëm qëndrim më aktiv i organeve për zbatimin e ligjit. Në tërësi përgatitjet në këtë sferë janë të përparuar..

### **4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe hulumtimi**

Mund të vërehet përparim i vogël në politikën e hulumtimit dhe inovacioneve. Përgatitjet e Programit nacional për hulumtim dhe zhvillim për vitin 2012-2016 dhe

Strategjia për inovacione janë përparimtare, por mbetet të miratohen. Programet për veprimtari shkencore-hulumtuese, teknologjike dhe kulturë teknike për vitin 2012 u miratuan. Buxhetet për këto programe megjithatë vazhdojnë të zvogëlohen nga viti 2010. Mjetet financiare janë ende të kufizuara dhe kapacitetet e institucioneve të hulumtimit mbetet të dobëta. Janë të nevojshme përpjekje më të mëdha, veçanërisht në nivel të inovacioneve dhe përfundimit të kapaciteteve në nivel nacional nëpërmjet të zmadhimit të numrit të shkencëtarëve dhe modernizimit të infrastrukturës. Përgatitjet në këtë sferë mesatarisht kanë përparuar.

Është bërë përparim i mëtejshëm në pjesëmarrjen në Programin e shtatë kornizë (PK7). Shkalla e pjesëmarrjes në PK7 vazhdon të zmadhohet por mbetet e pabarabartë. U përmirësua kapaciteti administrativ për organizimin e aktiviteteve promovuese, punëtorive dhe konferencave për mundësitë për bashkëpunim në kornizat e PK7. Përpjekje të veçanta janë bërë për përfshirjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në lidhje me aksionet Mari Kiri. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme, veçanërisht për përgatitjen për programin e ardhshëm kornizë "HORIZONT 2020" i cili përfshin periudhën 2014-2020. Bashkëpunimi me Qendrën e përbashkët të hulumtimeve rezultonte me lidhjen e Memorandumit për bashkëpunim (MB) me qëllim zmadhimin e këmbimit të shkencëtarëve dhe përgatitjes për harmonizim me standardet e UE-së dhe kërkesat teknike. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar mirë.

Në lidhje me Sferën Evropiane të Hulumtimit (SEH) janë ndërmarrë hapa që të lehtësohet integrimi në SEH dhe kontribut në Unionin e Inovimeve. Blerja e pajisjeve për laboratorit shkencore për universitetet publike dhe institute hulumtuese mundësoi avancimin e disa instituteve nacionale. Në lidhje me mobilitetin e hulumtimit, përgatitjet për EURAKSES rjetin nacional dhe për vendosjen e infrastrukturës së rjetit kanë përparuar mirë. Megjithatë, shkalla e inovacioneve në hulumtim është zvogëluar në vitin 2012. Mungesa e të dhënave të sakta statistikore e vështirëson përcjelljen e investimeve dhe rezultateve. Përgatitjet për politikën e UE-së për hulumtim dhe inovacione kanë përparuar mesatarisht.

#### *Konkluzion*

Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e shkencës dhe hulumtimit. Përgatitjet e Programit nacional për hulumtim dhe zhvillim për vitin 2012-2016 dhe për Strategjinë për inovacione janë përparimtare, por mbetet të miratohen dokumentet. Pjesëmarrja në PK7 vazhdon mirë. Kapaciteti administrativ për përkrahje në pjesëmarrje në programet kornizë është përmirësuar, por mbetet i dobët. Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e integriteteve të ardhshme në Sferën Evropiane të Hulumtimit. Në tërësi, në sferën e shkencës dhe hulumtimeve vendi pjesërisht i plotëson qëllimet e saj.

#### **4.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura**

U arrit përparim i caktuar në sferën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve. Parlamenti miratoi ndryshime të Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm. Janë shpallur rangimet e universiteteve për të gjitha 19 institucionet duke përfshirë aspekte siç janë arsimi, hulumtimi dhe shërbimet sociale. Filloi cikli i tretë i studimeve (të doktoraturës) si pjesë e zbatimit të Procesit të Bolonjës në arsimin e lartë. U krijuan strategji për përfshirjen e arsimit sipërmarrës dhe ekologjik dhe për trajnim të nxënësve të talentuar në arsimin fillor. U vendos sistem i licencimit të aktiviteteve për arsim të të

rinjve. Skemat për arsim për të rritur të cilat sigurojnë studime universitare dhe trajnim janë në rrjedhë.

Vendi i përmirësoi realizimet e tij në lidhje me arsimin e mesëm dhe në sferat ku në nivel të UE-së janë vendosur parashenja për vitin 2020, veçanërisht në lidhje me lënien e hershme të arsimit dhe arsimit të lartë.

Megjithatë, marrë përgjithësisht vendi mbetet nën mesataren e UE-së në arsim, veçanërisht në arsimin parashkollor. Nuk ishin përcaktuar qëllime nacionale për realizimin e arsimit në pajtim me Kornizën për arsim dhe trajnim 2020 me të cilat do të adresoheshin sferat prioritare në secilin nga nivelet e ndryshme të arsimit dhe trajnimit. Janë kufizuar mundësitë për mësim në largësi, mësim modular dhe mësim inordinar. Masat për kursim ndikuan në shpenzimet e përgjithshme për arsim. Dallimet rajonale mbeten. Disa fëmijë në vendet rurale nuk marrin arsim fillor dhe shkalla e lënies së hershme të arsimit mbetet e lartë, veçanërisht ndërmjet Romëve. Është e nevojshme të përmirësohet trajnimi për mësues. Është i domosdoshëm arsimit i lartë, sepse nuk i reflekton nevojat e tregut të punës. Korniza nacionale për kualifikime nuk është zhvilluar. Kapacitete e përgjithshme të Qendrës për Arsim Profesional dhe të Qendrës për Arsim të të Rriturve mbetet e pamjaftueshme.

Kishte përparim të mirë në lidhje me përfshirjen e vendit në programet për Mësim të përjetshëm dhe Të rinj në aksion. Përparimi i bërë në plotësimin e kushteve të vendosura nga UE-ja solli ndërprerjen e suspenzionit të masave përgatitëse në kornizat e këtyre programeve. Ishin përforcuar sistemi i kontrollit sekondar të punës dhe menaxhimi i përditshëm i Agjencisë Nacionale për Programe Evropiane të Arsimit dhe Mobilitet. Organet nacionale ndërmorën masa për mënjanimin e parregullsisë të zbuluara dhe sigurimin e garancisë së Agjencia Nacionale punon drejtë. Vendi, gjithashtu, u bë pjesë e aksionit të centralizuar të Programit për mësim të përjetshëm.

Në tërësi, përgatitjet në sferën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve janë në fazë të hershme.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e kulturës. Vendi e intensifikonte pjesëmarrjen e tij në programet Kulturë dhe Evropë të qytetarëve. Pjesët e reja dhe institucionet u deklaruan si pjesë e trashëgimisë kulturore. Programet kulturore-infrastrukturore të financuara nga Qeveria nuk arritën ta reflektojnë përbërjen multietnike të vendit dhe mjetet për aktivitete kulturore të bashkësive joshumicë mbeten të pamjaftueshme. Përgatitjet në sferën e kulturës janë në rrugë të mirë.

#### *Konkluzion*

U arrit përparim i caktuar në sferën e arsimit, trajnimit, të rinjve dhe kulturës. Vendi i përmirësoi realizimet e veta në lidhje me qëllimet e përbashkëta për arsim dhe trajnim 2020. U mënjana suspenzioni i masave përgatitëse për programet për mësim të përjetshëm dhe të rinj në aksion. Investimet vazhdojnë, edhe pse duhet të zbatohen në mënyrë më përkatëse që të reflektohet më mirë shoqëria ndërkulturore. Në sferën e arsimit dhe kulturës vendi ka përparuar mesatarisht.

#### **4.27. Kapitulli 27: Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike**

Në sferën e mjedisit jetësor ishte arritur përparim i mëtejshëm në legjisllacioni horizontal. U miratua legjisllacioni për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor (VSNMJ) dhe për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor (VNMJ). U përmirësua kapaciteti administrativ për zbatimin e Direktivave për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor (VSNMJ) dhe për vlerësim strategjik të ndikimit mbi

mjedisin jetësor (VNMJ), megjithatë edhe më tej ka mangësi, veçanërisht në nivel lokal. Kërkesat për qasje në informata dhe konsultime publike të lidhura me VNMJ dhe VSNMJ ende nuk zbatohen në mënyrë përkatëse. Ende nuk ka filluar zbatimi i legjislacionit për përgjegjësi ndaj mjedisit jetësor. Është e nevojshme të përshpejtohen përgatitjet për harmonizim me Direktivat INSPIRE dhe me Direktivat për krim ekologjik. Përgatitjet në këtë sferë janë përparimtare.

Në sferën e kualitetit të ajrit është vërejtur përparim i caktuar. Vazhdoi harmonizimi me acquis-in, me miratimin e legjislacionit për zbatim. Është arritur përparim i mirë në zhvillimin e sistemit për monitorim të kualitetit të ajrit, megjithatë i njëjti ishte i pabarabartë për shkak të mjeteve të pamjaftueshme financiare për funksionimin e tij. Kjo e vështirëson zbatimin e legjislacionit në këtë sferë. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e menaxhimit me hedhurina. U miratua Ligji për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike dhe pajisje të hedhurinave elektrike dhe elektronike. U miratuan ligje për zbatim dhe u arrit përparim i mëtejshëm në vendosjen e sistemit të integruar për menaxhim me hedhurina. U përmirësua kapaciteti administrativ. Investimet në këtë sferë janë më shumë se të mjaftueshme dhe duhet të zmadhohen. Ishte vendosur pilot sistem për grumbullimin e të dhënave, regjistrim dhe njoftim. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

Përparim i vogël mund të vërehet në sferën e kualitetit të ujit. Harmonizimi me acquis-in ende ngec. Strategjia nacionale për ujëra ende nuk është miratuar. U vendosën struktura për menaxhim me rrjedha të lumenjve, por ato ende nuk janë plotësisht funksionale. Kapaciteti administrativ ende nuk është i mjaftueshëm, si në nivel qendror ashtu në nivel lokal. Koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet organeve kompetente në sektorin për ujëra edhe mëtej e vështirëson zbatimin e legjislacionit. Nuk është arritur përparim në zbatimin me mangësitë e sistemit për monitorim të ujërave. Planifikimi dhe përgatitja e investimeve infrastrukturore ngec dhe financimi është i ulët në lidhje me nevojat në sektor. Nuk ka përparim në zbatimin e parimit “ndotësi paguan” dhe në vendosjen e sistemit përkatës për përcaktimin e çmimit të ujit. Kjo edhe më tej e vështirëson funksionimin e stacioneve për pastrim. Përgatitjet në këtë sferë ngecin.

Është arritur përparim i vogël në sferën e mbrojtjes së natyrës. Vazhdoi harmonizimi me acquis-in, me miratimin e legjislacionit për zbatim të Ligjit për mbrojtjen e natyrës. Mund të vërehet përparim i caktuar në lidhje me zhvillimin e planeve për menaxhim me rajonet e mbrojtura, megjithatë ende nuk zbatohen kurdoherë në mënyrë përkatëse kërkesat për konsultim publik me palët të prekura. Zbatimi i këtyre planeve ende nuk është përkatës për shkak të financimit të qëndrueshëm dhe monitorimit të pamjaftueshëm. Ende nuk ka filluar zhvillimi i strategjisë së re nacionale dhe planit aksionar për mbrojtjen e natyrës. Përgatitjet në këtë sferë mesatarisht kanë përparuar. Është vërejtur përparim i vogël në aspektin e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit me rreziqe. Transponimi dhe zbatimi i Direktivës Seveso II përparon. Procesi vonohet për dhënien e KIPN (lejet për kontrollin e integruar dhe parandalimin e ndotjes). Është e nevojshme të forcohen në mënyrë të konsiderueshme kapacitetet administrative, veçanërisht për aktivitetet për lëshimin e lejeve, kontrollin dhe kryerjen e inspektimit. Përgatitjet në këtë sferë kërkojnë përpjekje të konsiderueshme plotësuese.

Ka pasur përparim të mirë në fushën e hemikaleve. Ishte i miratuar raportin për gjendjen e hemikaleve dhe planit nacional për qasje strategjike për menaxhimin me hemikalet. Mund të vërehet përparim në zbatimin e Rregullativës REOOH (REACH) (regjistrimi, evalvimi, miratimi dhe kufizimi i hemikaleve). Ishte i përmirësuar

Kapaciteti administrativ . Përgatitjet në këtë fushë janë mesatarisht të përparuar .

Është arritur përparim i vogël në fushën e zhurmës. Kapaciteti administrativ është i pamjaftueshëm dhe në drejtim të personelit dhe në drejtim të pajisjeve. Në këtë sferë, përgatitjet janë në fazë të hershme.

Është arritur përparim i mirë në mbrojtjen civile në formën e anëtarësimit të mekanizmave për mbrojtje civile të UE-së dhe pjesëmarrjen në projektin IPA për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes civile.

Është arritur përparim i vogël në fushën e ndryshimeve klimatike. Ende është e nevojshme të zhvillohet strategjia gjithëpërfshirëse për klimën. Aspektet klimatike gjithnjë e mëshomë janë duke u integruar në politikën energjetike, por megjithatë përpjekjet e konsiderueshme janë të nevojshme për integrimin e plotë të ndryshimeve klimatike në politikat e tjera sektoriale dhe strategjike. Shteti rregullisht i mbështet pikëpamjet e UE-së në planin ndërkombëtar. Edhe pse më parë e përkrahte Marrëveshjen e Kopenhagës, shteti ende nuk e ka marrë përgjegjësinë për zvogëlimin e emisioneve të ajrit deri në vitin 2020. Shteti duhet të mendojë të ndërmarrë angazhime për zvogëlimin e emisioneve në ajër në përputhje me ato të UE-së dhe shteteve - anëtare të saj me qëllim që, deri në vitin 2015 të arrijë marrëveshje për klima që do të fillojë të zbatohet në vitin 2020.

Shteti i ka bërë hapa fillestare për identifikimin e instalimeve stacionare me qëllim të zbatimit të ardhshëm të sistemit të tregtimit të emisioneve. Plani Nacional për eliminimin e hidrohlorofluorokarbonateve (HCFCs) u miratua në nëntor 2011. Përpjekjet e konsiderueshme janë të nevojshme për forcimin e kapaciteteve të shtetit për përcjellje, njoftim dhe verifikim.

Shteti rregullisht është pjesëmarrës në grupin e punës për klimën në suazat e Rrjetit rajonal të mjedisit jetësor për anëtarësim në UE (RENA) dhe me Rrjetin rajonal për mjedisin jetësor për anëtarësimin në UE. U ngritën iniciativa për rritjen e vetëdijes dhe përparimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara, megjithatë, është e nevojshme që të intensifikohen përpjekjet. Në këtë sferë, përgatitjet janë në fazë të hershme.

Kapaciteti administrativ për zbatimin dhe forcimin e legjislacionit nga sfera e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike edhe më tej janë masë më të madhe dhe të pamjaftueshme si në nivel nacional dhe në nivelin lokal. Ende nuk ka koordinim efektiv midis trupave administrative përgjegjëse për çështjet të lidhura me mjedisin jetësor. Kërkesat në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike ende nuk janë integruar mirë në hartimin dhe zbatimin e politikave. Përfshirja e palëve të interesuara në vendimmarrje është përmirësuar, por ende është e pamjaftueshme. Është e nevojshme në mënyrë plotësuese të zhvillohet sistemi i përcjelljes dhe informimit në drejtim të mjedisit jetësor. Investimet në këtë sektor mbeten edhe më tej në nivelin më të ulët.

### *Konkluzion*

Në përgjithësi, ka pasur përparim të kufizuar në sferën e mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike. Është arritur përparim i mëtëjshëm në transponimin e acquis-it në legjislacionin nacional, veçanërisht në sferën e menaxhimit të hedhurinave, kualitetit të ajrit dhe hemikaleve. Është arritur përparim i vogël në pamjen e harmonizimit me asquis me ndryshimet klimatike. Janë të domosdoshme angazhimet e konsiderueshme për zbatimin e legjislacionit nacional, veçanërisht me menaxhimin me ujërat, kontrollin mbi ndotjen industriale, mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike. Janë të domosdoshme angazhimet e konsiderueshme për

rritjen e vetëdijes, krijimin e qasjes strategjike të shtetit, për harmonizim me acquis-in për klimën UE-së dhe zbatimin e njëjtë, si dhe për forcimin e kapaciteteve administrative. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet administrative si në nivel qendror ashtu dhe nivel lokal. Është e nevojshme të rriten investimet, sidomos në sektorët për hedhurina dhe ujëra. Në përgjithësi, përgatitjet në sferën e mjedisit jetësor janë në përparim të përmirësueshëm, ndërsa në sferën e ndryshimeve klimatike mbeten në fazë të hershme.

#### **4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore**

Janë arritur disa përparime në sferën e mbrojtjes të konsumatorëve. Në drejtim të aspekteve horizontale, korniza rregullore dhe evidentimi për zbatim janë përmirësuar. Organizata e konsumatorëve vazhdon të organizojnë ngjarje për rritjen e vetëdijes, fushat për përmirësimin e edukimit dhe këshillim e konsumatorëve, duke përfshirë edhe zonat rurale. Organizohen ngjarje për ngritjen e kapaciteteve për profesionistë të inspektorateve të tregut, organizatave të konsumatorëve dhe ministrive . Megjithatë, mbështetja financiare që u është ndarë konsumatorëve ende është e pamjaftueshme. Kapaciteti administrativ i Sektorit për mbrojtje të konsumatorëve në Ministrinë e Ekonomisë duhet të rritet.

Janë arritur disa përparime në lidhje me çështjet e lidhura me sigurinë e prodhimeve. Janë bërë ndryshime në Rregulloren për sigurinë e lodrave për fëmijë. Evidentimi për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit është përmirësuar në mënyrë plotësuese. Inspektorët e tregut gjithnjë e më tej merren me ankesat nga konsumatorët dhe me të e zvogëlojnë punën e organizatave të konsumatorëve. Përkundër disa përmirësimeve, mbikëqyrja e tregut nuk ka dhënë ende plotësisht mbrojtje efektive dhe mbrojtje transparente të konsumatorëve. Kapaciteti administrativ i trupit koordinues duhet të rritet ndjeshëm.

Ka disa përparime në aspektin e çështjeve të pasigurisë. Ligji i ri për mbrojtje të konsumatorëve për marrëveshje të kredisë hyri në fuqi dhe është miratuar rregullativa e nevojshme për implementim në mënyrë që të jenë në harmonizim me acquis-in. Ligji parashikon më shumë informata dhe mbrojtje efikase ligjore për konsumatorët gjatë lidhjes së marrëveshjeve për kredi. Përgatitjet në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve janë shumë të avancuara.

Është arritur përparim i caktuar në fushën e shëndetit publik. Në drejtim të aspekteve horizontale, është miratuar ligj i ri për mbrojtje shëndetësore që i rregullon profesionin mjekësor dhe sistemin e akreditimit për institucionet e kujdesit shëndetësor. Ligji e riorganizon rrjetin e kapaciteteve shëndetësore në baza gjeografike. Zbatohet sistem i integruar i teknologjisë informtike shëndetësore, i cili përfshin dhe ofrimin e pajisjeve. Vazhdojnë përgatitjet për vendosjen e sistemit të kartelave shëndetësore elektronike. Buxheti i përgjithshëm ndahet për programet shëndetësore që është i dyfishuar në krahasim me vitin 2011. Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës Evropiane për parandalimin dhe kontrollin e Sëmundjeve (ECSKB), Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe Fondit Global (GF) është ende e mirë. Përgatitjet në këtë fushë janë në rrugën e duhur.

Është arritur pjesë e përparimit në fushën e kontrollit të duhanit. Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen nga pirja duhanit mbetet i kënaqshëm dhe është rritur me vendosjen e sanksioneve më të rënda në rast të shkeljeve të shumta të ligjit. Inspektorati të Punës dhe i Tregut dhe Inspektorati Sanitar dhe Inspektorati Shtetëror kryejë



kontroll të përbashkët në terren. Sigurohen shërbime këshilluese për ndërprerjen e duhanit.

Është arritur përparim i kufizuar në luftën kundër sëmundjeve ngjitëse. Të punësuarit në shëndetësi dhe inspektorët morën pjesë në trajnimin për zbatimin dhe monitorimin e imunizimit dhe çështje të tjera që lidhen me kontrollin e sëmundjeve ngjitëse. Është miratuar Strategji Nacionale për kontrollin e rezistencës bakteriale 2012-2016 dhe janë kryer aktivitete për ngritjen e vetëdijes për përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve. Nuk është miratuar Strategjia për luftë kundër HIV / AIDS 2012-2016 dhe Strategjinë Nacionale të imunizimit 2011-2020. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

Është arritur përparim i vogël në fushën e gjakut. Kapaciteti i sistemit nacional i integruar për transfuzionin e gjakut duhet edhe më tej të forcohet. Ndihma në pajtim me IPA 2009 është paraparë për këtë qëllim. Në fushën e indeve, qelizave dhe organeve po zhvillohet sistem i integruar për transplantime. Trajnimet për punëtorët në shëndetësi që kanë të bëjnë me këtë fushë janë kryer nëpërmjet TAEX-it. Është e nevojshme të miratohet legjislacioni sekondar në fushën e gjakut në mënyrë të plotë të kornizës ligjore në këtë fushë. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

Është vërejtur përparim i kufizuar në fushën e shëndetit mendor. Është miratuar Programi vjetor për mbrojtje shëndetësore për njerëzit me sëmundje mendore. Janë rinovuar disa objekte të shëndetit mendor. Megjithatë, objektet nuk kanë staf të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme financiare. Programi i buxheti vjetor është i pamjaftueshëm. Ka përparim në zbatimin e Planit Aksionar të shëndetit mendor që synon të sigurojë kujdesin e shëndetit mendor në komunitet si alternativë ndaj institucioneve. Qëndrueshmëria e qendrave komunale ekzistuese të shëndetit mendor është një problem serioz. Në këtë sferë, përgatitjet janë në fazë të hershme.

Është vërejtur përparim në fushën e parandalimit të përdorimit të drogës. Ka filluar vlerësimi i strategjisë nacionale për drogat e paligjshme deri në vitin 2012. Është aritur përparim i caktuar në ndërtimin e kapaciteteve për zgjidhje të problemit të varësisë nga alkooli dhe drogat e paligjshme, për të siguruar rehabilitimin dhe mbështetjen për familjet dhe për të zhvilluar shërimi me substitute.

Është vërejtur përparim i vogël në trajtimin e pabarazive shëndetësore. Në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2005-2015, gjashtëmbëdhjetë ndërmjetësues shëndetësorë të kombësisë rome filloi duke i dhënë këshilla shëndetësore të anëtarëve të bashkësisë rome.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e zvogëlimit të dëmit të shkaktuar nga alkooli, me çrast përfshirja e moshës minimale prej 18 vjetësh për të blerë alkool dhe ndalimi për shitjen e alkoolit në mbrëmjet e vona solli zvogëlimin e rasteve të helmimit me alkool të të gjitha grupet e rritura.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e kontrollit të kancerit. Qeveria promovoi program vjetor për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje, duke përfshirë edhe kancerin dhe ekzaminimet e rregullta. Megjithatë, Regjistri për kancer është vetëm pjesërisht funksional. Aktivitetet për rritje të vetëdijes për kancerin nuk marrin mjete të mjaftueshme.

Është miratuar Program vjetor Nacional për trajtimin e sëmundjeve të rralla dhe është rritur buxheti i tij. Megjithatë, buxheti ende nuk është i mjaftueshëm për të siguruar

zbatimin e plotë. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

#### *Konkluzion*

Janë arritur disa përparime në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbrojtjes shëndetësore. Përparimi plotësues në këtë fushë ka qenë i paaftë për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe strukturave të dobëta operationale, në veçanti në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Në përgjithësi, përgatitjet në këtë fushë janë mesatarisht të përparuara .

#### **4.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor**

Është arritur përparim i caktuar në legjislacionin doganor. Tarifa doganore e vitit 2012 u miratua në përputhje me ndryshimet e fundit të Nomenklaturës së Kombinuar të UE-së. U përfshinë dispozita të reja për zbatimin e menaxhimit me rrezikun, duke përfshirë edhe menaxhimin elektronik me rrezikun dhe shkëmbimin e informatave, përdorimi i deklaratave doganore të shkurtuara, analiza e rrezikut, procedura për lëshimin dhe revokimin e lejeve për procedurë doganore më të thjeshtëzuar dhe shkëmbimin e informatave midis organeve doganore me përdorimin e IT dhe rrjeteve kompjuterike. Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme.

Është vërejtur përparim i mirë në kapacitetet administrative dhe operationale. Bashkëpunimi me shoqatat e biznesit rritet dhe ndërsa vazhdon dhe shkëmbimi i informatave me drejtoritë doganore të vendeve fqinje. Standardet profesionale dhe masat e kontrollit ndërkombëtarë janë kryer sistematikisht në mënyrë për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mesin e zyrtarëve të doganave. Kapaciteti operacional i kontrollit doganor është forcuar më tej. Është bërë përparim i mëtejshëm në zhvillimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut për vendkalimet kufitare në formën e aplikimit më të gjerë e analizës së rrezikut. Megjithatë, është e nevojshme të sigurohen burime të qëndrueshme financiare për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të kontrollit doganor. Janë miratuar strategji për zhvillimin e teknologjisë informatike dhe komunikative (TIK) dhe strategjia për marrëdhëniet me publikun për 2012-2014. Plani Nacional për zbatimin e sistemit të ri tranzit të kompjuterizuar (NKST) rregullisht azhurnohet. Është krijuar aplikimi ri për transit ,plotësisht në përputhje me NKST dhe ka hyrë në fuqi dhe kapacitet për zbatim. Sistemi njësportelor për lëshimin e miratimit përmirësohet në mënyrë plotësuese. administrata doganore filloi me përpunimin e sistemit të ri për përpunimin e deklaratave doganore. Të punësuarit duhet të përmirësojnë më tej menaxhimin e projekteve dhe kapacitetin për garanci të kualitetit në mënyrë që të minimizojnë rreziqet që lidhen me zbatimin paralel të një numri të caktuar të IT projekteve për zhvillim dhe në përgjithësi ta përmirësojnë punën e projekteve. Përgatitjet në këtë sferë janë në rrjedhë.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim i konsiderueshëm në Unionin Doganor, në veçanti sa i përket kapaciteteve administrative dhe operationale. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive, lufta kundër korrupsionit në drejtorinë doganore dhe kapaciteti për të parandaluar krimin tejkuftar vazhdoi të përmirësohet. Përgatitjet në fushën e unionit doganor kryesisht janë në rrugën e duhur.

#### **4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme**

Është arritur përparim i konsiderueshëm në fushën e politikës së përbashkët

tregtare. Republika e Maqedonisë vazhdon gradualisht t'i zvogëlojë tarifat doganore në vitin 2012, në përputhje me detyrimet e OBT-së. Vendi, gjithashtu, ka ratifikuar Konventën Rajonale mbi Rregullat pan-evro-mesdhetare preferenciale të origjinës, të cilat do të lejojnë që ajo të marrë pjesë në sistemin e grumbullimit diagonal të origjinës. Vendi merr pjesë në punën e trupave të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe të vazhdojë të koordinojë ngushtë me Komisionin Evropian dhe të harmonizohet lidhur me politikën dhe pozicionet e UE-së në negociatat e tregtisë ndërkombëtare. Lista e re e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë është miratuar dhe zbatuar, me çka zëvendësohet ajo e mëparshme e vitit 2008. Me këtë transpozohet lista e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe teknologji të përfshira në Rregulloren përkatëse të Këshillit. Përgatitjet në fushën e politikës së përbashkët tregtare shënojnë përparim mesatar.

Në pikëpamje të marrëveshjeve bilaterale me vendet e treta, vendi ka ratifikuar marrëveshjet për mbrojtjen e investimeve me Lituaninë dhe Katarin. Numri i marrëveshjeve të ratifikuara dypalëshe për investime ishte rritur në 37, nga të cilat 32 janë në fuqi dhe 17 me shtetet anëtare të UE-së.

Është vërejtur përparim i konsiderueshëm në fushën e politikave të zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Ministria e Punëve të Jashtme ka koordinuar ndihmën humanitare në Turqi në prag të tërmetit në Van në vitin 2011. Shteti u bë anëtar i Mekanizmit për Mbrojtjen Civile të Unionit Evropian, i cili mundëson pjesëmarrjen në sistemin evropian për përbashkët me katastrofa. Përgatitjet në të dy sferat, janë në fazë të hershme.

#### *Konkluzion*

Është arritur përparim i konsiderueshëm në fushën e marrëdhënieve të jashtme, në veçanti në pikëpamje të politikës së përbashkët tregtare. Megjithatë, kapaciteti institucional i vendit ende nuk është i mjaftueshëm për pjesëmarrjen e tij të plotë në politikën tregtare, zhvillimore dhe humanitare të UE-së. Përgatitjet në fushën e marrëdhënieve me jashtme janë pjesërisht të avancuara .

### **4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes**

**Dialogu politik** i rregullt ndërmjet UE-së dhe Republikës së Maqedonisë mbulon çështje nga politika e jashtme në bazë të vazhdueshme. *(Në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet tjera të zgjerimit dhe me shtetet-anëtare, shih pjesa për Kriteret Politike, 2.3 – Çështje rajonale dhe obligime ndërkombëtare)*

Sa i përket **politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (PPJS)**, gjatë periudhës së njoftimit vendi u mbështet, kur ishte ftuar, në të gjitha deklaratat e UE-së dhe Vendimet e Këshillit. *(Në lidhjet me Gjykatën Ndërkombëtare Penale, shih pjesa Kriteret politike 2.3 – Çështje rajonale dhe obligime ndërkombëtare)*

Në lidhje me sanksionet dhe *masat restriktive*, shteti u bashkëngjiti drejt masave restriktive të cilat ishin vendosur me vendimet e Këshillit. Zbatimi i masave restriktive vazhdoi edhe gjatë periudhës së njoftimit. Trupi koordinues për përcjellje të zbatimit të masave ndërkombëtare restriktive, që para do kohe ishte themeluar me ligjin përkatës, rregullisht është takuar. Është themeluar Regjistër i masave restriktive ndërkombëtare dhe ruhet në suazat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, me nën-regjistra të institucioneve kompetente.

Nuk është shënuar zhvillim i veçantë në lidhje me parandalimin e konflikteve.

Në lidhje me jo proliferimin e armës, shteti ka filluar të merr pjesë në Vasenar aranzhmanin në aktivitete të terrenit në shtetet të cilat nuk janë anëtare. Ministria e Punëve të Brendshme ka çrënjësuar të gjitha rezervat e armëve dhe arma e konfiskuar është asgjësuar.

Shteti vazhdoi në mënyrë aktive të përfshihet në bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare (KB, OSBE, Këshilli i Evropës, etj.).

Në lidhje me masat e sigurisë (informata të klasifikuara), projekt-tekstet e marrëveshjeve bilaterale me Italinë dhe Serbinë për këmbim dhe mbrojtje të informatave të besueshme janë kontraktuar. Marrëveshja me Gjermaninë është nënshkruar.

Në suazat e politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes (PPSM), shteti e mirëmban dedikimin rrjedhës për pjesëmarrje në operacionet civile dhe ushtarake për menaxhim me kriza. Për momentin shteti ka gjithsej 171 persona që janë sistematizuar në misionin ISAF në Afganistan, duke përfshirë tetë oficerë në shkollën nacionale të armatës së Afganistanit për trajnim ushtarako-policor në Kabul. Shteti vazhdoi të merr pjesë në misionin EUFOR/Altesa në Bosnje dhe Hercegovinë, me ekip mjekësor prej 11 anëtarëve në kampusin Butmir dhe këshilltar ndihmës juridik për çështje gjinore. Ajo, gjithashtu, vazhdoi të merr pjesë në misionin paqësor UNIFIL në KB në Liban me sigurim të oficerit të shtatmadhorisë në Qendrën për operacione të përbashkëta në Nagurë. Si pjesë e kontributit të saj drejt grupit luftarak të UE-së për gjysmën e dytë të vitit 2012, Shtatmadhuria e armatës merr pjesë në trajnim përkatës, duke përfshirë përgatitjet për ushtrime të Endeavorit Evropian 2012.

### *Konkluzion*

Shteti ka mbajtur nivelin e vet të lartë të respektimit me Deklaratat e UE-së dhe Vendimet e Këshillit dhe vazhdoi të merr pjesë në operacionet civile dhe ushtarake për menaxhim me kriza. Përgjithësisht, përgatitjet në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes janë mirë të avancuara.

### **4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar**

Është arritur progres i vogël në fushën e **kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP)**. Janë themeluar komitete për menaxhim dhe kontroll financiar (MKF) dhe për revizion të brendshëm. Prapë se prapë, strategjia afatgjatë fiskale për 2013-2015 që i caktoi parametrat themelor të buxhetit nuk është miratuar, siç kërkohet me Ligjin për buxhet të Organit. Mungon dokumenti i azhurnuar strategjik për KPFB për 2012-2014 dhe plani i tij aksionar dhe Ligji për inspeksion financiar. Ligji për KPFB dhe legjislacioni i tij zbatohen me prolongime. Udhëheqësit e institucioneve fillimisht duhet të miratojnë përgjegjësi udhëheqëse dhe në mënyrë përkatëse të përcaktojnë shpërndarje të obligimeve. Përgjegjësia udhëheqëse është kusht themelor për zhvillim të KMF dhe revizionit të brendshëm si vegla për përmirësim të menaxhimit publik. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë të hershme.

Mund të shëhonet progres i caktuar në **revizionin e jashtëm**. Enti shtetëror për revizion (ESHR) zbaton plan të zhvilluar strategjik për 2010-2014 që është azhurnuar në vitin 2012. Në vitin 2011, ESHR plotësisht zbatoi programin e vet vjetor të punës me të gjitha llojet e revizioneve. Nga ndryshimi i Ligjit për financim të partive politike

në tetor 2011, ESHR zbaton revizione për të gjitha mjetet financiare të të gjitha partive politike, pa dallim të burimit. Trupi revizionit për IPA zyrtarisht është ndarë nga ESHR me krijimin e linjës së pavarur buxhetore në qershor 2012. Pavarësia funksionale e ESHR duhet të mbrohet ende në mënyrë kushtetuese. Duhet të themelohen mekanizma formalë për bashkëpunim ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit, veçanërisht në lidhje me përcjelljen e raporteve të revizionit. Përgatitjet përparojnë.

Ka progres të vogël në **mbrojtjen e interesave financiare të UE-së**. Shërbimi për koordinim të luftës kundër mashtrimit (AFKOS) përgatiti strategji nacionale për parandalimin e mashtrimit për mbrojtje të interesave financiare të Bashkimit Evropian, duke e mbuluar periudhën 2012-2014. Megjithatë, kapaciteti administrativ i AFKOS duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohet bashkë me bashkëpunimin operativ ndërmjet AFKOS dhe partnerëve të vet, duke përfshirë edhe OLLAF. Përgatitjet janë në fazë të hershme. (*Shih Kapitullin 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore – për progresin e revizionit të fondeve të UE-së.*)

Mund të shënohet progres i mirë në **mbrojtjen e euros nga falsifikimi**. Është miratuar dhe zbatohet Memorandum për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, policisë financiare, Bankës Qendrore dhe Drejtorisë Doganore, me të cilën rregullohen koordinimi i tyre dhe përpjekjet e tyre të përbashkëta për parandalimin e falsifikimit të parave. Zyra qendrore për parandalimin e larjes së parave bashkëpunon dhe merr pjesë në aktivitetet e përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë. Është themeluar bazë elektronike e të dhënave për larje të parave dhe është përpiluar rregullore për përdorim të të njëjtës. Përgatitjet janë në rrjedhë.

#### *Konkluzion*

Është arritur progres i caktuar në këtë kapitull, veçanërisht në fushat e revizionit të jashtëm dhe mbrojtjes së euros nga falsifikimi. Nevojiten edhe mëtej përpjekje të konsiderueshme, veçanërisht për zbatimin e Ligjit për KFPB, për fuqizimin kushtetues të themelimit të revizionit shtetëror dhe për rritjen e kapacitetit administrativ për mbrojtje efikase të interesave financiare të UE-së. Përgjithësisht, përgatitjet në këtë kapitull janë në fazë të hershme.

### **4.33. Kreu 33: Dispozita financiare dhe buxhetore**

Nuk ka zhvillim të madh në lidhje me **resurset tradicionale personale, resurset e TVSH-së dhe resurset e BPJ-së**. Për progresin në fushat bazike politike, *shih Kapitulli 16 – Tatimimi, 18-Statistika, 29-Unioni doganor dhe 32- Kontrolli financiar*.

Sa i përket infrastrukturës administrative, institucionet janë vendosur në fushat themelore politike, të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë sistemin e resurseve personale. Ato duhet më tej të përforcohen për kalkulim, grumbullim, kontabilitet, pagesë dhe përcjellje të saktë të resurseve personale dhe për informim në BE për zbatimin e rregullave të BE-së për resurset e veta. Strukturat përkatëse për koordinim për menaxhim dhe orientim të resurseve personale dhe përgatitjet paraaderuese dhe për përcaktim të procedurave për punë duhet të caktohen. Duhet edhe më tej të zhvillohen vegla efikase për luftë kundër evazionit tatimor dhe mashtrim dhe reduktim të ekonomisë informale.

#### *Konkluzion*

Ka progres të vogël në këtë sferë. Institucionet dhe kapacitetet administrative për kalkulim, grumbullim, kontabilitet, pagesë dhe përcjellje të saktë të resurseve personale duhet të zhvillohen kur për atë do të vjen koha. Përgjithësisht vlerësuar,

përgatitjet janë në fazë të hershme.

## Aneksi Statistikor

<b>Llogaritë nacionale</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Produkti i brendshëm bruto (GDP) (në milion nga valuta nacionale)		233 840	364 989	411 728	410 734	434 112	463 393по.
PBB (në milionë euro)		3 839	5 965	6 720	6 703	7 057	7 524по.
BPV (në euro për secili qytetar)	1)	1 890	2 921	3 286	3 272	3 438	3 664по.
BPV (Në Standardet e Fuqisë Blerëse (SFB) për banor)		4 972	7 723	8 414	8 500	8 873	9 248по.
BPV për secilin banor në SFB (UE-27 = 100)		25	31	34	36	36	:

## TË DHËNAT STATISTIKORE Republika e Maqedonisë

<b>Të dhënat bazë</b>	Për.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Popullsia (në mijëra)		2 031	2 042	2 045	2 049	2 053	2 057
Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km <sup>2</sup> )		25 713	25 713	25 713	25 713	25 713	25 713

<b>Bilanci i pagesave</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Bilanci i pagesave llogaria rrjedhëse e përgjithshme (në milion euro)	5)	-263	-421	-862	-457	-150	-201
Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: Bilanci tregtar (në milionë euro)	5)	-588	-1 181	-1 763	-1 560	-1 468	-1 682
<b>Bilanci i pagesave të llogarisë rrjedhëse: Shërbimet Treguesit financiarë)</b>	5)	21	28	0	16	40	07
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë në tërësi, në raport me eksportin e përgjithshëm (%)	7)	108.4	92.6	97.6	148.2	129.7	122.5
Ofertë e parave M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat afatshkurtra në euro milion)	8)	415	772	881	854	933	997
Ofertë e parave M2 (M1 plus depozitat me orochenost në dy vjet, në miliona euro)	8)	1 145	2 728	2 913	3 040	3 277	3 523
Ofertë e parave M3 (M2 plus instrumentet që mund të ofrohen në treg në llum. Euro)	8)	1 267	2 872	3 184	3 388	3 781	4 147
Prej të cilave IHD i ekonomisë për të cilën raportohet në BE-27 (milion euro)	:	:	:	:	:	:	:
Investimet e huaja direkte (FDI) në ekonominë raportuese për të cilën njoftohet (në miliona euro)	5)	499	506	400	145	159	304
Prej te cilave IHD e ekonomisë për të cilën njoftohet (milion euro)	6)	:	355	264	131	114	168
Ndryshimet në rezervat, si një përqindje e DPV (%)		1.2	0.0	0.0	0.0	0.1	.
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, kundrejt BPV (%)		42.7	52.4	50.9	39.2	46.6	54.4про
Eksporti i mallrave në lidhje me BPV (%)		56.6	70.8	76.2	61.0	65.3	

73 8про

<b>Industria</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2005=100)	4)	96.4	110.0	115.6	105.6	100.5	103.8

<b>Shkalla e inflacionit</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Norma mesatare vjetore e inflacionit (PPI,% ndryshim nga viti i kaluar)		5.5	2.3	8.3	-0.8	1.6	3.9

<b>Financat publike</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Deficiti i përgjithshëm qeveritar / teprica, kundrejt PBB (%)		:	0.6	-0.9	-2.6	-2.4	-2.6
borxhi i përgjithshëm shtetëror në raport me BPV (%)		48.8	24.0	20.6	23.8	24.2	28.6

Gjithsej kredi nga institucionet financiare monetare për banorët (konsoliduar) (milion euro)	9)	620	2 093	2 803	2 913	3 102	3 367
Normat e interesit Norma e parasë e përdishme	10)	11.7	3.6	4.1	6.0	3.8	2.2
Norma e interesit e kreditimit (në vit). vjetore (%)	11)	23.0	7.5	8.5	10.0	5.5	5.5
Norma e interesit e kreditimit (në vit). vjetore (%)		.	.	.	.	.	.
Kursi devizor të Euros Me një periudhë mesatare - 1 euro = ...valuta nazionale		60.913	61.184	61.265	61.273	61.515	61.529
Indeksi i kursit devizor efektiv (2005=100)	12)	88.6	99.8	100.8	106.8	106.3	107.2
Vlera e mieteve rezervë (përfshirë arin) (në milion)	11)	844	1 524	1 495	1 598	1 715	2 069

<b>Tregtia e Jashtme</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Vlera e importit Të gjitha mallrat , të gjithë partnerët (Në milion euro)		1 893	3 834	4 664	3 637	4 137	5 038
Vlera e importit Te gjitha mallrat , te gjithe partneret (Ne milion euro)		1 293	2 477	2 698	1 937	2 535	3 198
Bilansi tregtar: Te gjithe mallrat , te gjithe partneret (Ne milion euro)		-600	-1 356	-1 967	-1 700	-1 602	-1 841



Kushtet e tregtisë (indeksi i çmimit të eksportit / indeksi i çmimeve të importit)	97.1	109.3	93.1	98.3	101.5	92.7
Pjesa e eksporteve në UE-27 vendeve në vlerë të eksporteve të përgjithshme (%)	53.5	65.3	59.5	56.4	61.8	60.6
Pjesa e eksporteve në UE-27 vendeve në vlerë të eksporteve të përgjithshme (%)	59.5	49.8	48.2	52.2	53.2	54.4

<b>demografi</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Shkalla e rritjes natyrore Ndryshimi natyror (lindjet minus vdekjet) (në 1000 banorë)		5.0	1.5	1.9	2.3	2.5	1.6
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave Vdekshmëria e fëmijëve nën 1 vit. Për 1000 lindje të gjalla		11.9	10.3	9.7	11.7	7.6	7.6
Jetëgjatësia në lindje Burra (vjet)		70.8	71.9	72.1	72.5	72.7	:
Jetëgjatësia në lindje Gra (vjet)		75.6	76.1	76.3	76.7	77.0	:

<b>Treu i punës</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Shkalla e aktiviteteve ekonomike (20-64): Pjesa e popullsisë 20-64 d. që është ekonomikisht aktive (%)		:	68.5	69.4	70.1	70.4	70.1
* Shkalla e punësimit (20-64) Pjesa e popullsisë prej 20-64v. Që janë të punësuar (%)		:	45.0	46.3	47.9	48.1	48.4
Shkalla e punësimit të meshkujve (20-64) (%)		:	54.0	56.2	58.4	58.4	57.8
Shkalla e punësimit të meshkujve (20-64) (%)		:	35.8	36.2	37.1	37.5	38.8
Shkalla e punësimit të punëtorëve më të vjetër (55-64) Pjesa e popullsisë prej 55-64v. Që janë të punësuar		27.7	28.8	31.7	34.6	34.2	35.4
Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)							
Bujqësi	13)	42.0e.					
Industri	13)						
Ndërtimtari	13)		6.5нев.	6.5нев.			6.2нев.
shërbime	13)						
Shkalla e papunësisë Pjesë e fuqisë punëtore që		30.5	34.9	33.8	32.2	32.0	31.4
Pjesë e fuqisë punëtore që është e papunë (%)		29.5	34.5	33.5	31.8	31.9	31.8
Pjesë e fuqisë punëtore të femrave që janë papunë		32.0	35.5	34.2	32.8	32.2	30.8
Shkalla e papunësisë e personave <25 vjet Pjesë e fuqisë punëtore që është e papunë (25)		56.1	57.7	56.4	55.1	53.7	55.3
Shkalla e papunësisë afatgjatë Pjesë e fuqisë punëtore që është e papunë (12) muaj nëse më		26.5	29.7	28.7	26.3	26.7	25.9

<b>Kohezioni social</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Rrogat mesatare mujore nominale dhe rrogat (valuta kombëtare)		10 552.0	14 584.0	16 096.0	19 957.0	20 553.0	20 847.0
Indeksi i rroga ve reale dhe mëditjet (indeksi i rrogave nominale pjesëtuar me IÇK / IHÇK) (2000=100)	14)	98.1	124.5	126.9	158.7	160.8	157.0
* Shkolla e hershme lënë - pjesa e popullatës 18-24 vjet me shkollë të lartë dhe më të ulët trajnimi nuk janë duke ndjekur (%)	:		19.9	19.6	16.2	15.5	13.5

<b>Nivel i jetesës</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Numri i lejeve për vetura për 1000 banorë		152.1	121.9	128.6	137.7	151.0	152.1
Numri i abonentëve të telefonisë mobile për 1000 banorë		109.0	884.2	1 223.4	948.4	1 098.2	1 104.9тп оц.
<b>Infrastrukturë</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja funksionale, në 1000 km <sup>2</sup> )		36.0	36.0	36.0	36.0	36.0	36.0
Gjatësia e autostradave (km)		145	221	237	251	251	259

<b>Inovacioni dhe hulumtim</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Shpenzimet për burimet njerëzore (shpenzimet publike në arsim) në% të BPV-së		3.6	3.1	3.3	3.6	3.7	:
* Shpenzimet e brendshme bruto në hulumtime dhe		0.30	0.17	0.23	0.20	0.19	:
Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në		:				46.0	55.0

<b>Miedisi ietësor</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
* aiithsei emetimet të gazeve serë ekuivalente me CO2 (në intensiteti i energjisë i ekonomisë (kg naftë ekuivalent për 1000 €PBB-së)		92.0	:	:	:	:	:
Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë elektrike (%)		9.2	11.2	9.3	15.4	28.0n.	:
Mallrave Transporti Rruqor (% në ton-km)	15)		88.4	84.3	89.0	89.0	:

<b>Eneraii</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Prodhimi primar i të aiitha produkteve të energjisë		1 642	1 504	1 624	1 607	1 616n.	:
Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (miie TOE)		0	0	0	0	0	:
Prodhimi primar i thënaillit vështirë të liniitit dhe (miie TOE)		1 419	1 254	1 378	1 293	1 194n.	:
Prodhimi primar i gazit natyror (miie TOE)		0	0	0	0	0	:
Importet neto të të aiitha produkteve të energjisë		1 011	1 461	1 404	1 273	1 274n.	:
Konsumi i energjisë bruto në vend (miie TOE)	16)	2 677	3 033	3 023	2 810	2 882n.	:
Prodhimi i energjisë elektrike (në miie GWh)		6.4	6.5	6.3	6.8	7.3n.	:

<b>Bujqësi</b>	Per.	2001	2007	2008	2009	2010	2011
Indeksi i shkallës së prodhimit të mallrave dhe shërbimeve bujqësore (çmimet e prodhuesit, viti sipërfacia e përaiihshme e shfrytëzuar bujqësore (në Bleatori: Kafshë (miiera kokë, fundi i periudhës)		90.2	98.1	104.5	102.9	107.7	96.8
Bleatori: Kafshe (miiera koke, fundi i periudhes)		1 244	1 077	1 064	1 014	1 121	1 120
Bleatori: Delet dhe dhitë (miiera kokë, fundi i prodhimi dhe përdorimi i qumështit në ferma (qumështi total, miie ton)		265	254	254	253	260	265
Prodhimi i të mbjellave Drithërat (përfshirë orizin) (në miie ton prodhim i korrur)		189	255	247	194	191	197
Prodhimi i të mbjellave Panxhar sheqeri (në miie ton prodhim i korrur)		1 286	944	950	849	854	839
Prodhimi i te mbjellave Perime (ne miie ton prodhim i korrur)		201	374	368	343	347	376
		474	469	613	606	539	552
		38	8	0	0	0	0
		667	698	728	804	887	845

: paaritshmëri

- Nuk është i zbatueshëm

p= paraprakisht

për = vlerësuar

prek Në Seria

Të pa sigurta Të dhënat pasigurta apo të pasigurta

prog prognozë

Indikator Europe 2020

Përdorimi bilancit të pagesave të nënshkruar konventa mbi IHD-ve. Per IHD jasht shenjes se minusit do te thote se investimet jashte ekonomise per te cilen investohet e ka kaluar deinvestimin e tij ne periudhen, perderisa futet pa shenje do te thote se deinvestimi e ka kaluar investimin.

Fusnotat.

1) llogaritet duke përdorur PBB në euro dhe një popullsi prej 1 Jan.

2) BPV me çmime konstante të vitit të kaluar.

3) 2003 - 2008, Të dhënat sipas NACE Rev.. 1.1.

4) Të dhënat ri-llogaritur në përputhje me rev NACE. 2 për periudhën 2005-2010.

5) Për periudhën 2001-2002, vlerat në euro janë llogaritur duke përdorur norma vjetore mesatare e këmbimit.9) Nga viti 2003 e tutje, vlerat në euro janë llogaritur në bazë të normave të këmbimit valutor.

7) Të dhënat për fluksin e investimeve të huaja nga vendi për vitin 2011. Marrin vetëm barazinë kategori dhe përbërës të kapitalit të kredisë tjetër. Të dhënat për fitimet e ri-investuara dhe komponentëve të tjerë dotoci IHD-ve, bazuar në anketën vjetore të IHD-ve janë në dispozicion brenda t 270 ditë.

8) 2001 -2003, të dhënat e borxhit të jashtëm janë llogaritur bazuar në metodologjinë e vjetër, me të dhënat e mbulimit të pjeshme. Që nga viti 2004. Dhënave bruto borxhit të jashtëm janë përgatitur në bazë të të dhënave statistikore për udhëzues të borxhit të jashtëm me mbulim të plotë.

9) Që nga viti 2003., Seria e të dhënave mbi të dhënat e ofertës së parasë janë rishikuar për të përfshirë bankat e kursimeve.

10) Të dhënat nga viti 2006 që mbulon transaksionet prekunokjni dypalëshe [2003] -. Duke filluar nga viti 2003, Gjithsej Kategoria kreditë MFli (institucionet mikrofinanciare) është zgjeruar për të kreative të dhëna nga bankat e kursimeve..

11) 2001-2006 fundi i vitit;. deri në vitin 2005. Të dhënat mbuluar të gjitha transaksionet e maturimit përfundimin e tregut të institucionalizuar parave; që nga viti 2006, të dhënat e mbuluar transaksionet bilaterale gjatë natës.

12) Fundi i vitit

13) NNEK (Norma efektive nominale të këmbimit)

14) Të dhënat e siguruar në përputhje me NACE. 1.1.

15) Një koncept i ri i të ardhurave bruto është aplikuar në vitin 2009.

16) Ndërprerje në seri: 2004-2008. Të dhënat e rishikuara (përfshirë transportin për

llogari të vet); 2005-2010. Ndërprerje seriale: 2005-2010 . Të dhënat e rishikuara (transporti përfshirë tubacion)  
17) 2001-2009 për të llogaritur konsumin e brendshëm bruto të energjisë, janë përdorur konsumin primar, importet neto dhe të dhënat e ndryshimit të aksioneve.